



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në: “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”  
Kolegji Universitar “LOGOS”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Dr. Anila HODA**

**Prof.Dr. Etleva REFATLLARI**

**Mars / 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “LOGOS”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Mjekësore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në: Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 428, datë 22.09.2017
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 21, datë 01,03,2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 49, datë 13.07.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	v a 2019-2020 22 studentë v a 2020-2021 14 studentë v a 2021-2022 8 studentë v a 2022-2023 17 studentë
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, Kolegji Universitar “Logos”. KU Logos ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në vitin 2017 dhe riakredituar në nivel institucional në vitin 2021 me vendim të BA nr.58, datë 16.12.2021, për një periudhë 4 vjeçare. Programet e studimit që ofron Departamenti i Shkencave Mjekësore janë akredituar dhe janë në proces riakreditimi periodik nga institucionet përgjegjëse.

Misioni i Programit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë në një stad më të lartë dijet e fituara në programin e ciklit të parë Bachelor përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor. Të formojë specialistë të lartë në fushën Laboratorike Mjekësore në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit për ofrimin e një shërbimi laboratorik klinik, biokimik, mikrobiologjik, histopatologjik të kualifikuar në funksion të diagnozës, monitorimit dhe parandalimit.

Programi është riorganizuar me urdhër të MAS Nr.428 datë 22.09.2017 dhe është akredituar për një periudhë 5 vjeçare me Vendim Nr.49 datë 13.07.2018 të Bordit të Akreditimit.

Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet në përputhje me kërkesat aktuale dhe ka një ndërthurje të mirë të teorisë me praktikën që mundëson formimin profesional të studentëve. Programi i studimit realizohet me 60 ECTS dhe kohëzgjatja normale e tij është 1 (një) vit akademik. Programi organizohet në lëndë/module në përputhje me aktet ligjore në fuqi, konkretisht me ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr. 41 datë 24.01.2018.

Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi përbëhet nga personalitete të spikatur në fushën e mjekësisë laboratorike, si dhe nga mjekë të rinj. Institucioni ndjek një politikë për të ruajtur vazhdimësinë e mësimdhënies përmes rekrutimit të stafit të ri të specializuar si dhe mbështet dhe promovon marrjen e gradave dhe titujve akademikë pret tyre.

Institucioni ka vendosur përparësitë e veta strategjike siç janë fuqizimi i kapaciteteve të laboratorëve ekzistues dhe për këtë ka rinovuar hapësirat e laboratorëve, si dhe ka investuar në paisjen e tyre me teknologji bashkëkohore për të mundësuar aftësimin praktik dhe shkathtësimin në veprimet profesionale të studentëve. Institucioni ka në fokus rritjen e cilësisë së mësimdhënies, bashkëpunimin me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit mbështetur në marrëveshje bashkëpunimi midis palëve. Institucioni bashkëpunon me institucione të ndryshme publike dhe private, ku mundëson jo vetëm formimin profesional të studentëve, por edhe ndihmon dhe mbështet studentët në rrugën e punësimit dhe rezultojnë që një përqindje e lartë e studentëve punësohen në profesion direkt pas diplomimit.

## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Programi Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është akredituar sipas legjislacionit Shqiptar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.49 datë 13.07.2018 me vlefshmëri maksimale prej 5 vitesh akademike. BA ka lënë disa rekomandime për këtë program studimi, të cilat janë plotësuar nga institucioni si më poshtë:

- 1. Rekomandimi 1: Institucioni të mbajë në vëmendje përmirësimin e syllabuseve duke rishikuar shpërndarjen e krediteve në raport me format e mësimdhënies si dhe rishpërndarjen më të mirë duke shtuar peshën specifike të disiplinave të ngjashme dhe të integruara.**

Në përmbushje të rekomandimit të parë programi i studimit ka pësuar ndryshime në masën 20% për t’u përshtatur me kërkesat ligjore (raportet teori/praktikë, raportet e lëndëve sipas tipologjive) dhe kërkesat e tregut të punës. Ndryshimet janë si më poshtë:

1. Lënda Bakteriologji klinike e avancuar (tipologji B me 6 ECTS) u riorganizua në Diagnostika laboratorike në mikrobiologji (tipologji B me 7.5 ECTS). Riorganizimi ka synuar shtimin e orëve të praktikës laboratorike.
2. Lënda Kimi klinike (4 ECTS tipologji A) u riorganizua në Vlerësim i metodave të analizës në laboratorë mjekësorë (6 ECTS, tipologji C).
3. Lënda Sëmundje infektive (4 ECTS tipologji A) u hoq nga programi
4. Gjashtë lëndë janë riemërtuar dhe syllabuset janë rishikuar:
  - a. Hematologji klinike e avancuar u bë Hematologji laboratorike
  - b. Imunologji klinike e avancuar u bë Imunodiagnostikë laboratorike
  - c. Biokimi klinike e avancuar u bë Biokimi e aplikuar
  - d. Analiza klinike e avancuar e gjakut dhe urinës u bë Analiza e lëngjeve biologjike
  - e. Histopatologjia klinike e avancuar u bë teknika të histopatologjisë klinike
  - f. Biologjia molekulare e avancuar u bë Diagnostika molekulare në laboratorë mjekësorë.

Plani mësimor për akreditim zhvillohet në një vit akademik dhe përmban 60 ECTS të grupuara sipas skemës së mëposhtme:

- Kategoria A: Lëndë bazë 4.5 ECTS / 7.5% (5 – 10%)
- Kategoria B: Lëndë karakterizuese 31.5 ECTS / 52.5% (30 – 40%)
- Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 12 ECTS / 20% (20 – 30%)
- Kategoria D: Lëndë plotësuese 6 ECTS / 10% (10%)
- Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 6 ECTS /10% (10 – 20%).

- 2. Rekomandimi 2: Institucioni të ngrejë një sistem të informatizuar në funksion të stafit dhe studentëve në kuadër të realizimit cilësor dhe efektiv të procesit mësimor.**

Në përmbushje të rekomandimit të dytë institucioni:



1. ka shtuar numrin e sallave të leksioneve dhe seminareve në funksion të programit të studimit dhe ka përmirësuar infrastrukturën e sallave të leksioneve dhe seminareve me mjete të teknologjisë së informacionit (projektor, kompiuter, webcam, software Windows) për të garantuar përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimit.
2. ka adaptuar përdorimin e platformave on-line (Edu-Page, MS TEAMS) mjaft të rëndësishme sidomos në periudhën e pandemisë për komunikimin student-pedagog dhe krijimin e klasave online.
3. Ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën e re të paisur me kompiutera për të aksesuar bibliotekën digjitale dhe platformat on line.

**3. Rekomandimi 3: Institucioni të shikojë mundësinë e pasurimit të laboratorëve me paisje të reja bashkëkohore për realizimin sa më të mirë të orëve praktike/laboratorike.**

Në përmbushje të rekomandimit të tretë institucioni:

1. ka riorganizuar 4 laboratorët në vendndodhjen e re (kati i dhjetë i godinës) sipas profilit duke i paisur me aparatura të reja bashkëkohore në funksion të programit të studimit.
2. Paisjet e reja janë siguruar nga blerje dhe donacione: mikroskop fluoreshent, 2 koagulometra, immulite (për ekzaminime imunodiagnostike).
3. Institucioni demonstron qëndrueshmëri (të dhënat e buxhetit) dhe vazhdimësi në sigurimin e reagentëve dhe bazës materiale për realizimin e praktikave laboratorike.
4. Janë rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit duke synuar laboratorë të akredituar dhe me teknologji bashkëkohore.

GVJ konkludon se **KU LOGOS** i ka plotësuar plotësisht të gjitha rekomandimet e akreditimit të mëparshëm.

Kolegji Universitar “LOGOS”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.02.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 121 Prot, datë 07.02.2024. Kolegji Universitar “LOGOS”, përcjell në ASCAL, mw datw 14.02.2024 me anë të shkresës me Nr. 37 Prot, datë 08.02.2024, “Përgjigje, lidhur me dërgimin e draft raportit të vlerësimit të jashtëm për programin e studimit”, ku shpreh dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Drafti merr formën e Raportit Final.



5  


## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në “Teknikë e lartë në laboratorë mjekësorë” të ofruar nga Departamenti i Shkencave Mjekësore, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

GVJ përbëhej nga Prof.Dr. Anila Hoda dhe Prof.Dr. Etleva Refatllari. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirmeli. GVJ shfrytëzoi RVB, si dhe një numër të konsiderueshëm evidencash të ndryshme, të cilat iu vunë në dispozicion mjaft kohë përpara zhvillimit të vizitës në institucion. Përmes leximit të dokumentacionit GVJ u familjarizua me strukturën, politikat, menaxhimin, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe aktivitetet kërkimore të kryera nga IAL, si dhe konkretisht nga stafi i Departamentit të Shkencave Mjekësore. GVJ realizoi një sërë takimesh gjatë vizitës në institucion, çka i mundësoi ekipit vlerësues të kuptojë më qartë këndvështrimet e stafit dhe studentëve. GVJ u takua me përfaqësues të ndryshëm, autoritete drejtuese, përfaqësues të studentëve, përfaqësues të zyrave mbështetëse të procesit mësimor, dhe aktiviteteve akademike e kërkimore të Departamentit. Gjithashtu GVJ realizoi dhe një vizitë në ambjentet e brendëshme të institucionit, që lidheshin kryesisht me programin e studimit. GVJ vizitoi klasat, laboratorët mësimorë, sekretarinë mësimore, bibliotekën etj.

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen
- Standardet përmbushen pjesërisht
- Standardet përmbushen kryesisht
- Standardet përmbushen plotësisht

Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, si dhe gjithë informacionin e mbledhur gjatë vizitës, GVJ arriti në konkluzionet se standardet për të gjitha fushat e vlerësimit përmbushen plotësisht.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Standardi I.1**


**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Kolegji Universitar Logos është institucion i arsimit të lartë që ushtron aktivitetin e tij në Shqipëri që nga viti 2009 fillimisht si Shkollë e Lartë Private (liçensuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1055 dt. 29.07.2009) dhe nga viti 2017 me statusin e Kolegjit Universitar (Urdhër i Ministres së Arsimit dhe Shkencës Nr. 93, dt. 06.03.2017).</p> <p>Në statutin e Kolegjit Universitar “Logos” evidentohet si mision i institucionit kontributi në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit. <i>(Aneks II/1)</i> Në përmbushje të këtij misioni KU Logos ofron një seri programesh studimi në fushat e biznesit, shkencave humane, arsimit, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, shëndetit dhe mirëqënies sociale dhe agorbiznesit <i>(Aneks II/4, II/5.1)</i>. Programet e studimeve të ofruara nga KU Logos, ofrojnë një arsim të lartë cilësor dhe edukim të brezit të ri me vlerat akademike dhe kulturore kombëtare.</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga KU Logos janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar të arsimit të lartë dhe i përgjigjen interesave kombëtare në fushën e arsimit të lartë. Në mënyrë specifike, Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë <i>(Aneks II/3.3, II/4.1, II/4.3)</i>. Programi synon Të përgatisë specialistë të laboratorit të aftë të përdorin teknologjinë bashkëkohore në laboratorët mjekësorë. Zhvillimi strategjik i programit mësimor synon rritjen e kapacitetit teorik-praktik profesional të studentëve në përputhje me nevojat aktuale dhe perspektivën e shërbimit laboratorik mjekësor në vend. Në planet strategjike theksohet fuqizimi i laboratorëve për fusha specifike si imunologjia laboratorike, biologjia molekulare dhe</p>



	<p>ekzaminimet gjenetike. KU Logos në gjithë procesin mësimor – edukativ dhe kërkimor – shkencor mbështetet në infrastrukturën ligjore të MASR, që reflektohet në statutin dhe kuadrin rregullator të institucionit, duke ruajtur transparencën mbi veprimtarinë e saj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”. është hartuar në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara i KU Logos.</p> <p>Misioni i Programit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë në një stad më të lartë dijet e fituara në programin e ciklit të parë Bachelor përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor. Të formojë specialistë të lartë në fushën Laboratorike Mjekësore në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit (<i>Aneks II/3.3</i>).</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të KU Logos. Programi është hartuar në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë (<i>Aneks II/4, II/1</i>). Institucioni ka një përvojë të gjatë në pregatitjen e specialistëve në fushën laboratorëve mjekësore, një nga programet e para të ofruara prej tij dhe që ka ndjekur një rritje progresive në cilësi. Programi përmban elementët e domosdoshëm për të përmbushur misionin dhe për të realizuar objektivat për formimin e thelluar teorik – praktik të specialistëve në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”. (<i>Aneks II/3.3, Tabelat e RVB, Syllabuset</i>)</p> <p>Programi është riorganizuar me urdhër të MAS Nr.428 datë 22.09.2017 (<i>Aneks 0/4</i>) dhe është akredituar për një periudhë 5 vjeçare me Vendim Nr.49 datë 13.07.2018 të Bordit të Akreditimit. Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” kategorizohet në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është hartuar në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e Institucionit dhe mbështet strategjinë për zhvillim të tij. Zhvillimi strategjik i programit mësimor synon rritjen e kapacitetit teorik-praktik profesional të studentëve në përputhje me nevojat aktuale dhe</p>

<p>dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>perspektivën e shërbimit laboratorik mjekësor në vend. (<i>Aneks II/4, II/4.1</i>)</p> <p>Misioni i institucionit i shprehur në statutin dhe rregulloren e KU Logos (<i>Aneks II/1, II/2</i>) është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të zhvillojë dijet, përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në të mirë të përgatitjes në nivel bashkëkohor të studentëve;</li> <li>- të ofrojë mundësi të mira për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës</li> <li>- të kontribuojë në mbështetje të interesave strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit</li> <li>- të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor.</li> </ul> <p>Institucioni për përmbushjen e misionit të tij është organizuar në përputhje të plotë me infrastrukturën ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke ruajtur autonominë dhe lirinë akademike.</p> <p>Ky program studimi merr në konsideratë nevojat e tregut të punës. Programi është në përputhje me strategjitë e zhvillimit të institucionit si dhe parashikon modifikime e përmirësime në përputhje me rezultatet e arritura dhe me kërkesat e zhvillimit të profesionit dhe sistemit laboratorik në Shqipëri.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Zhvillimi social dhe ekonomik i vendit në përgjithësi dhe ambicia për integrim në hapësirën europiane kërkon burime njerëzore të kualifikuara me një bazë të gjerë dhe të përshtatshme dijesh. Mendojmë se ky program studimi është në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe integritit. Programi është në harmoni me strategjinë kombëtare për shëndetësinë (<i>Aneks II/4.3</i>). Nga vlerësimi i RVB dhe dokumentacionit shoqërues GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet në përputhje me zhvillimin lokal dhe kombëtar dhe ndihmon në zhvillimin e shërbimit shëndetësor në përputhje me kërkesat e kohës. Programi i studimit ka një ndërthurje të mirë të teorisë me praktikën që mundëson formimin profesional në fushën e laboratorëve biokimikë, klinikë, mikrobiologjikë dhe histopatologjikë (<i>Aneks RVB, II/4, II/3.3, Syllabuset</i>). Në takimin me drejtuesit e institucionit dhe stafin u theksua se programi ofron dhe një formim teorik në diagnostikë molekulare, vlerësimin e metodave të analizës të domosdoshme për të punuar në një mjedis laboratorik në zhvillim dinamik në përshtatje dhe</p>





	me kërkesat e akreditimit laboratorik si dhe me kërkesat globale për teste të reja laboratorike të lidhura me problematikat aktuale shëndetësore. Në takime u informuam gjithashtu se institucioni ndjek ndryshimet e tregut dhe vlerëson performancën e programit përmes komunikimit të vazhdueshëm me aktorët e tregut laboratorik shqiptar dhe internacional si dhe përmes marrjes së vlerësimit feed-back nga studentët Alumni. <b>(Takimet në institucion).</b>			
<b>Konkluzione</b>	<p><b>GVJ gjykon se Standardi I.1 përmbushet plotësisht.</b></p> <p><i>Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit dhe në përputhje të plotë me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Departamentit të Shkencave Mjekësore që janë përgjegjëse për këtë program studimi. Programi i studimit synon formimin e specialistëve të aftë për të punuar në mënyrë të pavarur në sistemin laboratorik shqiptar dhe më gjerë. Programi synon të pregatisë studentët me kapacitete të mjaftueshme teoriko-praktike për të vazhduar studime të mëtejshme dhe kërkim shkencor. Programi është në përputhje me strategjinë kombëtare në fushën e shëndetësisë, me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe synon të përmbushë nevojat specifike për personel të kualifikuar në fushën e diagnostikës laboratorike.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për	<p>KU Logos është institucion i Arsimit të Lartë që ka përmbushur kriteret e akreditimit instituconal dhe është akredituar për një periudhë katër vjeçare me Vendim Nr.58, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit. Në përbërje të KU Logos janë tre fakultete:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fakulteti Ekonomik,</li> <li>- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara,</li> </ul>

ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

- Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor

që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat humane, arsimin, teknologjinë së informacionit dhe komunikimit, shëndetin dhe mirëqënies sociale dhe agorbiznesit. Institucioni tashmë ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon dhe burimeve njerëzore në staf akademik dhe mbështetës. Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësore” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara i cili përbëhet nga 3 departamente (*Aneks II/1*):

- Departamenti i shkencave mjekësore
- Departamenti i informatikës së zbatuar dhe statistikës
- Departamenti i shkencave të shëndetit dhe mirëqënies sociale

Departamenti i shkencave mjekësore është përgjegjës për programin e studimit.

Pas konsultimit të dokumentacionit të dorëzuar, takimit në institucion dhe vizitës në ambientet e auditorëve dhe laboratorëve, GVJ konstaton se institucioni ka përvojë të gjatë dhe zotëron burimet dhe kapacitetet akademike për ofrimin e programeve të studimit në fushën e Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësore.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej **29 pedagogë**, nga të cilët **15 janë pedagogë efektiv (PAE)** nga ku: 4 kanë titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 4 kanë gradën Dr./PhD, dhe 5 Asistent Lektorë me Msc. 2 prej të cilëve janë në proces doktrature; dhe **14 pedagogë me kontratë (PAK)** nga ku 2 kanë titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 8 kanë gradën Dr./PhD. dhe 2 Asistent Lektorë me Msc.

Departamenti i Shkencave Mjekësore për vitin akademik 2022-2023 ka **6 PAE** (2 kanë titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”, 2 kanë gradën Dr./PhD., 1 asistent Lektor me Msc dhe Specializim pasuniversitar në fushën e Mjekësisë Laboratorike), **2 PAK** (1 ka titullin “Profesor”, dhe 1 ka titullin “Profesor i Asociuar” si dhe 2 personel ndihmës akademik. (*RVB-tabelat 1,2*)



	<p>Neni 25/pika 4 e ligjit 80/2015, e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” përcakton numrin minimal prej 7 anëtarëve PAE në krijimin e një Departamenti. KU Logos ka firmosur një marrëveshje (datë 01.07.2019) me MASR “Për Përcaktimin e Numrit të Personelit Akademik me Kohë të Plotë në Njësitë Bazë në Kolegjin Universitar Logos” në nenin 3, pika 2 të së cilës theksohet se: të gjitha departamentet e Kolegjit, do të kenë në përbërje të secilës njësi bazë të paktën 5 (pesë) pedagogë me kohë të plotë, minimalisht 2 (dy), prej të cilëve duhet të zotërojnë gradë shkencore ose titull akademik. Në çdo rast personeli akademik me kohë të plotë në secilën njësi bazë duhet të mbulojë 70% të ngarkesës mësimore. (<i>Aneks No. 3</i>)</p> <p>Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi përbëhet nga personalitete të spikatur në fushën e mjekësisë laboratorike si dhe nga mjekë të rinj (<i>tabelat e RVB, CV e personelit akademik</i>) Institucioni ndjek një politikë për rinovimin e stafit akademik duke krijuar bashkëpunim midis profesorëve me pedagogë të rinj në moshë për të siguruar qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të departamentit.</p> <p>GVI u njoh me infrastrukturën mësimore që disponon institucioni KU Logos dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ku zhvillohet ky program studimi. Për zhvillimin e programit mësimor KU Logos ka në dispozicion të studentëve salla për leksione dhe seminare të paisura me videoprojektorë, laboratorët e biokimisë, hematologjisë, mikrobiologjisë dhe histopatologjisë të ndërtuar me një konceptim bashkëkohor. (<i>RVB-tabela 16, vizita në institucion</i>)</p> <p>Në dispozicion të studentëve janë dhe ambientet e rinovuara të bibliotekës. GVI vizitoi ambientet e bibliotekës dhe u informua për rregulloren e funksionimit, listën e librave gjatë takimit me punonjësit dhe përmes shqyrtimit të dokumentave në dosjen e programit. (<i>RVB-tabela 17, vizita në institucion</i>)</p> <p>Salla e re për aktivitete promovuese e paisur dhe me njësinë e përkthimit krijon mundësi për takime e konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare për promovimin e aktivitetit akademik e shkencor të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të</p>

<p>e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Shkencave të Aplikuara. Ky Fakultet ka tre departamente (shih standardi 1.2, kriteri 1) dhe ofron tre programe studimi. Departamenti i Shkencave Mjekësore është përgjegjës për dy programe Bachelor dhe Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ndërsa Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës është përgjegjës për programin Bachelor në Informatikë e Zbatuar. <i>(Aneks II/3.1, II/3.2)</i></p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet si program me kohë të plotë dhe është kodifikuar sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe europiane (kodi 725G sipas QSHA). Senati akademik ka miratuar udhëzimin për kodifikimin e lëndëve mësimore të programeve të studimit të ofruara nga KU Logos në zbatim të VKM 41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” <i>(Aneks 13)</i></p> <p>GVJ vlerëson se Programi Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është organizuar dhe strukturuar në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit duke respektuar kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Klasifikimi/kodifikimi i programit të studimit është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve në fuqi për IAL.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi kategorizohet në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve</li> <li>- Emërtimi përputhet me fushën specifike të studimit</li> <li>- Strukturohet në 2 semestra akademike (secili me 30 ECTS)</li> <li>- Në ndarjen e lëndëve janë respektuar kriteret ligjore në fuqi (VKM 41 datë 24.01.2018)</li> <li>- Lëndët e programit të studimit janë të koduara sipas përcaktimeve ligjore</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” përputhet plotësisht me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, Departamentit të Shkencave Mjekësore që është përgjegjës për këtë program studimi.</p> <p>Programi kodifikohet në nivelin 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve duke respektuar direktivat dhe udhëzimet në fuqi. <i>(Aneks III/3).</i></p>

bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Në realizimin e programit të studimit janë përfshirë staf akademik PAE dhe PAK nga Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti i Shkencave të Shëndetit dhe Mirëqënies Sociale departamente që në fokus kanë shkencat mjekësore të aplikuara (Fushat 09 sipas ISCED dhe specifikisht 0914 që i referohet diagnozës mjekësore dhe teknologjise se trajtimit).  <i>(Aneks III/2.0 - 2.4, III/1.1)</i>
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	<b>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.</b>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Për studentët që ndjekin programin e studimit dhe për studentët e diplomuar, institucioni ofron trajnime specifike profesionale në bashkërendim me aktorë të fushës siç janë rrjetet e laboratorëve bashkëpunues Check-up dhe Cambridge. Institucioni mbështet dhe inkurajon departamentet për organizimin e leksioneve të hapura me lektorë të spikatur nga universitetet partnere europiane. <i>(RVB, Aneks VII/3.5, VIII/11.3, takimet në institucion)</i>
<b>Konkluzione</b>	<b><i>GVJ gjykon se Standardi I.2 përmbushet plotësisht.</i></b>  <i>GVJ konstaton se institucioni ka përvojë të gjatë dhe zotëron burimet dhe kapacitetet akademike për ofrimin e programeve të studimit në fushën e Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë. Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi përbëhet nga personalitete të spikatur në fushën e mjekësisë laboratorike si dhe nga mjekë të rinj.</i>  <i>Për zhvillimin e programit KU Logos ka në dispozicion të studentëve salla për leksione dhe seminare të paisura me videoprojektorë, laboratorët e biokimisë, hematologjisë, mikrobiologjisë dhe histopatologjisë të ndërtuar me një konceptim bashkëkohor, bibliotekën etj.</i>  <i>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe të njësisë bazë, Departamentit të</i>

	<i>Shkencave Mjekësore që është përgjegjës për këtë program studimi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në KU Logos ofron 3 programe studimi. Për realizimin e programit të studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësore” janë përfshirë si struktura bashkëpunuese Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti i Shkencave të Shëndetit dhe Mirëqënies Sociale. Në realizimin e programit të studimit përfshihen dhe stafi ndihmës dhe administrativ i KU Logos. Organizimi i strukturave realizuese të programit është piramidial dhe funksionon me parimin e bashkëpunimit dhe kontrollit. <i>(Aneks II/3.1,3.2,3.3)</i></p> <p>GVJ u njoh me dokumentacionin e gjerë të vënë në dispozicion mbi aktet rregullatore për ndarjen e detyrave dhe funksionimin e personelit akademik, administrativ dhe ndihmës në funksion të programit të studimit. <i>(Aneks II/8-18)</i> Në dosje institucioni ka paraqitur dhe një seri dokumentacionesh (vendime senati, dokumentacione të rektoratit, dokumentim të procedurës së ndjekur për ndryshimin e kurrikulës në masën 20%) që evidentojnë mënyrën e funksionimit përmes krijimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit brenda institucionit <i>(dokumentat e Aneksit I)</i>.</p> <p>Institucioni bën analizë të vazhdueshme të punës që pasqyrohet në Raportin vjetor të Departamenteve dhe të KU Logos <i>(Aneks II/24, 24.1, 24.2, 25)</i>. Institucioni bën gjithashtu analizë të punës kërkimore të dokumentuar në raportet përkatëse <i>(Aneks V/1, V/2, V/3, V.4)</i>. Në institucion me vendim senati janë ngritur dhe</p>

	<p>funksionojnë komisionet e përhershme për garantimin dhe sigurimin e cilësisë dhe për marrdhëniet me studentët (<i>Aneks I/8</i>). NJSBC jep kontribut në analizën e vazhdueshme të punës përmes grumbullimit dhe analizimit të informacionit si dhe përpunimit dhe krahasimit statistikor të të dhënave në bazë të indikatorëve Europianë. Në takimin me stafin, pedagogët referuan që janë të përfshirë në procedurat vlerësuese e përmirësuese të syllabuseve, si dhe në hartimin e aplikimin e projekteve kërkimore shkencore. (<i>takimet në institucion</i>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të programit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda vendit, institucione spitalore dhe laboratorë privatë si dhe institucione homologe jashtë vendit në kuadër të programit Erasmus+. (<i>RVB-tabela 5, Aneks VII/1, VII/3, VII/5</i>)</p> <p>Përmes këtyre marrëveshjeve institucioni ka mundësuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Realizimin e praktikës profesionale për studentët</li> <li>– Realizimin e temave të diplomave</li> <li>– Mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve</li> <li>– Realizimin e trajnimeve profesionale</li> <li>– Realizimin e konferencave ndërkombëtare me partnerë si Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Universiteti Katolik Zoja të Mirë, Universiteti i Pireut, Greqi (<i>Aneks V/4, V/5</i>).</li> </ul> <p>Në RVB dhe në takimin me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe mardhënieve me jashtë evidentohet shtimi i mobiliteteve të stafit të Departamentit të Shkencave Mjekësore në kuadër të projekteve Erasmus gjatë dy viteve të fundit dhe aplikimi i projekteve të mobilitetit dhe për studentët e programeve të këtij departamenti. (<i>RVB, takimet në institucion</i>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike,</p>	<p>Për aftësimin praktik të studentit në teknika të avancuara të diagnostikës laboratorike, institucioni ka lidhur një seri marrëveshjes me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si dhe me struktura laboratorike spitalore dhe jospitalore. (<i>RVB-tabela 5, Aneks VIII/1, VII/3, VII/5</i>) Me riorganizimin e programit të studimit praktika profesionale është kthyer në një zë të rëndësishëm për realizimin e plotë të tij. Ajo realizohet në</p>






<p>praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>laboratorë të akredituar në të cilat aplikohet teknologji e avancuar (Intermedika, Check-up, Cambridge).</p> <p>Institucioni ka ndërtuar një kuadër rregullator për zhvillimin e praktikës (<i>Aneks II/3.3 VIII/11.1 – 11.3</i>)</p> <p>Studentët stimulohen të marrin pjesë aktive me punime të realizuara në laboratorët e praktikës në konferencat studentore. Pas periudhës së pandemisë ka një riaktivizim të projekteve të mobilitetit Erasmus me pjesëmarrje të pedagogëve dhe studentëve të Fakultetit si dhe pjesëmarrje të studentëve të programit të studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” në aktivitete shkencore të IAL. (<i>RVB-tabelat 20, 22, takimet në institucion</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” funksionon bazuar në rregullore dhe planin strategjik të zhvillimit në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor, sigurimit të cilësisë, ndërkombëtarizimit etj. Në analizën periodike vjetore të punës së Departamentit të Shkencave Mjekësore raportohet dhe për masën e realizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit (<i>Aneks II/24.1, II/24.2, II/25</i>). Ky raport siguron informacion lidhur me ndikimin e këtyre marrëveshjeve në bashkëpunimin midis personelit akademik dhe studentëve për shkëmbim eksperience, kërkim shkencor, mobilitet etj. Të dhënat e raporteve shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, hartimin e politikave të zhvillimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Synohet shtimi i kontakteve dhe marrëveshjeve në kuadër të programit Erasmus + pas situatës së jashtëzakonshme me kufizim të lëvizjes e krijuar nga pandemia COVID19.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i><b>GVJ gjykon se standardi I.3 përmbushet plotësisht.</b></i></p> <p><i>Institucioni ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me struktura laboratorike spitalore dhe jospitalore përmes të cilave siguron realizimin e praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi me qëllim përgatitjen e specialistëve në fushën e diagnostikës laboratorike të aftë për të kontribuar me ekspertizë teknike në sektorët e sigurimit të cilësisë laboratorike, testimeve biokimike, hematologjike, imunologjike, mikrobiologjike, histopatologjike. Institucioni ka lidhur një numër të madh marrëveshjes me institucione universitare</i></p>

	<i>europiane që i shërbejnë jo vetëm aftësimin profesional të stafit por janë dhe në funksion të kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri (ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41, të MASR datë 24.01.2018). Programi është i organizuar në lëndë dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit. Referuar rregullores së programit të studimit dhe tabelave të RVB (<i>Aneks II/3.3, 3.2.0-3.2.4, RVB-tabelat 9, 10</i>):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Programi Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është program i ciklit të dytë të studimeve që korrespondon me Nivelin 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve</li> <li>– Studimet zhvillohen me kohë të plotë</li> <li>– Kohëzgjatja e studimeve është 1 vit akademik/2 semestra</li> <li>– Programi i studimit është organizuar në lëndë sipas kriteve ligjore në fuqi</li> </ul>





- Vlerësimi në kredite: 60 ECTS për vit akademik/1500 orë
- 1 ECTS = 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit
- Raporti ECTS: orë është 1 ECTS = 25 orë (Raporti 1/1.5 orë në auditor/orë studimi individual). Kohëzgjatja e orëve të mësimit është 50 minuta
- Viti akademik ka 30 javë (secili semester ka 15 javë)
- Proçesi mësimor në auditor përmban elementë të mësimit teorik, (leksione, seminare) dhe praktik (praktikë profesionale në auditor). Referuar llogaritjeve në planin mësimor (*RVB-tabela 10*), orët totale janë 1500.

<b>MP "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë"</b>	<b>Orë total</b>
<b>Në auditor</b>	<b>540</b>
- <i>Leksione</i>	<i>240</i>
- <i>Seminare</i>	<i>120</i>
- <i>Praktika profesionale në auditor</i>	<i>60</i>
- <i>Laboratorë</i>	<i>120</i>
<b>Punë e pavarur e studentit</b>	<b>960</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>1500</b>

Praktika profesionale ka 150 orë të llogaritura 60 në auditor dhe 90 në punën e pavarur të studentit.

- Kreditet e një lënde apo moduli sigurohen, kur studenti ka frekuentuar 75% të orëve teorike dhe praktike dhe kur vlerësimi në atë lëndë apo modul është kalues.
- Studentët në Programin e Studimit Master Profesional në "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë", diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose temë diplome. Departamenti përcakton pragun e notës mesatare që i jep të drejtën studentit të ciklit të dytë të diplomohet duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome.
- Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diploma Master Profesional në fushën "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë", shoqëruar me suplementin e

	<p>diplomës. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë dhe përshkruan natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve për studentin (<i>Aneks 3.5 Diploma + Suplementi i Diplomës</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit në mjedisin dinamik të shërbimit shëndetësor komunitar përmes ofrimit të ekspertizës teknike në diagnozë laboratorike. Programi i pajis studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” me njohuri të thelluara specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës në fushën e mjekësisë laboratorike. Programi synon dhe krijimin e shprehive të veçanta në specialitete si imunodiagnostika laboratorike, histopatologjia, hematologjia laboratorike, diagnostika laboratorike në mikrobiologji, biokimia e aplikuar dhe analiza e lëngjeve biologjike.</p> <p>Programi fokusohet gjithashtu në aftësimin e studentëve për implementimin dhe vlerësimin e metodave analitike, procedurë standart për sigurimin e cilësisë së punës në laborator dhe për realizimin e procesit të akreditimit laboratorik sipas ISO 15189. Programi krijon një bazë njohurish teorike në principet e diagnostikës molekulare, mjaft e rëndësishme për të kuptuar principet diagnostike në virologji, diagnozën e sëmundjeve të lindura etj.</p> <p><i>(tabelat e planit mësimor, Aneks 3.2.0-3.2.4)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është i organizuar me kohë të plotë në një vit akademik të ndarë në dy semestra në total 60 ECTS. Programi ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>Praktika profesionale, lëndë e kategorisë D zë 10% të ECTS (6 nga 60 ECTS). Ajo organizohet në 60 orë në auditor (praktikë laboratorike e mbikqyrur) dhe 90 orë punë e pavarur.</p> <p>Praktika profesionale realizohet në laboratorët e rinovuar të departamentit si dhe në laboratorët me të cilët institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Institucioni është kujdesur që</p>

	<p>bashkëpunimin në funksion të praktikës profesionale të kryejë me laboratorë që ofrojnë teknologji bashkëkohore (<i>RVB-tabela5</i>). Programi ka një syllabus të detajuar mbi organizmin e praktikës profesionale dhe vlerësimin e studentëve për praktikën. Vlerësimi bëhet nga Udhëheqësi i praktikës pranë institucionit. Detyrimet përmbyllëse kanë 6 ECTS ose 150 orë punë të pavarur. Referuar rregullores së programit të studimit (<i>Aneks III.3</i>), për të fituar diplomën në programet e studimeve “Master Profesional” studenti duhet të marrë kreditet përkatëse. Mbrojtja e temës së diplomës ose provimit përfundimtar bëhen në dy sezone: të verës dhe të dimrit, të cilët përcaktohen në strukturën e studimeve. Kandidati diplomant i cili rrëzohet në sezonin e parë ka të drejtë të riparaqitet në sezonin e ardhshëm.</p> <p>Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor “Master Profesional”, që ka kryer praktikën dhe ka mbrojtur mikrotezën ose ka marrë provimin përfundimtar, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me listën e notave të fituara gjatë viteve të studimit (<i>Aneks 3.5</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p><b>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet</p>	<p><b>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.</b></p>

<p>“Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p><b>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara. Ai ofrohet në përputhje me misionin dhe objektivat e këtij institucioni. Gjatë takimeve në institucion dhe vlerësimit të planit mësimor GVJ konstaton se programi ofron njohuri të thelluara teknike në fushat specifike të hematologjisë, kimisë klinike, mikrobiologjisë, vlerësimit të metodikave laboratorike, biologjisë molekulare etj. Në vijim të rekomandimeve të RVJ në akreditimin e parë institucioni ka ndërmarrë procedurë rishikuese-përmirësuese (<i>Aneks I.2</i>) për përmbushur plotësisht kriteret ligjore për organizimin e studimeve (VKM nr.41, datë 24.01.2018) dhe për një përshtatje më të mirë të programit me kërkesat e tregut të punës. Në takimet në institucion me anëtarë të zyrës së këshillimit të karrierës dhe pedagogët u informuam se studentë të këtij programi studimi janë punësuar jashtë vendit si teknikë laborator pas një testimi paraprak. Kurrikula e programit është pranuar (<i>takimet në institucion</i>). Në RVB dhe dokumentacionin e dorëzuar nuk ka të dhëna krahasuese me programe të ngjashme që ofrohen nga institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.</p>



<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit është kodifikuar sipas fushës së studimit nga MASR në vitin 2020 (<i>Aneks I.13</i>) Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ka një numër unik identifikimi (71MP0914S). Për këtë program studimi është kryer dhe kodifikimi i lëndëve i cili pasqyrohet në dokumentat e planit mësimor.</p> <p>(<i>Aneks 3.2.0-3.2.4</i>)</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p><b>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><b>GVJ gjykon se standardi II.1 përmbushet plotësisht.</b></p> <p><i>Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit Europian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit. Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit në mjedisin dinamik të zhvillimit të shërbimit laboratorik përmes ofrimit të ekspertizës profesionale të thelluar. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës. Programi është i kodifikuar dhe krijon mundësi për mobilitet dhe ndjekje të mëtejshme të studimeve të ciklit të dytë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi II.2**





**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara që ofron programin e studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>KU Logos është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, date 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e institucionit dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në Tiranë. Organet drejtuese dhe akademike janë senati akademik, këshilli i etikës, rektorati, dekanati, asambleja e stafit akademik, komisionet e përhershme. Autoritet drejtuese akademike janë rektori, dekanët, drejtuesit e njësisë bazë. Organet administrative janë bordi i administrimit, administratori i universitetit, njësi kryesore. <i>(Aneks Nr.2)</i></p> <p>KU Logos ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në vitin 2017 dhe riakredituar në nivel institucional në vitin 2021 me vendim të BA nr.58, datë 16.12.2021, për një periudhë 4 vjeçare. Departamenti i Shkencave Mjekësore ofron dy programe studimi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Programi Bachelor në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”</li> <li>2. Programi Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”</li> </ol> <p>Të dy programet janë akredituar në vitet 2018 dhe 2019 dhe janë në proces riakreditimit periodik nga institucionet përgjegjëse. Programi Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është akredituar për një periudhë 5 vjeçare me Vendim Nr.49 datë 13.07.2018 të Bordit të Akreditimit <i>(Aneks 0/5)</i>. Bordi i Akreditimit ka lënë tre rekomandim/sugjerime për këtë program studimi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. përmirësimin e syllabuseve duke rishikuar shpërndarjen e krediteve në raport me format e mësimdhënies si dhe rishpërndarjen më të mirë duke shtuar peshën specifike të disiplinave të ngjashme dhe të integruara.</li> </ol>

2. Ngritjen e një sistemi të informatizuar në funksion të stafit dhe studentëve në kuadër të realizimit cilësor dhe efektiv të procesit mësimor.
3. Institucioni të shikojë mundësinë e pasurimit të laboratorëve me paisje të reja bashkëkohore për realizimin sa më të mirë të orëve praktike/laboratorike.

GVJ vlerëson se rekomandimet janë plotësuar nga institucioni. Programi ka pësuar ndryshime përmirësuese në masën 20% në strukturimin dhe emërtimin e lëndëve duke shtuar peshën specifike të orëve praktike në funksion të përgatitjes më të mirë profesionale (*RVB-tabela 11*). Në përmbushje të rekomandimit të dytë institucioni ka përmirësuar infrastrukturën e sallave të leksioneve dhe seminareve me mjete të teknologjisë së informacionit si dhe ka adaptuar përdorimin e platformave on-line mjaft të rëndësishme sidomos në periudhën e pandemisë. Në përmbushje të rekomandimit të tretë institucioni ka riorganizuar 4 laboratorët në vendndodhjen e re (kati i dhjetë i godinës) sipas profilit duke i paisur me aparatura të reja bashkëkohore në funksion të programit të studimit (*takimet dhe vizita në institucion*).

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Shkencave Mjekësore. Referuar tabelave 1 dhe 2 të RVB, në vitin akademik 2022 – 2023, njësia bazë përbëhet nga **6 anëtarë PAE** dhe përfshin në mësimdhënie **dhe 2 anëtarë PAK**. Kualifikimi i personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie është:

- PAE: 2 anëtar i kategorisë Profesor, 1 anëtar i kategorisë Prof.Asc., 2 anëtarë të kategorisë Doktor i Shkencave dhe 1 anëtar me Master Shkencor dhe Diplomë Specializimi Pasuniversitar.
- PAK: 1 anëtar i kategorisë Profesor, dhe 1 anëtar i kategorisë Prof.Asc:

Të dhënat e departamentit gjatë tre viteve akademike janë si më poshtë vijon:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK



	Prof.Dr.	3	1	2	1	2	1
	Prof. Asoc.	0	0	1	1	1	1
	Dr./PhD.	1	1	2	0	2	0
	Msc.	2	0	1	0	1	0
	<b>Totali</b>	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>2</b>
	<p>PAK janë personel të angazhuar me kohë të plotë në institucione Shëndetësore si Universiteti i Mjekësisë, QSUT dhe Instituti i Shëndetit Publik. Lidhur me treguesit e moshës, pjesa më e madhe e stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie që kanë tituj akademikë i përkasin grup moshës mbi 66 vjeç. Lektorët me gradën Doktor i përkasin grupmoshës 36 – 55 vjeç. Nga analiza e tabelave mbi shpërndarjen e ngarkesës mësimore të programit rezultojnë se rreth 80% e ngarkesës përballohet nga PAE (<i>RVB-tabela 12</i>).</p>						
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Departamenti i Shkencave Mjekësore kanë angazhuar në këtë program studimi dhe 2 staf ndihmës akademik (MP) që asistojnë studentët në realizimin e punëve laboratorike në mjediset e institucionit.</p> <p>Në funksion të programit të studimit janë dhe personeli administrativ. Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës administrativ dhe teknik dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione punë.</p> <p><i>(RVB-tabela 2, takimet në institucion)</i></p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Programet e studimit të Departamentit të Shkencave Mjekësore Bachelor dhe Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” kanë një koordinator staf akademik me kohë të plotë që ka formimin dhe kualifikimin e duhur për të kryer këtë funksion(<i>Aneks VIII/7</i>).</p> <p>Koordinatori i programit përgjigjet për organizimin dhe realizimin e programit mësimor dhe praktikës profesionale, përgatitjen e syllabuseve sipas një formati të miratuar dhe raporton rregullisht tek dekani i FM. Institucioni dëshmon angazhim serioz të personelit mësimor-shkencor me kohë të plotë, për mbikëqyrjen e studentëve gjatë kryerjes së praktikave laboratorike në auditor dhe mirëmbajtjen e mjedisve laboratorike dhe shkollore. Kjo u</p>						


	konstatua gjatë vizitës në institucion të GVJ dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor.			
<b>Konkluzione</b>	<p><b>GVJ konstaton se kriteri II.2 përmbushet plotësisht.</b></p> <p><i>KU Logos, Fakulteti i Shkencave të aplikuara dhe Departamenti i Shkencave Mjekësore që ofrojnë programin e studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” përmbushin kërkesat ligjore dhe standartet e cilësisë për ofrimin e tij. Stafit akademik përbëhet nga një numër optimal pedagogësh PAE dhe PAK, me kualifikime dhe specializime në fushën e mjekësisë laboratorike e më gjerë. Në funksion të programit të studimit institucioni ka angazhuar dhe personel ndihmës akademik, personelin administrativ dhe ndihmës. Në përmbushje të kërkesave ligjore departamenti ka caktuar dhe një koordinator përgjegjës për programin e studimit që veç të tjerash siguron lidhjen dhe shpërndarjen harmonike të studentëve në institucionet e kryerjes së praktikës.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Departamenti i Shkencave Mjekësore në KU Logos që ofron programin e studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” disponon gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Informacioni detajohet në Rregulloret e Fakultetit, Departamentit dhe në Rregulloren e Programit të Studimit (<i>Aneks II/3.1-3.3</i>).</p> <p>Në dosjen e programit që GVJ ka në dispozicion kemi gjetur informacionin për institucionin dhe për strukturën e programit të studimit, informacion për strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm formues të programit, të dhënat për personelin akademik për realizimin e programit, planin mësimor, të dhëna për infrastrukturën në</p>

	<p>dispozicion të programit, kriteret e pranimit, rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve dhe suplementin i diplomës.</p> <p>Me fillimin e vitit akademik programi i studimit dhe syllabuset ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi. Informacioni i përmbledhur gjendet në faqen web të institucionit si dhe në materialet informuese të publikuara nga institucionit. Në takimin me stafin dhe drejtuesit e institucionit u informuam për përfshirjen aktive të stafit në përgatitjen e RVB dhe hartimin e dokumentacionit bazë dhe mbështetës për procesin e akreditimit.</p> <p><i>(Dosja e programit të studimit, takimet në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është i organizuar në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar. Programi organizohet në lëndë /module dhe praktikë mësimore në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në planin mësimor detajohet tipi i veprimtarisë formuese, ngarkesa në auditor për secilën lëndë (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika mësimore), ECTS, semestri në të cilin zhvillohet lënda, orët e studimit individual dhe orët totale.</p> <p>Programi zhvillohet në një vit akademik, 2 semestra dhe ka në total 60 ECTS ose 150 orë mësimore prej të cilave 540 orë në auditor dhe 960 orë studimi individual.</p> <p>GVI gjykon se raportet e veprimtarive formuese në auditor janë të arsyetuara sipas tipologjisë së lëndës. <i>(RVB- tabelat 9,10 dhe plani mësimor)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e Departamentit të Shkencave Mjekësore dhe Rregullorja e programit të studimit i sigurojnë studentit informacionet e nevojshme mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve <i>(Aneks II/3.1-3.3)</i>.</p> <p>Në takimet me sekretarinë mësimore dhe studentët, GVI konstatoi se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë dhe të përditësuar për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Institucioni aplikon kriteret specifike të pranimit që vendosen me VKM dhe rregulloren e KU Logos. KU Logos synon të tërheqë në</p>



	<p>programet e studimeve “Master Profesional” studentë, të cilët demonstrojnë aftësi për të punuar dhe kreativitet. Kandidati për Programet e Studimeve “Master Profesional” duhet të zotërojë një diplomë të pranueshme universitare në fushat përkatëse të Programit Master ose të përafërt me të, me rezultate në nivelin e kërkuar. Informacioni për kriteret dhe procedurat e pranimit publikohet në faqen e inrernetit të institucionit, në median e shkruar dhe elektronike si dhe në paketën e informacionit të studimeve master (<i>Aneks I/1, faqja web</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë. Syllabuset janë formatuar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Syllabuset janë të firmosura nga titullari i lëndës.</p> <p>Në syllabuse gjendet i detajuar informacioni për tipologjinë e lëndës, kreditet, shpërndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij, vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda. Syllabusi jep informacion për lëndën, objektivat dhe rezultatet e pritshme. Temat, literatura referuese dhe format e mësimdhënies janë detajuar sipas javëve. Çdo syllabus ka informacion për frekuentimin (i detyruar në masën 75%) dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm: 30% e notës përfundimtare sigurohet nga kontrolli i ndërmjetëm, 10% nga aktivizimi, 60% nga provimi përfundimtar.</p> <p>Në syllabuse është specifikuar literatura bazë dhe literatura e rekomanduar. GVJ rekomandon rifreskimin dhe përditësimin e literaturës së rekomanduar.</p> <p><i>(Aneks 3.2.0-3.2.4 plani mësimor dhe syllabuset)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>GVJ konstaton se programi Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është riorganizuar sipas kërkesave të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Pas akreditimit të parë, ky program studimi ka pësuar ndryshime në masën 20% për t’u përshtatur më mirë me kërkesat ligjore (raportet teori/praktikë, raportet e lëndëve sipas tipologjive) dhe kërkesat e tregut të punës (<i>RVB-tabela 11, planet mësimore</i>). Ndryshimet janë si më poshtë:</p>





	<p>5. Lënda Bakteriologji klinike e avancuar (tipologji B me 6 ECTS) u riorganizua në Diagnostika laboratorike në mikrobiologji (tipologji B me 7.5 ECTS). Riorganizimi ka synuar shtimin e orëve të praktikës laboratorike.</p> <p>6. Lënda Kimi klinike (4 ECTS tipologji A) u riorganizua në Vlerësim i metodave të analizës në laboratorë mjekësorë (6 ECTS, tipologji C).</p> <p>7. Gjashtë lëndë janë riemërtuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Hematologji klinike e avancuar u bë Hematologji laboratorike</li> <li>Imunologji klinike e avancuar u bë Imunodiagnostikë laboratorike</li> <li>Biokimi klinike e avancuar u bë Biokimi e aplikuar</li> <li>Analiza klinike e avancuar e gjakut dhe urinës u bë Analiza e lëngjeve biologjike</li> <li>Histopatologjia klinike e avancuar u bë teknika të histopatologjisë klinike</li> <li>Biologjia molekulare e avancuar u bë Diagnostika molekulare në laboratorë mjekësorë.</li> </ol> <p>Hartimi dhe implementimi i planeve strategjike afatgjata në mënyrë të natyrshme kërkon përshtatje dhe harmonizim të programeve të studimit. Programi dhe syllabuset e përditësuara miratohen dhe arkivohen në department çdo fillim viti.</p>			
	<p><b><i>GVJ konstaton se Standardi II.3 përmbushet plotësisht</i></b></p> <p><i>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit Master Profesional. Titullarët e lëndëve janë personalitete të spikatur të fushës si dhe mjekë të rinj të kualifikuar. Institucioni Synon përmirësim të programit në përmbajtje, literaturë e veçanërisht në implementim të metodologjive të reja mësimdhënëse të mundësuar dhe nga investimet në mjete audiovizive në auditorë si dhe investimet në laboratorë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi II.4**

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Misioni i Programit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë në një stad më të lartë dijet e fituara në programin e ciklit të parë Bachelor përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor. Si dhe të formojë specialistë të lartë në fushën Laboratorike Mjekësore në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit <i>(Rregullore e programit të studimit)</i>.</p> <p>Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fushat e veçanta të Laboratorit Mjekësor të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Numri i lartë i orëve të praktikave profesionale (6 ECTS) i bëjnë studentët të aftë për manipulim dhe punë të pavarur në fushën e laboratorit mjekësor. Gjatë vizitës në ambientet e rinovuara të laboratorëve mjekësorë, GVJ u njoh me politikën e institucionit për t’i vënë këto hapësira në funksion të trajnimit dhe mësimdhënies edhe jashtë orareve të programit mësimor.</p> <p><i>(RVB-tabelat 9, 10, Aneks II/3.2.0-3.2.4, plani mësimor, vizita në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre. Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orë mësimore përputhet me profilin e programit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”. Në program janë përfshirë lëndë specifike të diagnostikës laboratorike në hematologji, biokimi të aplikuar, histopatologji, mikrobiologji. Programi e pais studentin me informacione teoriko-praktike dhe për metodat e avancuara të diagnostikës laboratorike që përdoren në të gjitha fushat e mësipërme si imunodiagnostika, diagnostika molekulare apo analiza e lëngjeve biologjike. Duke ndjekur stadin aktual të</p>

	<p>zhvillimit të laboratorëve mjekësorë dhe nevojën për standartizim dhe akreditim të tyre, programi i pais studentët me njohuri mbi vlerësimin e metodave të analizës. Programi zhvillohet në një vit akademik dhe përmban 60 ECTS të grupuara sipas skemës së mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A: Lëndë bazë 4.5 ECTS / 7.5% (5 – 10%)</li> <li>- Kategoria B: Lëndë karakterizuese 31.5 ECTS / 52.5% (30 – 40%)</li> <li>- Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 12 ECTS / 20% (20 – 30%)</li> <li>- Kategoria D: Lëndë plotësuese 6 ECTS / 10% (10%)</li> <li>- Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 6 ECTS / 10% (10 – 20%)</li> </ul> <p>Numrin më të madh të ECTS e kanë lëndët karakterizuese me karakter profesional. GVJ konstaton se për këtë kategori, ka një shmangie nga kërkesat e përcaktuara në VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Objektivat e programit të studimit të shkruara në rregulloren e tij janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- T’u japë studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve Bachelor njohuritë më të avancuara teorike në fushën e zhvillimit të programit, mbështetur në metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme dhe ato të avancuara.</li> <li>- të rrisë shprehitë praktike të studentëve duke i aftësuar më tej si specialistë në fushat e laboratorëve klinik, biokimik, mikrobiologjik dhe histopatologjik.</li> <li>- Të përgatisë specialistë të laboratorit të aftë të përdorin teknologjinë bashkëkohore në laboratorët mjekësorë.</li> <li>- Të përgatisë studentë të aftë për të vazhduar studimet universitare master shkencor duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.</li> </ul> <p>Për realizimin e këtyre objektivave, programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është strukturuar dhe përmirësuar bazuar në eksperiencën e gjatë të ofrimit të programeve në fushën e Laboratorëve Mjekësorë nga KU Logos si dhe mbështetur në modelet dhe praktikatat më të mira të institucioneve partnere të arsimit të lartë. Struktura e programit,</p>



	<p>emërtimi, raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e profesionit dhe me programet europiane (<i>RVB-tabelat 9, 10, Aneks II/3.2.0-3.2.4</i>). Në takimin me zyrën e projekteve GVJ u informua se KU Logos synon aktivizimin e projekteve-marrëveshje për mbështetje të mësimdhënies dhe forcim të kapaciteteve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Strukturimi i programit, unifikimi i termave të programit me programet europiane i bën studentët konkurren në tregun e punës publik e privat, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Ndarja në kategori sipas veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre bazuar në legjislacionin në fuqi, ngjashmëria e programit me programe në IAL të tjera, ndikon në arritjen e objektivave të programit dhe transferimin, mobilitetin e studentëve në programe të tjera studimi të ngjashme. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij, ju krijon mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat brënda dhe jashtë vëndit.</p> <p>Sipas të dhënave të pasqyruara në RVB (<i>RVB-Tabela 23</i>) 88% e të diplomuarve në tre vitet e fundit janë të punësuar ndërkohë që 69% e të diplomuarve janë punësuar në profesion. Në takimin me studentët u theksua se në vitet e fundit është shtuar oferta e punës me kontribut dhe të institucioneve partnere në kryerjen e praktikës profesionale. GVJ u informua se studentë të këtij programi kanë mundur të punësohen jashtë Shqipërisë (në Angli dhe në Kanada). Ata i janë nënshtruar vetëm testimit të liçencës. (<i>takimet në institucion</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e programit të studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar përputhje të kompetencave të të diplomuarve me kërkesat e tregut të punës (<i>referuar tek standardi II.3, kriteri 5</i>).</p> <p>Institucioni inkurajon përditësimin e vazhdueshëm të programit të lëndëve me literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Mbështetur në literaturë bashkëkohore, pedagogët e këtij programi studimi pregatisin leksione dhe materiale didaktike të shkruara për studentët. Këto materiale janë përdorur me efikasitet veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë dhe mësimin on line. Pedagogët A. Sallabanda dhe S. Buzo kanë botuar tituj të ri librash në fushën e diagnozës laboratorike. Literatura e rekomanduar është përgjithësisht në gjuhë të huaj.</p>

	<i>GVJ rekomandon rishikimin dhe përditësimin e saj në disa prej syllabuseve. (Aneks II/3.2.0-3.2.4, takimet në institucion).</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”. Strukturimi i programit krijon mundësi për transferim të studimeve dhe mobilitet. Studenti i diplomuar në këtë program studimi mund të punojë në laboratorë të profilit biokimik, mikrobiologjik, histopatologjik, hematologjik. Ai mund të bëhet pjesë e stafeve teknike që merren me implementimin e vlerësimit të metodave dhe kontrollit të cilësisë. Studenti merr gjithashtu një përgatitje të mirë teorike në fushën e diagnostikës molekulare ( <i>RVB-tabelat 9, 10, Aneks II/3.2.0-3.2.4</i> ).			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit është strukturuar dhe përmirësuar nga specialist të spikatur të fushës së mjekësisë laboratorike. Përmbajtja e programit të studimit iu mundëson studentëve vijimin e studimeve në Master Shkencor. Përgatitja teorike është në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Praktika profesionale është një mundësi për njohjen e studentit me realitetin e profesionit dhe përfitimin direkt nga ofertat e tregut të punës. Në takimet në institucion u informuam se nga 13 studentë të diplomuar vitin e shkuar, 9 janë punësuar brenda profilit në institucionet bashkëpunuese.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ gjykon se Standardi II.4 përmbushet plotësisht.</i> <i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Në program ka një harmonizim të mirë të lëndëve të formimit bazë e karakterizues me praktikën profesionale.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Institucioni është investuar në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit Master Profesional në “Teknikë e lartë në Laboratorë Mjekësorë” në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Komunikimi me laboratorët partnerë, organizimi i ëorkshop-eve për teknikat bashkëkohore laboratorike në bashkëpunim me to, tërheqja e opinionit të studentëve të diplomuar kanë qenë shtysa të rëndësishme për modifikimin dhe strukturën së programit, shtimin e orëve të praktikës dhe veçanërisht orëve që realizohen pranë laboratorëve bashkëpunues në mjedise reale të punës së teknikut të laboratorit.</p> <p>Në takimet me drejtuesit e institucionit dhe personelin akademik GVJ u informua se përmes analizave dhe debatit shkencor në nivel Departamenti dhe Fakulteti diskutohen dhe aplikohen ndryshimet përmirësuese të programeve me kontributin e pedagogëve të përfshirë në mësimdhënie dhe profesorëve të ftuar.</p> <p>Mobiliteti dhe pjesëmarrja në projekte ka bërë që stafi akademik të njihet dhe të aplikojë më mirë programe bashkëkohore që përshtasin programet aktuale me kërkesat e tregut të punës dhe me kërkesat e kartës së Bolonjës. Në takimin me përfaqësues të zyrës së karrierës dhe marrdhënieve me jashtë RVB u informua se institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me universitete të hapësirës ballkanike (Greqi, Rumani, Bullgari) e më gjerë (Hungari, Austri) dhe bashkëpunime në kuadër të projektit Erasmus+. KU Logos synon trajnimin dhe aftësimin e stafit akademik përmes shkëmbimit të eksperiencave jo vetëm profesionale por dhe organizative në kuadër të programeve të studimit që mbulon.</p> <p><i>(Takimet në institucion, Aneks VIII/3, V/5, RVB-tabela 5).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime</p>	<p>Pjesë e rishikimit apo përditësimit të programit mësimor janë dhe propozimet e bëra nga studentët e programit të cilët janë në</p>

<p>studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>proçes ose ata që kanë mbaruar ciklin e studimit. Mbështetja e studentëve dhe përfshirja e tyre në përmirësimin e programeve realizohet me anë të përfshirjes së studentëve në bordin e administrimit, këshilli studentor, senatin akademik. Duke qënë pjesë e vendimarrjes ata ndikojnë dhe në përmirësim të programit të studimit. Institucioni përdor mekanizma të ndryshme për marrjen e mendimit të studentëve për programin mësimor si plotësimi i përvitshëm pyetësorëve. Një anë pozitive është përfshirja në këto konsultime edhe e studentëve të punësuar në struktura laboratorike.</p> <p>Institucioni ka një databaze për studentët që ndjekin studimet në programet e studimit si dhe për studentët e diplomuar prej të cilëve merr dhe informacion për kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë në punësimin e studentëve. Faqja Alumni në web-in e KU Logos është gjithashtu një pikë takimi dhe diskutimi për problematika që lidhen me programin e studimit. <i>(Aneks VIII/9, faqja web, takimet në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Mjekësore, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” ka realizuar një ndryshim përmirësues në përputhje me zhvillimet e fundit të teknologjisë dhe konceptimit të laboratorëve mjekësorë. Eksperienca dhe profesionalizmi i pedagogëve efektivë dhe të ftuar, anëtarë të shoqatave të mjekësisë laboratorike ka ndikuar në përfshirjen në studim të elementëve të vlerësimit të metodikave, të automatizimit, të biologjisë molekulare etj.</p> <p><i>(RVB-tabelat 9, 10, takimet në institucion)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><b><i>GVJ gjykon se standardi II.5 përmbushet plotësisht.</i></b></p> <p><i>Institucioni ka krijuar kushte për përmirësim dhe përditësim të programeve të studimit në përputhje me kërkesat e kohës.</i></p> <p><i>Departamenti çdo fillim viti akademik bën përditësimin e programit të studimit për përshtatjen më të mirë të tij me kërkesat e tregut të punës. Institucioni përfshin në proçesin e rishikimit të kurrikulave studentët me anë të mekanizmave të ndryshme si plotësimi i përvitshëm i pyetësorëve, përfshirjen e përfaqësuesve të tyre në senatin akademik, këshillin studentor. Një anë pozitive</i></p>



	<p>është përfshirja në këto konsultime edhe e studentëve të punësuar në struktura shëndetësore. Në përmirësimin e përditësimit e programit të studimit në përputhje me zhvillimet e fundit të teknologjisë kanë impakt pozitiv eksperiencia dhe profesionalizmi i pedagogëve efektivë dhe të ftuar të përfshirë në këtë program studimi si dhe politika e trajnimit të stafit në institucionet universitare bashkëpunuese e ndjekur nga KU Logos sidomos për stafin e ri në moshë.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.6

**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.**


<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në planin strategjik të zhvillimit të KU Logos për periudhën 2018 – 2024 theksohet se misioni i tij është t'i shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimimit, hulumtimit, inovacioneve; nxitjes së zhvillimit individual për transformimin e jetëve, sigurimin e suksesit të studentëve në një mjedis global, ofrimin e shërbimeve akademike dhe zhvillimin e një komuniteti të larmishëm dhe gjithëpërfshirës. Në këtë plan përcaktohen dhe prioritetet strategjike ku veç zhvillimit institucional, renditen përmbushja e standarteve akademike, kërkimi, partneriteti, ndërkombëtarizimi dhe sigurimi i cilësisë. <i>(Aneks No.4)</i></p> <p>Prioritetet strategjike të institucionit janë përkthyer në objektiva të qartë në rregulloren e programit të studimit. Në nenin 5 të rregullores theksohet se objektivat formues të Programit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. t’u japë studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve Bachelor njohuritë më të avancuara teorike në fushën e zhvillimit të programit, mbështetur në metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme dhe ato të avancuara.</li> <li>2. të rrisë shprehitë praktike të studentëve duke i aftësuar më tej si specialistë në fushat e laboratorëve klinik, biokimik, mikrobiologjik dhe histopatologjik.</li> </ol>



	<p>3. të përgatisë specialistë të laboratorit të aftë të përdorin teknologjinë bashkëkohore në laboratorët mjekësorë.</p> <p>4. të përgatisë studentë të aftë për të vazhduar studimet universitare master shkencor duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale. <i>(Aneks II/3.3)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore dhe bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin e mësimdhënies, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencor duke respektuar opinionet, idetë dhe metodat në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik dhe krijues të procesit të mësimdhënies, aktivitetit kërkimor shkencor dhe veprimtarive të tjera akademike. Institucioni organizon dhe leksione të hapura me personalitete nga fusha të ndryshme të mjekësisë dhe mjekësisë laboratorike të cilët bashkëbisedojnë më pedagogët dhe studentët për problematika të veçanta lidhur me profesionin. <i>(Aneks II/1, takimet në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Në statutin e KU Logos theksohet se institucioni synon t'i japë shoqërisë shkencëtarë të formuar që punojnë në mënyrë krijuese për përparimin e saj. Programi i studimit i motivon studentët të përfshihen në punë të mirëfilltë kërkimore që kontribuon në formimin profesional dhe shkencor. Departamenti i Shkencave Mjekësore promovon pjesëmarrjen e studentëve në seminare, ëorkshope, konferenca shkencore apo trainuese. Pedagogët dhe udhëheqësit shkencorë i mbështesin studentët për prezantimin e këtyre punimeve në Konferencën shkencore studentore të organizuar nga KU Logos si dhe në konferenca kombëtare. <i>(Aneks V)</i></p> <p>Në tabelën 22 të RVB evidentohet se 4 studentë të këtij programi studimi janë përfshirë në punime shkencore individuale të pedagogëve dhe 1 student ka përfituar nga projekti i mobilitetit Erasmus+. Në takimet në institucion u informuam se kalimi i situatës së pandemisë e cila uli mundësitë e bashkëpunimit në laborator dhe auditor, përmirësimi i teknologjisë së laboratorëve të institucionit si dhe marrëveshjet me laboratorë partnerë do të shtojnë përfshirjen e studentëve në punime të pedagogëve dhe në përgatitjen e projekteve shkencore për referim dhe publikim. <i>(RVB-tabela 22, takimet dhe vizita në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore,</p>	<p>Në tabelat e buxhetit për vitet 2020 – 2023, konstatohet se institucioni mbështet financiarisht kualifikimin dhe aktivitetin shkencor të pedagogëve. Institucioni ka parashikuar në buxhet</p>

<p>njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>shpenzime për pjesmarje në aktivitete shkencore mjekësore ndërkombëtare, mbështetje financiare për botime në revista me faktor impakti, mbështetje financiare për lektorët e huaj të ftuar si dhe fondo për organizim të konferencave dhe workshop-eve. <i>(Aneks IX/6, 6.1)</i></p> <p>Në takimin me stafin akademik dhe përfaqësuesit e zyrës së këshillimit të karrierës dhe marrëdhënies me jashtë u theksua se institucioni inkurajon pjesmarrjen e stafit në trajnime në universitetet partnere si dhe aplikimin për projekte mobiliteti dhe projekte kërkimore-shkencore. Për periudhën 2018 – 2022 stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi ka 15 publikime shkencore, 5 aktivitete shkencore të organizuara dhe 49 pjesmarrje në aktivitete shkencore, 15 prej të cilave në aktivitete ndërkombëtare. Gjatë vitit 2022 – 2023 ka patur dhe 10 leksione me lektorë të huaj <i>(RVB-tabelat 19, 20, takimet në institucion)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><b><i>GVJ gjykon se standardi II.6 përmbushet plotësisht.</i></b></p> <p><i>Njësia kryesore/bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin e mësimdhënies, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencore. Institucioni organizon dhe leksione të hapura me personalitete nga fusha të ndryshme përfshirë dhe mjekësinë të cilët bashkëbisedojnë me pedagogët dhe studentët për problematika të veçanta lidhur me profesionin. Institucioni mbështet financiarisht stafin akademik në aktivitetin kërkimor shkencor në funksion dhe të promovimit të titujve akademikë. Program i studimit i motivon studentët të përfshihen në punë të mirëfillta kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.7</b></p>	
<p><b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet</b></p>	<p>KU Logos i kushton një rëndësi të veçantë harmonizimit të aktivitetit mësimor me atë kërkimor shkencor ku një vëmendje e</p>



<p>lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>veçantë i kushtohet përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor. Institucioni ka investuar për ndërtimin e ambienteve të paisura me teknologji të përparuar prezantimi dhe përkthimi për realizimin e konferencave dhe workshop-eve me pjesmarrje të lektorëve vendas dhe të huaj.</p> <p>Njësia kryesore dhe njësia përgjegjëse e programit të studimit mbështesin përmes promovimit dhe financimit veprimtarinë kërkimore – shkencore dhe publikimin e punës shkencore të pedagogëve. Departamenti ka siguruar bashkëpunim me struktura laboratorike që ofrojnë ekspertizë të lartë diagnostike si dhe ka fuqizuar teknologjinë laboratorike në laboratorët e institucionit në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Të dhënat e kualifikimit periodik pasqyrohen dhe në raportin vjetor të institucionit dhe paketën e vlerësimit të pedagogut. <i>(Aneks IV/6, V/1)</i></p> <p>Në takimet me drejtuesit e Fakultetit/Departamentit dhe stafin akademik u informuam për inkurajimin dhe mbështetjen që jep institucioni për përfshirjen e stafit në programet ndërkombëtare të mobilitetit apo për përfshirjen në projekte kërkimore të përbashkëta si partnerë. <i>(Aneks IX/5, VII/3, takimet në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të kërkimit shkencor Departamenti ka ngritur grupin e kërkimit shkencor për të dy programet e studimit <i>(Aneks V/3)</i>. Stafi i departamentit është i përfshirë në projektet e Komisionit Europian (Oasis, Roaming, Magnet) me fokus kryesisht rritjen e kapaciteteve për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Stafi akademik i programit të studimit është trajnuar në kuadër të këtyre projekteve. <i>(Aneks VII/6, 7)</i></p> <p>Zyra e këshillimit të karrierës dhe marrëdhënieve me jashtë ka realizuar një seri marrëveshjesh përmes të cilave inkurajohet jo vetëm trajnimi i personelit akademik dhe studentëve por dhe pjesmarrja e tyre direkte në projekte kërkimore të përbashkëta numri i të cilave është ende i vogël në rang institucioni. <i>(Takimet në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon</p>	<p>Pjesë e rëndësishme e aktivitetit mësimor dhe kërkimor shkencor është organizimi i konferencave dhe aktiviteteve trainuese që ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave të</p>

<p>konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>programit të studimit. KU Logos ka krijuar një traditë në organizimin e konferencave studentore (<i>Aneks V</i>). Në takimet në institucion GVJ u informua se Departamenti ka realizuar me sukses një seri trajnimesh on line me fokus sfidat e diagnozës laboratorike në situatën pandemike Covid-19. Po ashtu për njohjen e studentëve me teknologjitë e avancuara laboratorike departamenti ka realizuar workshop-e dhe takime informuese me laboratorë dhe partnerë të industrisë me qëllim aftësimin profesional të studentëve të programit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”. (<i>Takimet në institucion</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” bazuar në objektivat dhe misionin e tij synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e teknikës laboratorike mjekësore dhe përgatitjen e specialistëve të aftë për ofrimin e shërbimit cilësor në këtë fushë. Programi e arrin këtë nëpërmjet aftësimin dhe kompetencës profesionale, zhvillimit të aftësive të komunikimit për t’u përshtatur me tregun e punës brenda vëndit apo jashtë tij.</p> <p>Kryerja e praktikave profesionale dhe mbrojtja e temave të diplomës bazuar në studime të kryera me raste të marra në laboratorët e praktikës përbëjnë një bazë të mirë kurrikulare për njohjen dhe punësimin e studentëve të këtij programi studimi në laboratorët partnerë por dhe më gjerë në laboratorë të sistemit publik dhe privat. Në takimet në institucion u referua gjithashtu se studentë të këtij programi studimi janë punësuar edhe jashtë Shqipërisë. (<i>Aneks 3.2, 3.5, takimet në institucion</i>)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Referuar Shtojcës 1 të Vendimit Nr.649, datë 14.9.2011 “Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara” (i azhurnuar me: VKM Nr.827, dt. 07.10.2015) profesioni i teknikut të laboratorit hyn në profesionet e rregulluara.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është program kualifikimi që ofrohet për studentë që kanë përfunduar ciklin e studimeve Bachelor në të njëjtën fushë pas të cilit liçensohen në profesion.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e</p>	<p>Programi Bachelor në të njëjtën fushë i ofruar nga KU Logos përputhet me aktet ligjore kombëtare dhe të BE për profesionet e rregulluara. Ai ofron studim trevjeçar teoriko-praktik siç</p>



<p>rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>kërkohet në nenin 40 të <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>.</p> <p>Departamenti i Shkencave Mjekësore në KU Logos bashkëpunon me Urdhërin e Infermierit, institucionin përgjegjës për liçensimin e Teknikëve të Laboratorit në Shqipëri për përmirësimin e kurrikulës universitare dhe përfshirjen në program të rekomandimeve lidhur me kompetencën e fituar profesionale.</p>
--	--

<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><b>GVJ gjykon se standardi II.7 përmbushet plotësisht.</b></p> <p><i>KU Logos harmonizon aktivitetin mësimor me atë kërkimor shkencor dhe ka në fokus përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor. Institucioni ka investuar për ndërtimin e ambienteve të paisur me teknologji të lartë dhe mbështet aplikimet dhe fitimin e projekteve të financuar nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare. Programi studimit ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për rritjen e kapaciteteve profesionale në fushat e testimit biokimik, hematologjik, histopatologjik, mikrobiologjik, imunodiagnostik si dhe për zhvillimin e aftësive të komunikimit të nevojshme për tu përshtatur me tregun e punës brënda vëndit apo jashtë tij. Njësia kryesore dhe njësia përgjegjëse e programit të studimit mbështesin përmes promovimit dhe financimit veprimtarinë kërkimore – shkencore dhe publikimin e punës shkencore të pedagogëve.</i></p>
---------------------------	--

<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1




**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Për zhvillimin e procesit mësimor, Rregullorja e Programit të studimit përcakton përdorimin e metodave të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika në laboratorët e departamentit, praktika profesionale në laboratorët bashkëpunëtorë. Forma të tjera që përdoren në këtë program studimi janë përgatitja e detyrave të kursit, temat e diplomave, puna kërkimore në laborator, si dhe leksionet e hapura të organizuara nga departamenti. Institucioni inkurajon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve në konferenca, trajnime dhe ëorkshop. <i>(Aneks II/3.3)</i></p> <p>Në organizimin e studimeve një vend të rëndësishëm ze dhe puna e pavarur e studentit (64% e orëve totale ose 960).</p> <p>Tabela e mëposhtme paraqet informacion më të detajuar të përmbledhur nga tabela e planit mësimor <i>(RVB-tabela 10)</i>.</p> <table border="1" data-bbox="608 1084 1390 1585"> <thead> <tr> <th data-bbox="608 1084 1198 1182">MP "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë"</th> <th data-bbox="1198 1084 1390 1182">Orë total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="608 1182 1198 1238"><b>Në auditor</b></td> <td data-bbox="1198 1182 1390 1238"><b>540</b></td> </tr> <tr> <td data-bbox="608 1238 1198 1294">- <i>Leksione</i></td> <td data-bbox="1198 1238 1390 1294">240</td> </tr> <tr> <td data-bbox="608 1294 1198 1350">- <i>Seminare</i></td> <td data-bbox="1198 1294 1390 1350">120</td> </tr> <tr> <td data-bbox="608 1350 1198 1406">- <i>Praktika profesionale në auditor</i></td> <td data-bbox="1198 1350 1390 1406">60</td> </tr> <tr> <td data-bbox="608 1406 1198 1462">- <i>Laboratorë</i></td> <td data-bbox="1198 1406 1390 1462">120</td> </tr> <tr> <td data-bbox="608 1462 1198 1518"><b>Punë e pavarur e studentit</b></td> <td data-bbox="1198 1462 1390 1518"><b>960</b></td> </tr> <tr> <td data-bbox="608 1518 1198 1585"><b>Gjithsej</b></td> <td data-bbox="1198 1518 1390 1585"><b>1500</b></td> </tr> </tbody> </table>	MP "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë"	Orë total	<b>Në auditor</b>	<b>540</b>	- <i>Leksione</i>	240	- <i>Seminare</i>	120	- <i>Praktika profesionale në auditor</i>	60	- <i>Laboratorë</i>	120	<b>Punë e pavarur e studentit</b>	<b>960</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>1500</b>
MP "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë"	Orë total																
<b>Në auditor</b>	<b>540</b>																
- <i>Leksione</i>	240																
- <i>Seminare</i>	120																
- <i>Praktika profesionale në auditor</i>	60																
- <i>Laboratorë</i>	120																
<b>Punë e pavarur e studentit</b>	<b>960</b>																
<b>Gjithsej</b>	<b>1500</b>																
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në takimet në institucion me personelin akademik dhe me studentët GVJ u informua se personeli akademik ka përvojë dhe ofron për studentët mënyra e metoda alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies në përputhje me nevojat e tyre. Në orën e mësimit përdoren metoda alternative si prezantime në ppt., biseda interaktive me studentët, demonstrimi i procedurave praktike laboratorike, ushtrime me raste klinike, demonstrime në mikroskop. Studentët punojnë në grupe të vogla në laborator. Në orët e mikroskopisë pedagogu orienton</p>																




	<p>studentët duke u ndihmuar dhe nga materialet didaktike të vendosura në formë panelesh në muret e laboratorëve. Staf i akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimi apo laboratorëve mësimore.</p> <p>Rinovimi i teknologjisë në laboratorët e institucionit, paisja me reagentë dhe bazë materiale dhe sigurimi i materialeve biologjike në klasë ose nga laboratorët bashkëpunorë mundësojnë kryerjen me sukses të demonstrimeve dhe aplikimeve praktike në laborator. Në takimin me stafin akademik GVJ konstatoi se pedagogu ka liri akademike në zhvillimin e orës së leksionit. <i>(takimi dhe vizita në institucion)</i></p> <p>Një sfidë për programin e studimit ka qenë praktika laboratorike online në kushtet e pandemisë. Departamenti në bashkëpunim me IT vendosi në funksionim platformat on line (EduPage, Microsoft Teams) përmes të cilave u kryen demonstrime laboratorike në kohë reale si dhe u shpërndanë temat e praktikës laboratorike në formën e videove ilustruese. <i>(Aneks XI/4-6)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional teorik. Në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor janë laboratorët mjekësorë biokimik-klinik, mikrobiologjik, histopatologjik si dhe laborator i informatikës. Laboratorët janë rinovuar dhe paisur me aparatura bashkëkohore.</p> <p>Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesmarje në konferenca shkencore, aktivitete trainuese, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike. <i>(Aneks I/7,8, XI/4,5 takimet dhe vizita në institucion)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë mjekësore, laboratorike apo pedagogjike në lëndët që zhvillon. Institucioni ka të siguruar logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, praktikave, aktivitetin kërkimor</p>



<p>koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>të studentëve etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit (<i>CV e stafit akademik, Planet mësimore, syllabuset, RVB-tabelat 4, 6.1-6.3</i>), GVJ konstatoi se formimi profesional i lektorit përputhet plotësisht me lëndën që zhvillon në këtë program studimi. Ngarkesa është shpërndarë në mënyrë proporcionale sipas profilit të specialitetit duke respektuar aktet ligjore në fuqi. Lektorët kanë titullin Prof., Prof. Asc. ose gradën Doktor.</p> <p>Institucioni mbështet dhe inkurajon trajnimin dhe kualifikimin akademik të pedagogëve të rinj. Institucioni mbështet rekrutimin e personelit të ri akademik me tituj dhe grada (<i>Aneks IV/4.1, 4.2, kriteret preferenciale të rekrutimit të personelit akademik</i>).</p> <p>Në takimin me studentët konstatuam se ata janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies, me komunikimin dhe ndërveprimin e pedagogëve në orët e mësimi si dhe me materialet didaktike që pedagogët pregatisin për procesin mësimor. Studentët ndihen të mbështetur dhe konstatohet një frymë pozitive bashkëpunimi (<i>takimet në institucion</i>). Kjo reflektohet dhe në vlerësimin periodik që studentët i bëjnë mësimdhënies dhe stafit akademik (vlerësim pozitiv mbi 90%) të pasqyruar në raportet e NJSBC (<i>Aneks VI/5, 7.1</i>). Personeli akademik është aftësuar dhe ka realizuar me sukses dhe metodat e punës on line sipas tematikave dhe profilit. (<i>Aneks XI/5</i>)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyre periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësori të vlerësimit, takimet mujore të studentëve me koordinatoren e programit. Rezultatet e raportuara nga NJSBC në raportin vjetor tregojnë se studentët e gjykojnë tërheqës procesin mësimor dhe sfidues detyrat e pedagogëve. Në 90% shpjegimi gjykohet i qartë dhe reflektohet përdorimi i metodave inovative. Në orën e mësimi ka bashkëveprim interaktiv pedagog-student. (<i>Aneks VI/5</i>)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me</p>	<p>NJSBC është struktura që koordinon dhe bashkëvepron me njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Institucioni përmes strukturave organizative të tij mbështet trajnimin dhe pjesëmarrjen e stafit akademik në projekte zhvillimi në të cilat veç aftësimi shkencor fitohet dhe eksperiencë në mësimdhënie.</p>

<p>njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Stafi akademik është trajnuar dhe mbështetet vazhdimisht për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies, për aspekte të organizimit të kurrikulës së programit dhe syllabuseve si dhe për metoda inovative të mësimdhënies siç është p.sh. mësimdhënia on line (<i>Aneks V/7, takimet në institucion</i>).</p> <p>Institucioni vlerëson arritjet e stafit akademik dhe i prezanton në analizat e departamentit dhe fakultetit. Analiza në departament e rezultateve të marra nga pyetsorët e plotësuar nga studentët dhe të vëna në dispozicion nga NJSBC përbën një mundësi të mirë reflektimi dhe lrijon premisa për përmirësim të vazhdueshëm të procesit mësimor-shkencor (<i>Aneks VI/6</i>).</p> <p>Në RVB theksohet se institucioni është i përfshirë si krijues në Rrjetin Ballkanik për Pedagogjinë Universitare dhe në projektin Magnet me fokus pedagogjinë universitare.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><b><i>GVJ gjykon se standardi III.1 përmbushet plotësisht.</i></b></p> <p><i>Institucioni garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale dhe eksperiencë mjekësore, laboratorike apo pedagogjike në lëndët që zhvillon. Formimi profesional përputhet me lëndën që pedagogu zhvillon në këtë program studimi Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre ne funksion të formimit profesional teorik të studentëve. Institucioni mbështet dhe promovon aktivitetin shkencor të stafit akademik.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi III.2</b></p>	
<p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>





<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloret e përgjithshme të institucionit përcaktohen në mënyrë specifike të gjitha rregullat dhe modalitetet e testimit të njohurive. Në syllabuset e lëndëve pasqyrohen format e kontrollit të njohurive (<i>Aneks II/1, 2, 3.1-3.3, 3.2.0-3.2.4, statuti, rregulloret, planet mësimore, syllabuset</i>).</p> <p>Në nenin 32 të rregullores së programit të studimit përcaktohen kriteret dhe procedurat e vlerësimit. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; b) me detyra kursi, projekte; c) i bazuar në një kombinim formash vlerësimi. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj. Notat vendosen në bazë të pikëve. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Vlerësimi kryhet sipas sistemit të detajuar më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="608 1081 1390 1541"> <thead> <tr> <th>Shkalla e pikëve</th> <th>Nota numerike</th> <th>Përshkrimi i notës</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>95 - 100</td> <td>10</td> <td>Shkëlqyeshëm</td> </tr> <tr> <td>85 - 94</td> <td>9</td> <td>Shumë mirë</td> </tr> <tr> <td>75 - 84</td> <td>8</td> <td>Mirë</td> </tr> <tr> <td>64 - 74</td> <td>7</td> <td>Kënaqshëm</td> </tr> <tr> <td>55 - 64</td> <td>6</td> <td>Mjaftueshëm</td> </tr> <tr> <td>45 - 54</td> <td>5</td> <td>Kalueshëm</td> </tr> <tr> <td>≤ 44</td> <td>4,3,2,1,0</td> <td>Mbetës</td> </tr> </tbody> </table>	Shkalla e pikëve	Nota numerike	Përshkrimi i notës	95 - 100	10	Shkëlqyeshëm	85 - 94	9	Shumë mirë	75 - 84	8	Mirë	64 - 74	7	Kënaqshëm	55 - 64	6	Mjaftueshëm	45 - 54	5	Kalueshëm	≤ 44	4,3,2,1,0	Mbetës
Shkalla e pikëve	Nota numerike	Përshkrimi i notës																							
95 - 100	10	Shkëlqyeshëm																							
85 - 94	9	Shumë mirë																							
75 - 84	8	Mirë																							
64 - 74	7	Kënaqshëm																							
55 - 64	6	Mjaftueshëm																							
45 - 54	5	Kalueshëm																							
≤ 44	4,3,2,1,0	Mbetës																							
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Metodologjia e vlerësimit përshkruhet dhe në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e funksionimit të Fakultetit, të programit si dhe rregulloren e zhvillimit të provimeve. Vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Ndjekja e lëndës dhe plotësimi i detyrimeve (laboratorë, detyra kursi) zenë 10%</p>																								



<p>lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>të vlerësimit. Testimet gjatë vitit zenë 30% të vlerësimit. Provimi përfundimtar ze 60% të notës.</p> <p>Në rregulloren e Departamentit të Shkencave Mjekësore dhe në Rregulloren e programit të studimit përcaktohen qartë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Format e kontrollit të dijeve</li> <li>- Sistemi i vlerësimit për lëndë e module</li> <li>- Sezonet e provimeve</li> <li>- Kushtet për të hyrë në provim</li> <li>- Mënyra e zhvillimit të provimeve</li> <li>- Mënyra e vlerësimit dhe kushtet kur studenti konsiderohet i kalues/i mbetur</li> <li>- Dokumentimi i rezultateve</li> <li>- Proçedurat e ankimimit, riprovimeve, përmirësimit</li> </ul> <p><i>(Aneks II/1, 2, 3.1-3.3, 3.2.0-3.2.4, statuti, rregulloret, planet mësimore, syllabuset, RVB-tabela 15)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/laboratore, provimi diplomimit. Vlerësimi i vazhdueshëm i jep mundësi studentit të demonstrojë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Gjatë periudhës së pandemisë, detyruar nga kushtet e krijuara, institucioni përpiloi dokumenta specifikë udhëzues për përmbushjen me sukses të proçesit të testimit në kushtet e mësimit on line. Ato ishin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Udhëzimi Nr. 4, datë 11.05.2020 i Senatit Akademik Për politikën e vlerësimit në distancë në Kolegjin Universitar “Logos” <i>(Aneks No.7)</i></li> <li>2. Vendim nr. 12, datë 01.06.2020 i Rektoratit Për miratimin e rregullores së posaçme për proçedurën e zhvillimit të provimeve online për sesionin e verës të vitit akademik 2019-2020 <i>(Aneks No.15)</i></li> </ol>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><b><i>GVJ gjykon që Standardi III.2 përmbushet plotësisht.</i></b></p> <p><i>Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e testimit dhe</i></p>



	<p><i>vlerësimi të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Informacioni i detajuar gjendet në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. që realizohet me anë të provime, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare, praktika, provimi diplomimit. Provimi zhvillohet me shkrim me gojë ose i kombinuar.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet qartë sistemi i vlerësimi të njohurive dhe aftësive profesionale. Në rregullore theksohet se kontrolli i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim dhe me gojë, detyrave të kursit, punës në grup, praktikave profesionale dhe provimit përfundimtar. Në tabelën 15 të RVB përcaktohet që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– 5% e pikëve të notës fitohen nga ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive</li> <li>– 5% e pikëve të notës fitohen nga plotësimi i detyrimeve (laborator, detyra kursi)</li> <li>– 30% e pikëve të notës fitohen nga testimet e kryer gjatë vitit</li> <li>– 60% e pikëve të notës fitohen nga provimi përfundimtar</li> </ul> <p><b>(Aneks II/3.2, RVB-tabela 15)</b></p> <p>Lëndët në fund të semestrit shlyhen me test ose provim sipas përcaktimit në planin mësimor. Vlerësimi i dijeve bëhet në përputhje me planin e studimit dhe zhvillohet në tre sezone: i dimrit-pas përfundimit të semestrit të parë, i verës-pas përfundimit të semestrit të dytë, i vjeshtës-pas pushimeve verore.</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Me urdhërin e rektorit Nr.10, datë 22.05.2020 “Për përdorimin e platformës dixhitale për mësimin në distancë” KU Logos vuri në zbatim në mënyrë të organizuar dhe koordinuar sistemet elektronike për mësimin online. Platformat e përdorura janë EduPage, Google Classroom, NEO LMS, Skype. Për realizimin e mësimin on line u ngritën dy ekipe, një ekip për menaxhimin akademik të mësimin në distancë, një ekip për administrimin teknik të mësimin në distancë. Po në vitin 2020 Senati akademik ka publikuar dokumentin për “Politikën e vlerësimit në distancë. Në këtë dokument prezantohen një seri udhëzimesh për pedagogët për format e vlerësimit në distancë. Pedagogët janë instruktuar nga departamenti për kontrollin e nivelit të ngjashmërisë së punimeve duke përdorur platformat online. <i>(Aneks II/15, I/7, I/8)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar nga një komisioni i përbërë nga dy pedagogë. Teza e provimit hartohet nga lektori (titullar i lëndës) miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Sekretaria mësimore nxjerr frekuentimin e leksioneve, seminareve dhe praktikave të studentit si dhe konfirmon realizimin e pagesave që ka detyrim studentit përpara se ai të hyjë në provim. Proçesverbali i provimit gjenerohet nga sistemi dhe firmoset nga pedagogët që kanë realizuar provimin. GVJ u njoh në sekretarinë mësimore me formatin e fletës së provimit dhe proçedurën.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e proçesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet finaciare sipas kontratës që ka me institucionin. Në rregulloren e KU Logos, Rregulloren e Departamentit dhe të programit të studimit përcaktohen qartë detyrimet që lidhen jo vetëm me ndjekjen e proçesit mësimor por dhe me numrin e ECTSve teoriko-praktike dhe llojin e lëndëve që studentit duhet të ketë të plotësuar para futjes në një sezon provimi. Studenti paraqitet në provim me dokument identifikues dhe çdo objekt që ka me vete vendoset në një vënd të caktuar nga organizatorët <i>(Aneks II/1, 2, 3.1-3.3)</i>.</p> <p>Në rregulloret e institucionit njihet e drejta e studentit për t’u njohur me rezultatin e provimit në prani të lektorit të kursit. Kur provimi kryhet me gojë vlerësimi shoqërohet me komente dhe këshillime të studentit për performancën e arritur në provim.</p>

	Ndërsa në provimet me shkrim komentet dhe sygjerimet kryhen në seancën e komunikimit të rezultateve. Në këto seanca pedagogu i mundëson studentit, nëse dëshiron, të shikojë rezultatet e provimit. GVJ inspektoi dosje provimesh në sekretarinë mësimore dhe i gjeti të rregullta plotësisht.
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësitë përgjegjëse kanë krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime. Në institucion funksionon Kodi i Etikës që plagjiaturën e konsideron sjellje të ndaluar. Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara parashikon masa disiplinore (nga vërejtje me shkrim në përjashtim) për studentët që kapen duke kopjuar. Në rastin e provimeve të zhvilluara on line parashikohet përdorimi i teknologjisë për verifikimin e origjinalitetit. Në RVB theksohet se institucioni angazhohet seriozisht në ndershmërinë akademike. <i>(Aneks II/3.1, 10)</i>
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Testimi i dijeve bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Në rregulloren e KU Logos përcaktohet afati 5 ditë për shpalljen e rezultateve të provimit. <i>(Aneks II/2)</i>  NJSBC monitoron mbarëvajtjen e procesit të provimit dhe përpilon raporte për këtë proces. <i>(Aneks VI/6.7)</i> Detyrimet e përcaktuara në kodin e etikës <i>(Aneks II/10)</i> për personelin akademik bëjnë të detyrueshëm vlerësimin e bazuar në meritë. Në RVB, mungesa e ankimeve për rezultatet në provime konsiderohet tregues i një vlerësimi të suksesshëm në bazë merite.
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Këto rregullore i japin të drejtë studentit të njihet me vlerësimin, të ankimohet për vlerësimin, të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit. <i>(Aneks II/2, 3.3)</i>
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të	Ankimimi për rezultatin e provimit bëhet jo më vonë se 48 orë nga publikimi i rezultateve. Rregullorja e programit të studimit parashikon një procedurë të qartë për ankimimin e rezultatit. Ankesa paraqitet me shkrim tek Përgjegjësi i Departamentit. Departamenti ngre një komision të përbërë nga të paktën 2




jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	anëtarë staf akademik me njohuri në fushën përkatëse. Komisioni aprovet nga dekani. Vendimi i komisionit vlerësues është i formës së prerë. Proçedura dokumentohet dhe arkivohet. ( <i>Aneks II/3.3</i> )			
<b>Konkluzione</b>	<b>GVJ gjykon se standardi III.3 përmbushet plotësisht.</b> <i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe proçesin e ankimimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve. Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Studentët njihen me rezultatin e provimeve në mënyrë konfidenciale. Studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Vlerësimi bazohet në meritë. KU Logos ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Rregullorja e programit të studimit përcakton objektiva të qartë profesionale për formimin e specialistëve polivalentë në fushën e laboratorëve mjekësorë( <i>Aneks II/3.3</i> ). Programi i studimit synon:  – t'u japë studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve Bachelor njohuritë më të avancuara teorike në fushën e zhvillimit të programit, mbështetur në metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme dhe ato të avancuara.



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të rrisë shprehinë praktike të studentëve duke i aftësuar më tej si specialistë në fushat e laboratorëve klinik, biokimik, mikrobiologjik dhe histopatologjik.</li> <li>- të përgatisë specialistë të laboratorit të aftë të përdorin teknologjinë bashkëkohore në laboratorët mjeksorë.</li> <li>- të përgatisë studentë të aftë për të vazhduar studimet universitare master shkencor duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.</li> </ul> <p>Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika profesionale në laboratorët bashkëpunëtorë. Studentët marrin formim të avancuar në shkencat dhe metodologjitë në fushat e laboratorit mjekësor: biokimi e aplikuar, hematologji, mikrobiologji, histopatologji. Studentët marrin përmes programit njohuri bazë për teknikat imunodiagnostike dhe të diagnozës molekulare si dhe për vlerësimin e cilësisë së metodikave laboratorike. Volumi që zënë orët e laboratorëve dhe praktikës profesionale u jep mundësi studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe të praktikohen gjatë manipulimeve dhe punës së pavarur. <i>(Aneks II/3.3 RVB-tabela e planit mësimor)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në lëndët e programit të studimit dhe në aktivitetin praktik që studentët zhvillojnë pranë laboratorëve bashkëpunëtorë marrin njohuri mbi aplikimin e teknologjisë së informacionit në praktikën laboratorike. Ato njihen me sistemin LIS dhe epërsitë e tij në rritjen e efikasitetit të punës në laborator, uljen e gabimeve preanalitike, monitorimin e kontrollit të cilësisë etj <i>(Aneks III/2.3, plani mësimor dhe syllabuset)</i>.</p> <p>Në KU Logos studenti trajnohet dhe përdor sistemin e menaxhimit të informacionit që i mundëson komunikimin me personelin akademik për çdo lëndë të programit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të</p>	<p>Në përfundim të lëndës, në orën e fundit të mësimit pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Në përmbledhjen e lëndës pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Studentët marrin pjesë aktive në diskutim. Studentët mund të përdorin ambientet laboratorike edhe jashtë orëve të programit</p>



<p>rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>mësimor. Ata asistohen nga pedagogët për të zgjidhur çështjet e rëndësishme teoriko-praktike. Analiza e rezultateve të provimeve në nivel lënde dhe departamenti i jep stafit akademik një vision të plotë për shkallën e asimilimit të njohurive dhe të përfitimit të kompetencave. <i>(Aneks II/24.2)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në programi Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie. Një pjesë e tyre janë lider të spikatur në fushat përkatëse. Bazuar në CV e stafit akademik që u vunë në dispozicion, fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës të cilën zhvillon pedagogu duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e mësimdhënies. <i>(CV e stafit akademik, takimet në institucion)</i></p> <p>Stafi akademik inkurajon edukimin e punës në grup për zgjidhjen e problemeve. Një ndër mënyrat që motivon studentët në asimilimin e programit mësimor është dhe puna e pavarur e studentit, puna në grup gjatë seminareve apo aktiviteteve trainuese të cila ju mundësojnë studentëve shprehjen e aftësive organizuese dhe drejtuese, komunikimit me etike midis kolegëve. Në ambientet e laboratorëve mjekësorë procesi ekzaminues është punë në grup. Një rol të rëndësishëm në edukimin e punës në grup luan dhe praktika profesionale e realizuar në laboratorët bashkëpunëtorë ku studenti ndjek nga afër funksionimin hierarkik dhe zgjidhjen e problemeve reale në laborator. Institucioni mbështet dhe inkurajon zhvillimin e ideve inovative dhe studimet kërkimore shkencore të stafit akademik. Në takimin me stafin akademik u informuam se ka patur dhe mbështetje financiare për pjesmarrje në konferenca internacionale dhe botime. Synohet në të ardhmen një përfshirje më e madhe e studentëve në aktivitete të partneritetit me institucione jashtë vendit për realizimin e projekteve shkencore. Synohet përfshirja e institucionit në projekte të mirëfillta kërkimore shkencore me mbështetje të partnerëve ndërkombëtare. <i>(takimet në institucion)</i></p> <p>KU Logos ka marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh universitare jashtë vendit. Në takime u referua që ka patur një mobilitet të kënaqshëm të pedagogëve përmes marrëveshjeve Erasmus+ si dhe aktivizim të tyre me pjesmarrje në trajnime dhe koferenca brenda dhe jashtë vendit. Mobiliteti i studentëve ka qenë në shifra të ulura, referuar situatës së</p>



	<p>pandemisë. Synohet që në të ardhmen të shtohet numri i studentëve që marrin pjesë në programet e këmbimit Erasmus+. Në rregulloren e programit të studimit parashikohen procedurat e transferimit dhe njohjes së ECTS-ve për studentët e këtij programi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore institucioni organizon trainime apo leksione jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet tyre. Tashmë është traditë në KU Logos organizimi i konferencave internacionale dhe konferencave studentore. Gjatë periudhës së pandemisë aktivitetet ekstrakurrikulare u kufizuan vetën në webinarë për përditësimin e informacioneve për Covid19. Aktivitetet kanë rifilluar në vitin e fundit. Në dosjen e programit të studimit institucioni ka paraqitur dhe dokumentacion lidhur me aktivitetet shkencore dhe publikimet. <i>(Aneks V/1-6)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Institucioni nxit pjesmarrjen e studentëve në projekte kërkimore të realizuara në bashkëpunim me pedagogët e departamentit. Ka patur dhe mobilitet të 2 studentëve të këtij programi në kuadër të projektit Erasmus+. Institucioni organizon në mënyrë periodike konferencat studentore duke stimuluar dhe mbështetur kërkimin shkencor nga studentët <i>(Aneks V)</i>. Synohet në të ardhmen një përfshirje më e madhe e studentëve në aktivitete të partneritetit me institucione jashtë vendit për realizimin e projekteve shkencore.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><b><i>GVJ gjykon se standardi III.4 përmbushet plotësisht.</i></b></p> <p><i>Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e Laboratorit Mjekësor. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Studentët marrin formim të avancuar në shkencat dhe metodologjitë e laboratorëve mjekësorë: biokimi e aplikuar, hematologji, mikrobiologji, histopatologji. Studentët marrin përmes programit njohuri bazë për teknikat imunodiagnostike dhe të diagnozës molekulare si dhe për vlerësimin e cilësisë së metodikave laboratorike, sistemit informatik laboratorik. Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme. Në funksion të</i></p>

	një përgatitje të gjithanshme profesionale dhe të formimit të mendimit kritik, institucioni organizon në mënyrë periodike leksione të hapura apo konferenca shkencore me pjesëmarrjen e lektorëve të shquar vendas apo të huaj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi III.5</b>	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblyëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	<p>Programi i studimit MP në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” mbyllet me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe/ose punim diplome. Në rregulloren e KU Logos, ka një kapitull të dedikuar për procedurën e diplomimit ku përcaktohen kushtet që duhet të përmbushë studenti para diplomimit. <i>(Aneks II/2)</i>. Studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe të ketë fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit. Studenti, para hyrjes në provimin e përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, duhet të ketë likuiduar të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me Kolegjin Universitar “Logos”. Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara përcakton se të drejtën për të përgatitur diplomë e kanë studentët me notë mesatare që plotëson kriteret e departamentit. <i>(Aneks II/3.1)</i></p> <p>Në rregulloren e programit të studimit, në kreun V, jepen detaje mbi procedurën e diplomimit. Për të fituar diplomën në programet e studimeve “Master Profesional” studenti duhet të marrë kreditet përkatëse. Mbrojtja e temës së diplomës ose provimit përfundimtar bëhen në dy sezona: të verës dhe të dimrit, të cilët përcaktohen në strukturën e studimeve. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor “Master Profesional”, që ka kryer praktikën dhe ka mbrojtur mikrotezën ose ka marrë provimin përfundimtar, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me listën e notave të fituara gjatë viteve</p>



	<p>të studimit. Kriteret për përfshirje në punim diplome vendosen nga departamenti. <i>(Aneks II/3.3)</i></p> <p>Në planin mësimor të programit të studimit, Diploma realizohet në 150 orë (60 orë në auditor dhe 90 orë studim individual) që ekuivalentohen në 6 ECTS.</p>
<p><b>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</b></p>	<p>Programi i provimit të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit me provim ose me përgatitjen e një teme diplome. Pedagogët përgatisin dhe vënë në dispozicion të studentëve bankën e pyetjeve që në semestrin e parë. Ata i orientojnë studentët dhe ju japin informacion lidhur me temat apo materialet që duhet të konsultohen për provimin final si dhe literaturën që duhet të shfrytëzohen në hartimin e temës së diplomës, skicimin e strukturës së studimit mbledhjen e informacionit apo realizimin e tij në laboratorët e departamentit apo institucionet shëndetësore me të cilat bashkëpunon institucioni si dhe prezantim e materialit. Departamenti harton listën e fushave prioritare dhe miraton listën e temave të diplomave dhe udhëheqësit e tyre <i>(Aneks II/2, VII/17)</i></p>
<p><b>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</b></p>	<p>Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga 3 – 5 pedagogë efektivë dhe të jashtëm, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga Dekani. Kryetari i komisionit caktohet nga dekani. Teza e provimit hartohet nga komisioni në bazë të bankës së pyetjeve përmban pyetje për çështjet kryesore të trajtuara gjatë gjithë programit të studimit. Provimi organizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar (me shkrim dhe me gojë). Korrigjimi i tezës bëhet nga komisioni, i cili shënon pikët e fituara në faqen e sekretimit. Heqja e sekretimit bëhet nga komisioni në prani të Dekanit. Rezultatet paraprake shpallen në mjediset publike të fakultetit.</p>
<p><b>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës.</b></p>	<p>Temat e diplomës dhe udhëheqësit shkencorë për programin e studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” përcaktohen nga departamenti dhe miratohen nga dekani. Në realizimin e temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët udhëheqës ndihma e të cilëve konsiston në zhvillimin e seancave konsultuese që janë orë pune që</p>

<p>Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>ndihmojnë studentin në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, metodologjinë, përpilimin e rezultateve, shkrimin dhe prezantim e punimit të diplomës. Seancat konsultuese zhvillohen nga pedagogu udhëheqës i temës dhe kanë karakter interaktiv. Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e pjesës teorike të temës së diplomës infrastrukturën e nevojshme si dhe ju garanton studentëve mbledhjen e të dhënave apo realizimin e testeve të ndryshme në funksion të temës në institucionet laboratorike me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Tema quhet e përfunduar vetëm pas miratimit nga udhëheqësi shkencor. Para prezantimit në komisionin e vlerësimit, tema vlerësohet dhe nga 2 reçensentë. <i>(Aneks II/2, VII/17)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Realizimi i temës së diplomës bazohet në rregulloret e institucionit. Në rregulloren e KU Logos theksohet se punimi i diplomës përcaktohet në mënyrë të tillë që të përfshijë domosdoshmërisht eksperimentin ose kërkim apo vjelje të dhënash në terren<i>(Aneks II/1)</i>. Në parim institucioni i siguron studentëve infrastrukturën e nevojshme logjistike për realizimi e studimit. Studentët mbledhin të dhënat në strukturat laboratorike bashkëpunuese ku realizohet studimi ose realizojnë pjesën eksperimentale në laboratorët e departamentit. Në RVB theksohet se periudha e pandemisë ishte e pafavorshme për përmbylljen e programit të studimit me temë diplome. Në këto vite u aplikua vlerësimi me provim të përgjithshëm përfundimtar. Institucioni në planet e zhvillimit mbështet punën shkencore të studentëve duke konsideruar kontribut të rëndësishëm përgatitjen e temave të diplomave për këtë qëllim <i>(RVB, takimet në institucion)</i>.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i provimit të diplomës apo temës bëhet me notë. Teza e provimit të diplomës ka 100 pikë maksimale. Teza korrigohet nga komisioni i vlerësimit. Proçes verbali përfundimtarë firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe dorëzohet në sekretari. Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara komisionit të ngritur nga Departamenti, e cila e vlerëson studentin me notë, bazuar në punën e tij dhe vlerësimin e udhëheqësit të temës. Tema e diplomës vlerësohet me pikë individuale nga secili anëtar i komisionit dhe në fund llogaritet mesatarja aritmetike. <i>(Aneks II/2, 3.3)</i></p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën (me punim diplome ose provim përfundimtar/të përgjithshëm), pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Në vizitën në sekretarinë e institucionit, GVJ u njoh me formatin e Diplomës dhe suplementin për këtë program studimi. Në përfundim të studimeve në Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laborator Mjekësorë” studenti merr suplementin e diplomës që përmban informacion të detajuar për programin e studimit <i>(Aneks 3.5)</i>.</p> <p>Me kërkesë të tij, në çdo kohë studentit i vihet në dispozicion kopja e plotë zyrtare e programit të studimit. Proçedura është rregulluar me urdhër Rektori.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet. Në sekretarinë mësimore të fakultetit gjëndet regjistri themeltar i studentëve, regjistri i vlerësimeve të marra nga studentët gjatë viteve të studimit në programin e studimit dhe regjistri i tërheqjes së diplomës. Sekretaria mësimore, përgjegjëse për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave punon mbështetur në rregullore të funksionimit dhe arkivimit. GVJ vizitoi ambientet e sekretarisë ku u njoh me mënyrën e menaxhimit të informacionit për studentët (u konsultuan dosje studentësh dhe regjistrat themeltarë) dhe për pedagogët (u konsultuan dosjet dhe kontratat). GVJ u njoh dhe me ecurinë e proçesit të dixhitalizimit të informacionit dhe arshivës së sekretarisë <i>(AneksII/16, 17)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><b><i>GVJ gjykon se Standardi III.5 përmbushet plotësisht.</i></b></p> <p><i>Institucioni ndjek një proçedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit.</i></p>



Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfuturit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Në funksion të realizimit të praktikës laboratorike dhe praktikës profesionale dhe në përmbushje të rekomandimeve të lëna gjatë procesit të akreditimit të parë të programit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”, Departamenti i Shkencave Mjekësore ka ristrukturuar në një hapësirë më të përshtatshme laboratorët klinik-biokimik, mikrobiologjik dhe histopatologjik si dhe ka përmirësuar ndjeshëm paisjen teknologjike të tyre (<i>vizita në institucion</i>).</p> <p>Në dosjen e programit të studimit GVJ ka konsultuar dhe tabelat e buxhetit (<i>Aneks IX</i>) në të cilat evidentohet furnizimi me reagentë i laboratorëve në përputhje me kërkesat e programit mësimor. Këto mjedise të rinovuara garantojnë përmushjen e objektivave praktikë të planit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me subjekte laboratorike të akredituar që disponojnë teknologji bashkëkohore dhe i mundësojnë studentit aftësim praktik në situata reale diagnostike dhe përfitim të kompetencës profesionale. Në këto laboratorë studentët kanë mundësi të njohin në praktikë dhe të përdorin systemin LIS, si dhe të realizojnë punimet e diplomës. (<i>Aneks VII/1,2</i>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe</p>	<p>Praktika profesionale në programin e studimit Master Profesional në “Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” realizohet në 150 orë që ekuivalentohen në 6 ECTS. Gjatë seancave të praktikës profesionale studenti mbikqyret nga një tutor i caktuar nga institucioni pritës dhe aktiviteti i tij</p>



dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	monitorohet dhe vlerësohet nga një personel akademik i departamentit. Nota e praktikës rezulton si mesatare e dy vlerësimeve. <i>(Aneks dosja e praktikës)</i>			
<b>Konkluzione</b>	<b>GVJ gjykon se Standardi III.6 përmbushet plotësisht.</b> <i>Institucioni ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për realizimin e praktikës mësimore në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara si dhe marrëveshje me institucione shëndetësore për kryerjen e praktikës profesionale të studentëve. Praktika profesionale ka 6 ECTS ose 150 orë mësimore. Në fund të praktikës bëhet vlerësimi me notë sipas udhëzuesit të praktikës profesionale.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>



**Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.**

RVB paraqet një analizë të detajuar të njësisë bazë së programit, kualifikimet e stafit akademik, dhe përshtatshmërinë e tyre me standardet dhe ligjin në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Në RVB përshkruhet organizimi i programit Master Profesional në "Teknikë të Lartë në Laboratorë Mjekësorë", duke specifikuar se stafi akademik përbëhet nga 6 pedagogë me kohë të plotë dhe 2 me kohë të pjesshme, të cilët plotësojnë kërkesat ligjore për kualifikim akademik. Kualifikimet e tyre, përfshirë gradat dhe titujt, janë në përputhje me standardet e përcaktuara nga Vendimi i MASR nr. 418, datë 10.5.2017. Për të përmbushur misionin e institucionit, është theksuar se seleksionimi i personelit akademik është bërë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor Nr. 80/2015. **Tabela 2** përcakton raportin e gradës/titullit në krahasim me funksionin, duke ndjekur standardet e Ligjit nr. 80/2015. Përveç kësaj, stafi akademik ka fusha kërkimore të përputhshme me programin e studimit dhe përvojë të gjatë në lëndët që ata mbulojnë, siç mund të verifikohet në CV-të e tyre (*Aneks IV/5 dhe IV/12-13*). GVI gjithashtu konstatoi përputhshmërinë e organizimit, kualifikimeve dhe përshtatjen e stafit akademik me standardet dhe kërkesat ligjore të arsimit të lartë në Shqipëri. Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, janë angazhuar staf akademik për tre vite akademike si më poshtë vijon: (*Aneks 4, tab 6.1-6.3*)

Tituj/grada	2019 - 2020		2020 - 2021		2022 - 2023	
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	3	1	3	1	3	1
Prof.As.Dr	-	1	-	1	-	1
Dr/PhD	2	-	4	-	4	-
SPA	1	-	-	-	-	-
Msc	-	-	-	-	-	-
Në total	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>7</b>	<b>2</b>

*\*mungojnë të dhënat për vitin 21-22*

**Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të**

KU "Logos" plotëson standardet e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 në lidhje me ngarkesën mësimore të personelit

<p>mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>akademik. Konkretisht, stafi akademik efektiv i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për të tre vitet akademike mbulon 75% të ngarkesës totale të personelit akademik të përfshirë në realizimin e programit. Kjo tregon se institucioni përmbush detyrimet e tij duke siguruar një përqindje të konsiderueshme të stafit akademik për të mbuluar nevojat mësimore të programit të studimit. <i>(Aneks 4, tab 12.1-12.3)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Institucioni garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik përmes kontratave individuale të punës. Disa kontrata u vëzhguan dhe nga GVJ (<b>Vizita në institucion</b>)</p> <p>Për të siguruar që stafi akademik të mbulohet në aspektet financiare, institucioni zbaton rregullisht detyrimet e percaktuara nga Kodi i Punës për stafin akademik të ftuar pjesë e programit, duke krijuar një bazë të qëndrueshme për stafin. Për më tepër, fakti që stafi akademik aktual ka qenë pjesë e programit për më shumë se 10 vite akademike shërben si dëshmi shtesë për qëndrueshmërinë e përmendur. Ky angazhim i gjatë tregon përkushtim dhe një marrëdhënie të qëndrueshme ndërmjet personelit akademik dhe institucionit. <b>(Aneksi IV/3; takimi me stafin)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" ndjek procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik dhe administrativ, duke iu nënshtruar Kodit të Punës, Ligjit Nr. 80/2015 dhe akteve nënligjore të zbatimit të tij, si dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Procedurat e punësimit zbatohen duke respektuar kërkesat e tregut të punës, dhe kriteret dhe procedurat specifike përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme <i>(Aneks II/2 nenet 43-48 dhe IV/4.2; Takimi me stafin, Vizita në Institucion)</i>. Për të siguruar cilësi të lartë, kolegji vlerëson edhe personelin akademik të kualifikuar dhe të diplomuar jashtë vendit me gradë shkencore dhe tituj akademikë si vlerë shtuar. Për propozimin e kandidatëve, Departamenti konsideron nivelin e studimeve, eksperiencat e mëparshme, përputhjen shkencore me lëndën, përvojën akademike dhe aftësinë e mësimdhënies. Kjo tregon zhvillimin e një procesi të strukturuar dhe të përpiktë për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit, duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" siguron angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve në programin e studimit "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë". Politika integruese e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ është në fokus, dhe Institucioni parashikon një plan vjetor për veprimtaritë akademike dhe kërkimore, duke përfshirë personelin ndihmës akademik. Në laboratorët mjekësorë të programit, janë angazhuar dy persona staf ndihmës akademik me kualifikim master dhe përvojë të nevojshme në laboratorët mjekësore. Përveç pjesëmarrjes së tyre në mirëmbajtjen e laboratorëve, ata ofrojnë asistencë për stafin akademik gjatë seancave laboratorike dhe hartojnë kërkesat për blerjen e materialeve bazuar në nevojat e stafit mjekësor. Detyrat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës akademik janë përcaktuar në Rregulloren e departamentit, dhe ata marrin pjesë në trajnime për ngritjen e aftësive profesionale, (<b>praktika e kualifikimit të Kristiana Nastos në histopatologji laborator</b>). Institucioni tregon përkushtim ndaj një personeli ndihmës akademik cilësor dhe në përputhje me nevojat specifike të programit të studimit dhe laboratorëve të tij.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" ka një sistem të strukturuar për mbledhjen, ruajtjen, dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë" në çdo vit akademik. Lista e personelit akademik me kontrata të plota është miratuar nga rektori dhe përfshin të dhënat e anëtarëve të personelit akademik përfshirë atë të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. (<i>Aneks I/5.2</i>). Departamenti planifikon kohën vjetore të punës për çdo anëtar të personelit akademik, duke përfshirë ngarkesën mësimore (<i>Aneks IV/2</i>), kërkimin shkencor dhe angazhimin institucional. Për vlerësimin e performancës, kolegji kryen vlerësime periodike duke përfshirë vetëvlerësimin, vlerësimin nga drejtuesi i njësisë bazë, dhe vlerësimin nga pyetëtorët e studentëve në fund të çdo semestri në lidhje me mësimdhënien (<i>Aneks VI/3 dhe IV/7</i>). Ky përkushtim ndaj mbledhjes së të dhënave dhe vlerësimit periodik shënon një përpjekje të qëndrueshme për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit akademik në programin e studimit.</p>



<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" vepron në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi, dhe kompani për të vënë në dispozicion personel të mjaftueshëm, të duhur dhe të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen, dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë". Për të arritur këtë, institucioni mundëson marrëveshje bashkëpunimi mes institucioneve bashkëpunuese dhe Departamenti vë në dispozicion personelin akademik me eksperiencë në laboratorët mjekësorë për mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës profesionale. Për të ilustruar, personeli akademik i angazhuar në vitet pas akreditimit të fundit ka diplomë në Mjekësi dhe Specializim në Laboratorët Klinik-Biokimik, duke theksuar kualifikimin dhe përvojën e tyre në fushën e laboratorëve mjekësorë. Kjo vë në dukje angazhimin e institucionit për sigurimin e një përvoje praktike të pasur dhe cilësore për studentët në fushën e tyre të studimit.</p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" e përmbush këtë kriter duke përdorur marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat mësimore. Institucioni bashkëpunues ofron personel mjekësor të specializuar në laborator, i cili ka përgjegjësinë e ndjekjes dhe udhëheqjes së studentëve gjatë praktikës profesionale. Ky personel ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve dhe raportit përfundimtar të praktikës dhe merr pjesë aktivisht në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. Për të bërë këtë, ata plotësojnë dosjen përfundimtare të vlerësimit të studentit nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm për përmirësimin dhe monitorimin e cilësisë së praktikës së studentëve në ambientin pritës (<b>dosja e praktikës</b>). Kjo tregon përpjekjen dhe angazhimin e institucionit për sigurimin e një përvoje të pasur dhe të monitoruar për studentët gjatë periudhës së praktikës profesionale.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi ka një staf akademik të kualifikuar dhe në përputhje me standardet ligjore për arsimin e lartë në Shqipëri. Stafit akademik përbëhet nga pedagogë me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, të cilët kanë gradat dhe titujt e nevojshëm për të mbuluar lëndët dhe fushat e tyre të specializuara.</i></p> <p><i>Institucioni ka përmirësuar përshtatjen dhe organizimin e programit në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe</i></p>

	<p><i>standardet e përcaktuara nga MASR. Gjithashtu, raporti i gradës/titullit me funksionin për stafin akademik ndjek standardet e ligjit nr. 80/2015.</i></p> <p><i>Institucioni ka siguruar qëndrueshmëri financiare për stafin akademik përmes kontratave të punës individuale dhe zbaton rregullisht detyrimet financiare të përcaktuara nga kodi i punës për personelin akademik.</i></p> <p><i>Kolegji ka ndjekur procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik dhe administrativ në përputhje me ligjin nr. 80/2015 dhe aktet e tjera zbatuese. Procedurat janë transparente dhe respektojnë kriteret e tregut të punës.</i></p> <p><i>Institucioni ka një politikë integruese dhe siguron personel ndihmës akademik të përshtatshëm për seancat laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve. Ata janë të kualifikuar dhe ndjekin trajnime për ngritjen e aftësive profesionale.</i></p> <p><i>Kolegji ka një sistem të strukturuar për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik.</i></p> <p><i>Për sa më sipër GVJ konkludon se ky standart përmbushet plotësisht</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me	Kolegji Universitar 'Logos' siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore në programin e studimit MP 'Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë' (Aneks X/1). Kampusi Nr. 1, me një sipërfaqe prej 5931 m <sup>2</sup> , është përdorur për zhvillimin e aktiviteteve akademike dhe administrative të departamentit të Shkencave Mjekësore, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara. Ky kampus ofron ambientet e nevojshme dhe ka një numër të mjaftueshëm të

<p>natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>sallave të leksioneve, klasave për seminaroe dhe laboratorëve të pajisur me teknologjinë dhe reagentët e nevojshëm për realizimin e praktikave mësimore (Aneks X/2, 3, 4, 5). Objekti është ndërtuar me materiale cilësore dhe ka kushte higjeno-sanitare të plotësuara, duke siguruar një mjedis të sigurtë dhe të përshtatshëm për studentët dhe personelin (Aneks X/2, 5 dhe 8.1). Në sallat e mësimi janë implementuar standarde akustike dhe elementët e tjera të sigurisë dhe komoditetit për të përmbushur kërkesat ligjore dhe rregullative. Për të përmirësuar eksperiencën mësimore, janë përdorur teknologji digjitale dhe pajisje shtesë në të gjitha klasat. Gjithashtu, infrastruktura përfshin një bibliotekë të pajisur me salla kompjuterash, Wi-Fi, dhe ambiente studimi të përshtatshme (Vizita në institucion). Institucioni bën përpjekje të konsiderueshme për sigurimin e një mjedisit të përshtatshëm mësimor për programin e studimit në fjalë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Të gjitha mjediset mësimore, përfshirë klasat, laboratorët, dhe bibliotekën, janë të pajisura me mjete elektronike të teknologjisë së informacionit, duke siguruar realizimin e procesit mësimor, të asistuar nga metodologjitë dhe teknologjitë bashkëkohore të mësimdhënies-e mësimnxënies. Këto mjedise janë të pajisura me aparate elektronike si projektor, kompjuter, webcam, dhe software Windows për të mundësuar një proces mësimor të përshtatshëm (Vizita në Institucion). Përdorimi i këtyre mjeteve është i integruar në praktikën mësimore dhe ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimi.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara tregon se ka kapacitete infrastrukturore dhe hapësira të mjaftueshme për të akomoduar studentët e programit Master Profesional në "Teknikë të Lartë në Laboratorë Mjekësorë," duke përmbushur standardet për kapacitetet infrastrukturore fizike dhe teknike për studentët. Ky informacion është referuar në Tabelën 16 dhe Aneks X/5, por u konstatua edhe nga GVJ gjatë vizitës në institucion. .</p>
	<p>Gjatë periudhës së tërmeteve dhe pandemisë, kur u realizua mësimi online për të parandaluar përhapjen e COVID-19, u përdorën platforma të menaxhimit të të nxëniti si EduPage dhe platforma komunikimi të ndërmjetësuar si MS TEAMS. Ky përdorim i teknologjisë tregon adaptabilitetin e institucionit në situata të jashtëzakonshme. (Aneks XI 4 dhe 5.)</p>



	<p>GVJ e konsideron si praktikë të mire përdorimin e teknologjisë (sistemet digjitale si EduPage, MS Teams) për të mbështetur studentët dhe siguruar transparencë në procesin e mësimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratorët apo mjediset e tjera, të përdorura për programin studimor MP "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë," përmbushin dhe plotësojnë kërkesat e moduleve dhe objektivat formuese të programit në tërësi. Departamenti i Shkencave Mjekësore disponon tre laboratorë mjekësorë: Laboratori Biokimik Hematologjik, Laboratori Mikrobiologjik, dhe Laboratori Histopatologjik. Këta laboratorë janë të pajisur me teknologjinë e nevojshme për të kryer analiza laboratorike të ndryshme, duke përfshirë analizat mikrobiologjike, biokimike, hematologjike, imunologjike dhe histopatologjike sipas programit mësimor. Infrastruktura e krijuar në këto laboratorë siguron që studentët të kenë të gjitha aftësitë praktike bazë që i nevojiten një tekniku laborator për të përmbushur objektivat formuese të programit (Tabela 16 dhe Aneks IX/7).</p> <p>Gjithashtu, për të përmirësuar këtë infrastrukture për laboratorët mësimore bëhen mjaft përpjekje për të siguruar bazë materiale dhe aparatura të reja në çdo vit akademik. Pas akreditimit të fundit të programit, janë bërë investime në pajisje laboratorike të reja dhe përmirësim të infrastrukturës së laboratorëve, duke u përshtatur me rekomandimet dhe standardet e fundit. Ky angazhim kontribuon në sigurimin e mjeteve të nevojshme për realizimin e seancave laboratorike dhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni disponon tre laboratorë të teknologjisë së informacionit në shërbim të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara. Këto laboratorë janë të pajisur me programet bazë të paketës Microsoft dhe programe specifike që përshtaten me natyrën e programit të studimit. Përveç kësaj, brenda bibliotekës së Kolegjit Universitar "Logos," ekziston një sallë me vende të pajisura me kompjutera, e cila ofron mundësi për të aksesuar bibliotekën dixhitale dhe platformat online të cilat janë në dispozicion të institucionit (Aneks X/5.2, vizita në institucion).</p> <p>Përveç laboratorëve të teknologjisë së informacionit, mundësitë e platformës elektronike të komunikimit MS TEAMS i ofrojnë studentëve një mjet shtesë. Ata kanë mundësinë të përdorin pajisjet e tyre si një mini-laborator të teknologjisë së</p>




	<p>informacionit, duke ndarë leksione, seminare, dhe video nga praktikat dhe seancat laboratorike. Kjo tregon përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar mësimdhënien dhe komunikimin në mënyrë efikase, duke përshtatur infrastrukturën për të përmirësuar përvojën e studentëve në lidhje me fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>GVJ e konsideron si <b>përvojë të mire</b> faktin që institucioni ofron një sërë informacionesh të detajuara në lidhje me proceset e studimit, programet, dhe shërbimet e disponueshme.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Në Kampusin nr. 1, ku zhvillohet programi i studimit "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë," ka mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e procesit mësimor dhe praktikave laboratorike, siç është evidentuar në kriteret e mëparshme mbi infrastrukturën. Institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike dhe private për njohjen e studentëve me teknologjinë e laboratorit dhe për kryerjen e kërkimit shkencor të përbashkët (<b>Aneks VIII/1</b>).</p> <p>Në thelb, është krijuar një strukturë e bashkëpunimit me institucione shëndetësore, duke përfshirë marrëveshje për një bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e teknologjisë së laboratorit dhe kërkimit shkencor. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se njësia bazë nuk ofron programe në fushën e mjekësisë, prandaj marrëveshjet e bashkëpunimit nuk përfshijnë struktura spitalore me shtreter, por janë përqendruar në marrëveshje me struktura laboratorike (<b>Aneks VIII/1</b>).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ eidenton si më poshtë:</i></p> <p><i>Kampusi nr. 1 ofron hapësira të mjaftueshme me salla të përshtatshme për leksione, seminare dhe laboratorë. Mjediset e krijuara janë të pajisura me teknologji dhe reagjentë të nevojshëm për praktikat mësimore. Përdorimi i teknologjisë digjitale dhe pajisjeve shtesë në klasa dhe laboratorë përmirëson eksperiencën mësimore.</i></p> <p><i>Objekti është ndërtuar me materiale cilësore dhe ofron kushte higjeno-sanitare të plotësuara, duke siguruar një mjedis të sigurtë dhe të përshtatshëm për studentët dhe personelin.</i></p>

	<p><i>Standardet akustike dhe elementët e sigurisë janë implementuar në sallat e mësimit për të përmbushur kërkesat ligjore dhe rregullative.</i></p> <p><i>Përdorimi i mjeteve elektronike të teknologjisë së informacionit në klasa, laboratorë dhe bibliotekë përmirëson procesin mësimor dhe siguron një platformë efektive për studentët.</i></p> <p><i>Në kohët e pandemisë dhe tërmeteve, institucioni ka demonstruar adaptabilitetin duke përdorur platforma të menaxhimit të të nxënies dhe komunikimit online për të mbështetur mësimin në distancë.</i></p> <p><i>Institucioni ka krijuar një strukturë të bashkëpunimit me institucione shëndetësore, duke përfshirë marrëveshje për njohjen e studentëve me teknologjinë e laboratorit dhe kryerjen e kërkimit shkencor të përbashkët.</i></p> <p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi IV.3


**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse është e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit, duke garantuar marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, siç është parashikuar në programin e studimit. Literatura bazë e përdorur për mësim është në gjuhën shqipe, siç është specifikuar në <b>Regullore Programi në neni 24</b>. Të gjitha lëndët kanë tituj bazë të përcaktuar në programin mësimor, dhe literatura ndihmëse ofrohet në gjuhën shqipe ose të huaj (<b>vizita në institucion</b>). Përveç kësaj, leksionet e shkruara nga vetë pedagogët shërbejnë si një burim shtesë i informacionit për studentët. Kjo siguron që materialet e mësimit të jenë të arritshme dhe të kuptueshme për</p>



	studentët, duke i ndihmuar ata në marrjen e njohurive të duhura për të përmbushur synimet e programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Departamenti, ka një praktikë të përditësimit të literaturës me botime të viteve të fundit. Ky përditësim kërkohet nga stafi në fillim të vitit akademik dhe realizohet përmes përditësimit të sillabusit me literaturë bashkëkohore. Ky përditësim kryesisht fokusohet në literaturën e rekomanduar për programin. Arsyeja për këtë praktikë është vështirësia në gjetjen e titujve profesionalë mjekësorë në gjuhën shqipe. Kështu, Departamenti siguron që studentët të kenë akses në informacionin më të fundit dhe relevant në fushën e tyre të studimit, duke i përgatitur ata për sfidat dhe zhvillimet e reja në fushën mjekësore. <b>(takimi me stafin)</b>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka në dispozicion të studentëve dy biblioteka për programin e studimit. Bibliotekat janë Biblioteka Nr. 1 "LOGOS" në kampusin kryesor në Tiranë <b>(Vizitë në institucion)</b> dhe Biblioteka Nr. 2 "NGJALLJA" në kampusin e Shën Vlashit, Durrës. Studentët kanë të drejtë të anëtarësohen në këto biblioteka dhe të përdorin literaturën, si fizike ashtu edhe atë elektronike, brenda dhe jashtë mjediseve të bibliotekës <b>(Aneks II/21 neni 7 pikat 1-9, neni 10)</b> . Ata kanë të drejtë të huazojnë literaturën që u duhet dhe kanë akses në bibliotekën digjitale për të përdorur literaturën e nevojshme për pasurimin e njohurive teorike dhe realizimin e temave të ndryshme të ofruara nëpërmjet lëndëve të programit studimor.  Përveç kësaj, institucioni organizon trajnime të vazhdueshme për përdorimin dhe shfrytëzimin e bibliotekës. Kjo përfshin njohjen e studentëve me të gjithë elementët e nevojshëm për shfrytëzimin e bibliotekës, duke siguruar që ata të jenë në dijeni të burimeve të disponueshme dhe të mësojnë si të përdorin me efikasitet këto burime për të pasuruar studimet e tyre.
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme	Biblioteka është e pajisur me një fond të pasur fizik dhe elektronik. Ky fond përfshin tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, revista shkencore, si dhe e-libra <b>(Vizita në institucion)</b> . Kjo bibliotekë është përdorur për të plotësuar nevojat e studentëve për studimet dhe kërkimet e tyre. Në tre vitet e fundit, programi studimor është pasuruar ndjeshëm me literaturë bashkëkohore në gjuhën shqipe, duke përfshirë rekomandimet e lëna nga grupi i akreditimit të

<p>dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>mëparshëm. Për më tepër, biblioteka siguron qasje në literaturën më të fundit bashkëkohore përmes dy site-ve të rëndësishme: EBSCO dhe J-STOR. Studentët kanë mundësi të ndjekin këto site dhe të kërkojnë për informacionin më të fundit në fushën e mjekësisë laboratorike, përfshirë libra në format elektronik (e-book) (Aneks XI/7.6).</p> <p>Kjo qasje e bibliotekës ndaj pasurimit të burimeve dhe aksesit të studentëve ka një rol të rëndësishëm në sigurimin e njohurive dhe të informacioneve të nevojshme për pjesëmarrjen efektive në programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka krijuar kushte për shfrytëzimin e barabartë dhe pa pagesë të bibliotekave online në fushën e programit të studimit MP "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë." Institucioni ofron kushte pa pagesë për qasjen në literaturën online përmes platformave të njohura si EBSCO, JSTOR dhe PubMed. Përdoruesit, duke përfshirë studentët dhe stafin akademik, kanë mundësinë të përdorin këto burime online për të pasuruar njohuritë e tyre dhe për të kryer projektet e ndryshme që ofrohen nëpërmjet lëndëve të këtij programi studimi.</p> <p>Këto biblioteka online janë mundësuar nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet partnere dhe janë në fuqi sipas marrëveshjeve përkatëse me këto universitete, siç është shfaqur në Tabelën 17. Gjatë periudhës së pandemisë, studentët kanë përdorur katalogun elektronik të Bibliotekës, duke bashkëpunuar me punonjësit e bibliotekave për sigurimin e materialeve përmes skanimit dhe duke respektuar të drejtat e autorit.</p> <p>Studentët gjithashtu kanë pasur mundësi të përdorin databaza elektronike të aksesueshme falas nga pedagogët, e cila mundëson përdorimin e literaturës së huaj, si dhe literaturës digjitale me autorë nga pedagogët e Kolegjit, e cila është vënë në shërbim të programit të studimit (Aneks XI/7.5). Përveç kësaj, cdo vit studentët trajnohen për përdorimin e bibliotekës, dhe në bashkëpunim me departamentet planifikohen aktivitetet e trajnimit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, duke mundësuar shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentet. Kompjuterat në bibliotekë janë të pajisur me programet e Office-it, duke mundësuar që studentet të shkruajnë</p>





<p>shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>detyrat dhe punimet e tyre. Po ashtu, në keta kompjutera është instaluar edhe Google Chrome, duke mundësuar kërkimin e informacionit në internete (<b>Vizita në institucion</b>).</p> <p>Fondi i bibliotekës paraqitet në baze të të dhënave elektronike përmes regjistrimeve në programin e katalogimit të përbashkët elektronik PLEIADES, i bazuar në standartin MARC 21. Katalogu elektronik <a href="http://lib-orthodoxalbania.org">http://lib-orthodoxalbania.org</a> ndihmon përdoruesit në gjetjen e informacionit që disponon fondi i bibliotekës. Për trajnimin e përdorimit të bibliotekës dhe burimeve digjitale, të gjithë studentët trajnohen në fillim të vitit akademik.</p> <p>Informacioni i plotë mbi bibliotekën mund të aksesohet në linkun <a href="http://www.kulogos.edu.al/al/books.html">http://www.kulogos.edu.al/al/books.html</a>.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është e frekuentueshme gjatë gjithë vitit, me përjashtim të ditëve të festave zyrtare. Orari i bibliotekës është nga e hënë në të premte, nga ora 08:00 deri në 20:00. Ky orar afishohet në hyrjen e bibliotekës. Trajnimet për studentët rreth përdorimit të bibliotekës, linket, orari dhe informacione të tjera janë të aksesueshme në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar "Logos" <a href="http://www.kulogos.edu.al/al/books.html">http://www.kulogos.edu.al/al/books.html</a>.</p> <p>Vlen të theksohet se gjatë pandemisë, biblioteka ka luajtur një rol të rëndësishëm duke siguruar akses alternativ të materialeve mësimore dhe kërkimore për të zvogëluar ndikimin e mundshëm të mungesës së materialeve fizike.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në</p>	<p>Biblioteka ka një plan të detajuar strategjik për përditësimin e fondit fizik dhe online në mbështetje të programit të studimit. Fondi i bibliotekës pasurohet vazhdimisht me materiale shqip dhe në gjuhë të huaja përmes blerjeve, shkëmbimit, dhuratave dhe abonimeve (<b>Aneks II/20</b>). Departamenti ka marrë vendime për të kërkuar blerjen e titujve të rinj në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaja në fushën e laboratorëve mjekësorë.</p> <p>Për programin e studimit bachelor në "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë," në përmbushje të rekomandimit të lënë nga grupi i mëparshëm i akreditimit, është pasuruar numri i titujve me 154 tituj në total, prej të cilëve 137 tituj të rinj në gjuhën shqipe (<b>Aneks XI/7.7</b>). Biblioteka raporton rregullisht për shfrytëzimin e saj nga studentët dhe personeli akademik.</p>

<p>pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton:</i></p> <p><i>Institucioni siguron që të përdoret literatura bazë për mësim në gjuhën shqipe, siç është parashikuar në rregulloren e programit. Përveç kësaj, ka në dispozicion literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe ose të huaj, duke siguruar që studentët të kenë burime të përshtatshme për studim.</i></p> <p><i>Departamenti ka një praktikë të përditësimit të literaturës me botime të viteve të fundit. Ky përditësim është i fokusuar kryesisht në literaturën e rekomanduar për programin dhe ka për qëllim sigurimin e informacionit më të fundit dhe relevante për studentët.</i></p> <p><i>Institucioni ofron dy biblioteka për programin e studimit në kampuset e tyre. Studentët kanë të drejtë të anëtarësohen në këto biblioteka dhe të përdorin materiale fizike dhe elektronike brenda dhe jashtë mjediseve të bibliotekës.</i></p> <p><i>Për të siguruar që studentët të dinë si të përdorin me efikasitet burimet e bibliotekës, institucioni organizon trajnime të vazhdueshme. Kjo përfshin njohjen e elementëve të nevojshëm për shfrytëzimin e burimeve të disponueshme.</i></p> <p><i>Studentët kanë mundësi të hyjnë në bibliotekat online si EBSCO, JSTOR dhe PUBMED pa pagesë. Kjo siguron një akses të barabartë dhe efikas për të gjithë studentët në literaturën mjekësore.</i></p> <p><i>Institucioni ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me universitetet partnere për të siguruar qasje në bibliotekat online. Kjo sjellje e bashkëpunimit kontribuon në pasurimin e burimeve dhe informacionit për studentët.</i></p> <p><i>Biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, duke mundësuar shfrytëzimin pa kufizim për</i></p>




	<p><i>studentët. Kjo përfshin instalimin e programeve të nevojshme si microsoft office dhe google chrome.</i></p> <p><i>Fondi i bibliotekës përfshin tekstet mësimore bazë, literaturën ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, revista shkencore, si dhe e-libra. Përdorimi i katalogut elektronik ndihmon në lehtësimin e gjetjes së informacionit nga përdoruesit.</i></p> <p><i>Biblioteka ka një plan të detajuar strategjik për përditësimin e fondit fizik dhe online, duke mbështetur nevojat e programit të studimit. Përmes blerjeve, shkëmbimeve, dhuratave dhe abonimeve, institucioni siguron se fondi është gjithmonë në zhvillim.</i></p> <p><i>Biblioteka ka luajtur një rol të rëndësishëm gjatë periudhës së pandemisë duke siguruar akses alternativ të materialeve mësimore dhe kerkimore për studentët.</i></p> <p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</i></p>			
<b>Sbkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### **Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Institucioni ka një sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetet e tyre, duke filluar nga regjistrimi dhe deri te diplomimi në programin e studimit. Rregullorja e Kolegjit Universitar "Logos" specifikon procedurat për regjistrim, mbajtje dhe raportim të të dhënave, duke referuar Aneksit II/13, si dhe duke përfshirë detajet e nevojshme për këtë proces (vizita në sekretarinë mësimore).</p> <p>Sipas ligjit Nr. 80/2015, në Sekretarinë Mësimore mbahet një regjistër me të dhënat specifike për studentin, numrin e matrikullimit, etj, dhe cdo student ka dosjen personale në hard copy që gjendet në sekretarinë mësimore (Aneks II/18,</p>

	<p><b>Rregullore e Sekretarisë Mësimore, neni 7; vizita në sekretarinë mësimore).</b> Të dhënat e plota për studentët aktualë dhe të diplomuar transmetohen dhe ruhen në formë elektronike nga Sekretaria Mësimore, Zyra e Çështjeve Studentore, etj. Sektori TIK në institucion mbështet njësitë e tjera dhe kujdeset për bazën e të dhënave.</p> <p>Për ruajtjen e informacionit në lidhje me studentët, institucioni përdor sistemin Edupage dhe TEAMS, duke filluar nga të dhënat personale, vlerësimet e tyre, prezencën në mësim, etj. Kopje të këtyre të dhënave ruhen në formate xlsx si backup në kompjutera lokalë dhe në cloud.</p> <p>Sistemi Edupage përdoret për të ruajtur informacionin e nevojshëm për secilin pjesëtar të stafit, duke përfshirë të dhënat personale, materiale të leksioneve të zhvilluara, etj. Ruajtja e informacionit në kopje xlsx ndodh në kompjutera lokalë dhe në cloud. Me ndihmën e këtyre sistemeve, Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor gjeneron dhe ruan statistika vjetore për numrin e regjistrimeve, të dhënat e detajuara në lidhje me numrin e studentëve, transferimet, çregjistrimet, ecurinë akademike, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit në institucion administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore disponon dhe arkivon dokumentacionin për personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerët e angazhuar në realizimin e programit. Kjo përfshin CV-të, diplomën, arritjet akademike dhe gjithë informacionin e nevojshëm për secilin personel që ka kontribuar në programin e studimit përkatës (<b>Aneks II/17, Rregullore për arkivin e Institucionit</b>).</p> <p>Institucioni ka ngarkuar Zyrën e Administratorit të Fakulteteve me mbledhjen dhe raportimin e statistikave. Pas përpunimit të të dhënave nga departamentet, Zyrja e Administratorit të</p>





	<p>Fakulteteve bën përpunimet dhe raportimet e nevojshme pranë MASR.</p> <p>Sektori i IT kujdeset për digitalizimin e të dhënave dhe ruajtjen e dokumentacionit në formën e një bazë të dhënash elektronike. Kështu, informacioni për personelin dhe aktivitetet në programin e studimit ruhet dhe menaxhohet në mënyrë efikase dhe moderne.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Sistemi Edupage është përdorur për të ofruar akses të dedikuar mbi informacionin sipas nevojës për personelin dhe studentët e programit të studimit. Ky sistem përdor një ndërfaqe web, dhe çdo përdorues mund të aksesojë informacionin duke bërë autentikim me një kombinim të emrit të përdoruesit (Username) dhe fjalëkalimit (Password) në adresën <a href="http://kulos.edupage.org">kulos.edupage.org</a> (Aneks XI/4).</p> <p>Sekretaria mësimore ka përgjegjësinë për ruajtjen e të gjithë dokumentacionit të domosdoshëm për çdo student. Ky dokumentacion ruhet në versionin fizik dhe pastaj i hedh këto të dhëna elektronikisht në platformën Teams dhe në formatin e Regjistrimit Themeltar të Studentëve dhe Regjistrimit të Diplomimit. Çdo informacion koordinohet me sistemin qendror kombëtar, dhe studenti regjistrohet përfundimisht vetëm pasi njihet numri i matrikullimit (Aneks II/18, Neni 4, 6, 7, 8, 9, 11).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> <p>Komunikimi interaktiv realizohet nëpërmjet platformës Microsoft 365 dhe, në veçanti, aplikacionit Microsoft Teams. Ky aplikacion ofron jo vetëm një mjet për komunikim interaktiv, por gjithashtu siguron ambiente bashkëpunimi për studentët dhe stafin. Këtu mund të ndahen materiale mësimore, detyra, projekte, video praktike, dhe të zhvillohen aktivitete të ndryshme mësimore (Aneks XI/4 dhe 5). Aksesit në këtë platformë mund të bëhet përmes një ndërfaqe web-i ose përmes aplikacioneve të dedikuara për sisteme operative të ndryshme.</p> <p>Sistemi i menaxhimit gjithashtu përdor platformën Edupage për të menaxhuar regjistrimet, grafikun e provimeve online,</p>



	<p>vlerësimin, fazën e parë të diplomimit, dhe diplomimin. Studentëve u jepen të dhëna të aksesit për llogaritë e tyre individuale për të regjistruar në kohë dhe për të komunikuar me personelin akademik (<b>Aneks XI/5</b>).</p> <p>Sekretaria mësimore ruan në sistemin e menaxhimit të dhëna personale të studentëve, duke përfshirë numrat e telefonit, adresat email, dhe komunikon me ta për njoftime dhe informacione të rëndësishme. Të dhënat personale të studentëve dhe personelit janë të mbrojtura dhe përdoren për komunikime zyrtare dhe administrative.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka siguruar monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ. Përmes adresës elektronike, institucioni mundëson monitorim në kohë reale të aktiviteteve, duke lejuar akses për dekanin dhe përgjegjës të departamentit për të kontrolluar hedhjen e dokumentacionit në kohë.</p> <p>Platforma Edupage dhe Microsoft 365 ofrojnë statistika të detajuara për aktivitetet që mund të kryhen nga të dyja palët, studentët dhe stafi. Statistikat organizohen në grupet dhe individët dhe përfshijnë informacione mbi vlerësimin e studentëve, progresin e tyre në vite, prezencën e tyre, si dhe plotësimin e planeve mësimore, dhe të tjera (<b>Aneks XI/4 dhe 5</b>).</p> <p>Këto statistika dhe të dhëna janë të disponueshme për llogaritë e autorizuar dhe administratoret e sistemit, duke ofruar një mjet efektiv për monitorimin e zhvillimeve aktuale në programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" ka një faqe zyrtare në internet, <a href="http://www.kulogos.edu.al/al/logos-online.html">http://www.kulogos.edu.al/al/logos-online.html</a>, ku janë publikuar informacione lidhur me strukturën organizative, veprimtaritë, bazën ligjore, lajmet dhe aktivitetet që lidhen me veprimtarinë akademike të institucionit. Në këtë faqe, të dhënat janë të disponueshme në shqip dhe anglisht. Po ashtu, në faqen <a href="http://www.kulogos.edu.al/al/teklab.html">http://www.kulogos.edu.al/al/teklab.html</a> mund të aksesohen informacione specifike për programin e studimit MP "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë," duke përfshirë vlerësimet, stafin akademik dhe aktivitetet e ndryshme.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni ka një sistem të avancuar të menaxhimit, duke përdorur platforma të ndryshme dhe teknologji moderne për të</i></p>

*administruar informacionin e studentëve dhe aktivitetin e tyre në mënyrë efikase.*

*Përdorimi i sistemeve si EDUPAGE dhe TEAMS për ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave për studentët, duke përfshirë të dhënat personale, vlerësimet, prezencën në mësim, dhe informacione të tjera relevante. Ky informacion ruhet në formë elektronike dhe bëhet backup në kompjutera lokalë dhe në cloud për siguri të shtuar.*

*Implementimi i një sistemi të strukturuar të arkivimit për dokumentacionin e personelit akademik, administrativ, dhe partnerëve të angazhuar në programin e studimit. Ky sistem përfshin CV-të, diplomën, dhe informacionin relevant për secilin personel.*

*Përdorimi i platformave si edupage dhe microsoft 365 për të siguruar akses të dedikuar për personelin dhe studentët. Këto platforma ofrojnë një mjet efikas për komunikim, shkëmbim informacioni, dhe bashkëpunim në mënyrë të sigurt.*

*Mundësia për monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, përmes statistikave të detajuara të ofruara nga platformat e përdorura. Ky monitorim jep mundësinë për ndjekjen e vlerësimeve, progresit, prezencës, dhe zhvillimeve të tjera aktuale.*

*Përdorimi i një faqeje zyrtare në internet për të publikuar informacionin lidhur me institucionin, strukturën organizative, veprimtaritë, lajmet, dhe aktivitetet e institucionit. Kjo faqe ofron transparencë dhe disponueshmëri të informacionit në shqip dhe anglisht.*

*Përdorimi i platformave të komunikimit si microsoft teams për komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni në mënyrë efikase mes personelit dhe studentëve. Ky mjet mundëson ndarjen e materialeve mësimore, zhvillimin e aktiviteteve mësimore, dhe koordinimin e përgjegjësive.*


*Përdorimi i teknologjisë për të mbledhur dhe raportuar statistikën në lidhje me numrin e regjistrimeve, progresin akademik, transferimet, dhe të tjera. Ky aspekt mundëson një vlerësim të hollësishëm të performancës së programit të studimit.*

	<i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### **Standardi IV.5**


**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni harton një raport financiar vjetor që përfshin kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimin e tarifës së shkollimit, si dhe koston financiare mesatare për studentë. Ky raport përgatitet në nivelin e institucionit dhe ndahet sipas njësave kryesore të tij. Në kushtet aktuale, ku Kolegji Universitar "Logos" është ende një institucion me përmasa modeste, raporti financiar përgatitet kryesisht në nivelin e institucionit, por me rritjen dhe zhvillimin e institucionit, do të nevojitet edhe një përgatitje e raportit financiar në nivel të njësisë bazë dhe programit të studimit.</p> <p>Të ardhurat për mbarëvajtjen e programit të studimit vijnë nga buxheti i Fondacionit "LOGOS" dhe nga tarifat e studentëve. Institucioni paraqet një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe një plan financiar për mbështetjen dhe mbarëvajtjen financiare të programit të studimit "Master në Teknikë të Lartë në Laboratorë Mjekësorë," duke zbatuar praktikatat e raportimit financiar të njësisë bazë. (<b>Aneks IX/2, IX/4, IX/8 dhe 8.1</b>)</p> <p>GVJ e konsideron si praktikë të mire, stabilitin financiar dhe mbështetjen e KU nga Fondacioni "Logos", duke siguruar ecuri të qetë financiare, si dhe (ii) Tarifat e ulta dhe oferta e bursave tregojnë përkujdesje ndaj studentëve dhe inkurajojnë qasjen e gjërë të studentëve ndaj arsimit të lartë.</p>





<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit përfshin një gamë të gjerë të elementëve të financimit që janë kritike për realizimin e programeve të studimit. Ky plan është hartuar në nivel institucional, siç përcaktohet në <b>Aneksin IX/8 dhe tabelën nr. 18</b>. Në përputhje me karakteristikat e Kolegjit Universitar "Logos" si një institucion i madhësisë së vogël dhe fleksibël, plani financiar është i përshtatur për të përmbushur nevojat specifike të njësive kryesore dhe bazë.</p> <p>Elementët kyç në planin financiar përfshijnë financimin e burimeve njerëzore për programet e studimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve mësimore dhe teknologjive mbështetëse, investimet në bibliotekë dhe pasurimin e literaturës nëpërmjet aksesit në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet kombëtare dhe ndërkombëtare të fituara, si dhe kontratat për shërbimet që lidhen me realizimin e programit të studimit. Procesi i hartimit të planit financiar ka një rrjedhë të strukturuar dhe konsultuese, ku njësitë kryesore dhe ato bazë paraqesin kërkesat e tyre. Pas një vlerësimi të kujdesshëm dhe në përputhje me planin strategjik të zhvillimit institucional, kërkesat miratohen dhe reflektohen në detaje në buxhet. Ky proces siguron që resurset financiare të përdoren me efikasitet për të mbështetur qëllimet dhe aktivitetet e programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni implementon një sistem të rregullt auditimi financiar për të vlerësuar dhe dokumentuar gjendjen e financave dhe efektivitetin e përdorimit të tyre. Në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 për arsimin e lartë, institucioni ka përcaktuar një Ekspert Kontabel të Autorizuar për të kryer auditimin e jashtëm të aktivitetit financiar. Ky audit kryhet në bazë të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit të pasqyrave financiare. Auditimi përfshin vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme financiare, politikave kontabël dhe efikasitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Raporti i Audituesit të jashtëm i paraqitet Bordit Drejtues të Fondacionit dhe bashkëshoqërohet me pasqyrat financiare të vitit respektiv. Në përmbushje të detyrimeve ligjore, raporti dhe pasqyrat financiare depozitohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Ky raport shpreh një vlerësim të përgjithshëm për arritjen e objektivave financiare të institucionit dhe siguron një analizë të detajuar mbi shkallën e përmbushjes së objektivave</p>



	<p>strategjike, përfshirë cilësinë e mësimdhënies, procesin kërkimor dhe shërbimin ndaj studentëve. Përveç auditimit të jashtëm, Zyra e Financës dhe administratori i institucionit përgatisin raporte 6 mujore të ecurisë financiare. Këto raporte krahasojnë shpenzimet aktuale me buxhetin e miratuar dhe furnizojnë Bordin e Administrimit me informacion mbi performancën financiare aktuale të institucionit. (Aneks IX/3)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni raporton në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Bazuar në buxhetin e miratuar për njësinë përgjegjëse të programit, institucioni zbaton një komunikim të vazhdueshëm me përgjegjësin e njësisë bazë për realizimin e buxhetit dhe për përdorimin e mundësive financiare në dispozicion. Ky komunikim përfshin një analizë të rregullt të realizimit të buxhetit dhe përfshin shqyrtimin e shpenzimeve dhe të ardhurave aktuale në krahasim me planifikimet dhe projektet e parashikuara. Përmes këtij raportimi, institucioni siguron një transparencë të vazhdueshme dhe një kuptim të qartë të përdorimit të fondeve në nivelin e njësisë bazë, duke mundësuar përmirësimin e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë financiare në nivel programi. (Aneks IX/4)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve.</p> <p>Kolegji Universitar “Logos” ka siguruar një stabilitet financiar si pjesë e Fondacionit “Logos”, nëpërmjet themeluesit të tij, i cili e mbështet dhe inkurajon funksionimin normal lidhur me veprimtarinë kërkimore – shkencore dhe edukative të Kolegjit Universitar “Logos”. Institucioni ka një angazhim të vazhdueshëm për të siguruar resurse financiare të mjaftueshme për zhvillimin e programeve të studimit, duke përfshirë një përjasje të kujdesshme ndaj studentëve. Ky angazhim shprehet në ofrimin e tarifave të ulëta dhe në shpërndarjen e një numri të madh bursash studimi për të inkurajuar qasjen e studentëve me dëshira dhe vullnet për t'u zhvilluar profesionalisht. Për të siguruar qëndrueshmërinë financiare dhe për të përmirësuar situatën financiare në nevojë, institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe ka strategji të diversifikuara për burimet e financimit të programit të studimeve. Kjo përfshin rritjen e</p>



	<p>numrit të studentëve, hapjen e programeve të reja, si dhe pjesëmarrjen aktive në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>GVJ sugjeron rritjen e përpjekjeve për diversifikim të financimit për të përballuar ndryshimet e mundshme në mbështetje financiare, si dhe rritjen e përfshirjes në marketing dhe promovimin e programit të studimit për të rritur numrin e aplikimeve nga studentët.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni ka një përjasje të strukturuar dhe transparente në hartimin dhe monitorimin e raporteve financiare, duke siguruar stabilitet financiar dhe përgjegjshmëri në përdorimin e burimeve. Disa pika kyçe janë:</i></p> <p><i>Institucioni siguron stabilitet financiar përmes mbështetjes nga fondacioni "logos" dhe planifikimit të kujdesshëm të tarifave të studentëve. Kombinimi i këtyre burimeve siguron ecuri të qetë financiare dhe lehtëson qasjen e studentëve në arsimin e lartë përmes tarifave të ulëta dhe ofrimit të bursave.</i></p> <p><i>Hartimi i një plani financiar të përshtatur për njësitë kryesore dhe bazë të institucionit është një praktikë e mirë. Ky plan përfshin financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative, investimet, grantet, dhe kontratat për shërbime të tjera. Kjo përshtatje siguron që nevojat e specifika të secilit program të jenë të mbuluara në mënyrë efikase.</i></p> <p><i>Implementimi i një sistemi të rregullt auditimi financiar sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare është një hap i rëndësishëm drejt përgjegjshmërisë financiare. Raporti i audituesit të jashtëm siguron një vlerësim të pavarur të gjendjes financiare dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve. Përdorimi i raporteve periodike 6-mujore për ecurinë financiare është një mjet i rëndësishëm për monitorim të vazhdueshëm.</i></p> <p><i>Bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe komunikimi me përgjegjësit e njëjësive bazë për realizimin e buxhetit është një praktikë e rëndësishme për sigurimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë. Analiza e rregullt e realizimit të buxhetit dhe shqyrtimi i shpenzimeve dhe të ardhurave siguron një kuptim të hollësishëm për përdorimin e fondeve.</i></p> <p><i>Institucioni ka një strategji të diversifikuar për të siguruar burime të mjaftueshme të financimit, duke përfshirë rritjen e</i></p>

	<p>numrit të studentëve, hapjen e programeve të reja, dhe pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky diversifikim rrit stabilitetin financiar dhe mundëson reagim efikas ndaj ndryshimeve në kushtet e mbështetjes financiare.</p> <p>GVJ sugjeron një rritje të përpjekjeve për marketing dhe promovim të programit të studimit për të rritur numrin e aplikimeve nga studentët. Ky hap mund të ndihmojë në përmirësimin e ardhurave dhe rritjen e stabilitetit financiar në të ardhmen. GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Kolegji Universitar "Logos" implementon procedurat për kriteret e pranimit dhe transferimit në përputhje me bazën ligjore dhe aktet nënligjore aktuale. Për çdo vit akademik, pranimi i studentëve zhvillohet në përputhje me kriteret dhe kuotat e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit <a href="http://www.kulogos.edu.al">www.kulogos.edu.al</a> . Pranimi i studentëve të rinj bazohet në politikat e qarta të pranimit, dhe Statuti i Kolegjit






	<p>Universitar "Logos" specifikon kriteret e pranimit në përputhje me legjislacionin aktual dhe i bën ato të njohura publikisht (<b>Aneks II/1 neni 4 pika 3b, neni 5 pika e</b>).</p> <p>Zyra e Cështjeve Studentore është përgjegjëse për koordinimin e procedurave të pranimit, ndërsa vendimet për kriteret e pranimit merren në senat, në bazë të rekomandimeve nga departamentet (<b>Aneks II/1 neni 15 pika 6f</b>) (<b>Aneks I/6</b>) dhe komunikohen përmes kanaleve zyrtare dhe fushatave promovuese (<b>Aneks III/5.3</b>).</p> <p>Politikat dhe procedurat që rregullojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, duke përfshirë hyrjen, kalimin dhe diplomimin, janë të përfshira në Rregulloren e Programit të Studimit (<b>Aneks II/3.3 KREU IV</b>), e cila është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të Kolegjit Universitar "Logos".</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje e studentëve, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Politikat dhe procedurat që ndjek institucioni garantojnë barazi për të gjithë kandidatët për studentë. Informacioni është transparent në faqen web <a href="http://www.kulogos.edu.al">www.kulogos.edu.al</a>. Informacioni i nevojshëm për të gjithë kandidatët që duan të studiojnë në programin Master Profesional në Teknikë të Lartë në Laboratorë Mjekësorë jepet edhe përmes portalit U-Albania, ku janë të shfaqura publikisht kriteret dhe kuotat për çdo program studimi që Kolegji Universitar "Logos" ofron (<a href="https://ualbania.al/pages/fakultete.html?id=21">https://ualbania.al/pages/fakultete.html?id=21</a>).</p> <p>Barazia dhe shanset e barabarta janë parime të parashikuara edhe për studentët e përzgjedhur përgjatë studimeve të tyre, në zbatim të nenit 10 të Rregullores së institucionit (<b>Aneks II/2 neni 10</b>), e cila parashikon që institucioni gjatë kryerjes së detyrave të tij "nuk mund të bëjë diskriminime mbi baza etnike, gjuhësore, racore, politike, mendimi, filozofike dhe fetare". Departamenti, në kuotat për programin, propozon edhe kuota për kategori të veçanta.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" harton çdo vit akademik, me propozim të Departamentit të Shkencave Mjekësore dhe miratim nga Senati akademik, kritere të veçanta sipas legjislacionit në fuqi, për përzgjedhjen e kandidatëve për</p>



<p>kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>student në programin Master Profesional në Teknikë të Lartë në Laboratorë Mjekësorë.</p> <p>Në faqen zyrtare të Kolegjit Universitar "Logos" publikohen kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që institucioni ofron. Kriteret promovohen në fushatat dhe aktivitetet në kuadër të ditëve të informimit (<b>Takimi me studentët</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" e plotëson këtë kriter duke përcaktuar dhe publikuar në mënyrë transparente kriteret dhe procedurat për pranimin, përparimin në kurs, transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme dhe diplomimin në programin Master Profesional në "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë". Informacioni i nevojshëm për kandidatët është i aksesueshëm në faqen zyrtare <a href="http://www.kulogos.edu.al">www.kulogos.edu.al</a> dhe portalin e përdoruesit u-Albania. Programet e studimit, përfshirë lëndët dhe modulet, bëhen të ditura që në momentin e regjistrimit, ndërsa materialet udhëzuese, përfshirë Rregulloren e Programit të Studimit, syllabuset, kalendari akademik dhe fletëpalosja informative, sigurojnë që studentët të njohin kriteret dhe procedurat e tyre gjatë gjithë ciklit akademik (<b>Aneks II/3.3, Aneks I/12, Aneks VII/5,</b> dhe faqen zyrtare <a href="http://www.kulogos.edu.al/al/teklab.html">http://www.kulogos.edu.al/al/teklab.html</a>)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Para fillimit të çdo viti akademik, Kolegji Universitar "Logos" informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit. Informacioni i plotë rreth kriterëve dhe detajeve të programit është i aksesueshëm në faqen zyrtare të kolegjit <a href="http://www.kulogos.edu.al">www.kulogos.edu.al</a> dhe bëhet i njohur gjatë ditëve të informimit dhe fazave të regjistrimit të hapura për programin e studimit Master, në përputhje me vendimet dhe kalendarin e shpallur të MASR.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Para fillimit të çdo viti akademik, KU LOGOS harton dhe publikon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Kolegji Universitar "Logos" ndjek një rrugë të veçantë në zbatimin e kritereve dhe kuotave për pranim në çdo program studimi, duke i harmonizuar ato me ligjet dhe rregulloret në fuqi të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), si dhe me</p>



	<p>kërkesat e Maturës Shtetërore. Për periudhën akademike 2018-2019, 2019-2020 dhe 2021-2022, kuotat për programin e "Teknikë i Lartë në Laboratorë Mjekësorë" përfshijnë edhe vendosjen e kuotave për kandidatët me aftësi ndryshe, studentë nga trojet, dhe për studentët e huaj, sipas vendimit nr. 9, datë 13.02.2019 (Aneks I/1).</p> <p>Kolegji promovon një ambient të hapur dhe mikpritës për studentët e huaj dhe ata nga trojet. Në vitet 2018-2022, nuk ka regjistrime të studentëve të kësaj kategorie në programin "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë". Informacioni i detajuar mbi kriteret e pranimit, regjistrimet, tarifat e studimit, bursat, dhe aspekte të tjera është lehtësisht i gjatshëm në faqen zyrtare të institucionit <a href="http://www.kulogos.edu.al/en/admissions.html">http://www.kulogos.edu.al/en/admissions.html</a>.</p>
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Para fillimit të çdo viti akademik, Institucioni harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Departamenti propozon çdo vit kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e huaja. Gjatë periudhës së akreditimit, nuk ka regjistrime të studentëve të huaj në programin e studimit. Informacioni i detajuar rreth kriterëve të aplikimit për studentët ndërkombëtarë është i aksesueshëm në faqen zyrtare të institucionit.
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Institucioni ofron bursa të kategorive të ndryshme për studentët në nevojë apo me probleme ekonomike. Megjithatë, në programin Master, këto politika të ndihmës nuk janë aplikuar për mungesë të kërkesave nga ana e aplikantëve. Informacioni i plotë rreth politikave të ndihmës dhe bursave, përfshirë kriteret dhe kushtet e aplikimit, është i publikuar në faqen zyrtare të institucionit.
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura të përfshira në ciklin akademik të studentëve, duke u përpjekur të sigurojë transparencë, barazi dhe përgjegjshmëri. Përmbledhtazi:</i></p> <p><i>Institucioni ka hartuar politika dhe procedura për pranimin dhe transferimin e studentëve, duke i bazuar në legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullative. Kriteret dhe kuotat për pranim janë</i></p>

	<p><i>të publikuara në faqen zyrtare të institucionit dhe përmes portalit u-albania për qasje të lehtë nga kandidatët.</i></p> <p><i>Politikat dhe procedurat e pranimi dhe të gjithë ciklit akademik garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët. Informacioni i nevojshëm është transparent dhe i aksesueshëm në faqen zyrtare dhe portalin u-albania për të gjithë kandidatët.</i></p> <p><i>Institucioni harton çdo vit kriteret specifike për pranimin e studentëve në programin master profesional në teknikë të lartë në laboratorë mjekësorë. Këto kritere janë transparente dhe publikohen në faqen zyrtare, duke përfshirë kuotat dhe detajet e tjera relevante.</i></p> <p><i>Barazia dhe shanset e barabarta janë parime thelbësore për studentët gjatë studimeve të tyre. Institucioni ka hartuar politika që parashikojnë se nuk mund të bëhen diskriminime bazuar në baza etnike, gjuhësore, racore, politike, mendimi, filozofike dhe fetare. Departamenti propozon kuotat për kategori të veçanta për programin dhe promovon një politikë të mirëpritjes për studentët e huaj/trojet.</i></p> <p><i>Institucioni harton çdo vit kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera. Kriteret janë transparente dhe publikohen në faqen zyrtare të institucionit.</i></p> <p><i>Institucioni ka hartuar politika për ndihmë dhe bursa për shtresat në nevojë, duke u përpjekur të rrisë cilësinë e pranimi në programe dhe të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit. Kriteret dhe kushtet e aplikimit janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.</i></p> <p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>




**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>KU LOGOS furnizon një burim të detajuar dhe të plotë të informacionit për kriteret dhe hapat e përparimit akademik të studentëve, si dhe për kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Këto detaje janë të disponueshme në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe Rregulloren e Programit të Studimit Master Profesional në "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë" (Aneks II/3.3 nenet 24-26). Këto dokumente përcaktojnë me qartë kriteret e pranimit, kriteret për shlyerjen e detyrimeve vjetore nga studentët dhe kriteret për kalimin nga një vit në tjetrin. Në vitet e fundit, departamenti ka zbatuar me saktësi procedurat e transferimeve, duke lejuar disa studentë të kalojnë nga një program në tjetrin.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Institucioni u ofron studentëve një qasje unike në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Departamenti i përgjegjshëm për programin ofron mbështetje dhe udhëzime esenciale për studentët përmes një bashkëveprimi të veçantë me zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Sekretarisë Mësimore, (Takimi me studentë dhe përfaqësues të zyrave). Njohja e kualifikimeve apo studimeve të pjesshme bazohet në baza ligjore të përcaktuara në rregulloren dhe udhëzimet e Senatit Akademik. Procesi i transferimeve realizohet me përgjegjësi nga njësia bazë dhe specialistët e saj në bashkëpunim të ngushtë me njësitë kryesore, duke u përmbajtur me saktësi Ligjit të Arsimit të Lartë, Statutit, Rregullores dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi (Aneks II/1, Neni 34). Vendimet e duhura bazohen gjithashtu në Rregulloren e Transferimeve (Aneks II/12 dhe VII/16).</p>
	<p>Kolegji Universitar "Logos" adopton një qasje inovative duke komunikuar hapjen e procedurës së transferimeve dhe regjistrimeve në mjediset e tij dhe në faqen zyrtare elektronike. Informacioni i detajuar rreth dokumentacionit të nevojshëm dhe hapat e procedurës bëhen publik për të gjithë, duke treguar</p>

	përkushtimin ndaj transparencës dhe ndihmës së plotë për studentët në këtë proces.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	KU LOGOS informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit janë të formuluar me një qasje të veçantë në syllabuset e moduleve për çdo semestër, duke zbërthyer në mënyrë detajore parimet dhe metodat e përdorura për vlerësimin e secilës lëndë ( <b>Aneks III/2.3</b> ). Përtej kësaj, parimet e përgjithshme të vlerësimit në këtë program studimi shpalosen gjithashtu në Rregulloren e Programit të Studimit ( <b>Aneks II/3.3 neni 26</b> ) dhe dokumentacione të tjera të lidhura me të, duke sjellë një qasje të pasur dhe të diversifikuar për vlerësimin e performancës së studentëve.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë" shtrin para studentëve një hartë të qartë dhe inovative, duke përcaktuar me një transparencë të vecantë kriteret dhe procedurat e procesit të diplomimit ( <b>Aneks II/3.3 nenet 35-39</b> ). Përfundimi i ciklit të studimeve bachelor shënon një fazë vendimtare, duke mundësuar studentëve të zgjedhin temën e diplomës ose provimin e formimit, të rregulluar me kujdes nga Rregullorja e Programit të Studimit ( <b>Aneks VII/17</b> ). Fondi i pyetjeve për provimin e formimit, miratuar nga Departamenti, bëhet i qasshëm për studentët në fillim të vitit akademik, por jo më vonë se fillimi i semestrit të dytë të vitit të tretë akademik. Kjo përcakton një rrugë unike dhe stimuluese drejt përfundimit të studimeve dhe diplomimit në fushën e "Teknikës së Lartë në Laboratorë Mjekësorë".
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	KU LOGOS dallohet për praktikën e tij të veçantë duke bërë publike udhëzues të posaçëm dhe duke organizuar takime të hapura me qëllim të informimit të të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit, para se të fillojë çdo vit akademik dhe në mënyrë periodike. Përpara se pandemia globale e Covid-19 të bëhej e ndjeshme, Kolegji Universitar "Logos" ka bërë një prezantim të veçantë me shkollat e mesme gjatë ditëve të hapura për maturantët, duke sjellë një përmbledhje të institucionit dhe programeve të studimit që ofrohen ( <b>Aneks VII/3.2</b> ). Duke analizuar regjistrimet dhe takimet online, vërehet se institucioni synon të

	<p>organizojë një takim informues me studentët në fillim të vitit të parë të studimeve. Këtë vit, KU LOGOS ka ndërmarrë një përpjekje të re duke realizuar sesionin e informimit gjatë panairove "Work &amp; Study" (Aneks VII/3.1).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kolegji universitar "LOGOS" ka përcaktuar dhe zbaton procedurat dhe kriteret për përparimin akademik të studentëve në programin e studimit "master profesional në teknikë të lartë në laboratorë mjekësorë". Përmbledhtazi:</i></p> <p><i>Institucioni ka hartuar dhe zbaton rregullore dhe udhëzues që përcaktojnë qartë kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve. Ky informacion është i aksesueshëm në rregulloren e fakultetit të shkencave mjekësore dhe rregulloren e programit të studimit. Kriteret e pranimit, shlyerjes së detyrimeve vjetore, pragun e kalimit nga një vit në tjetrin dhe procesin e diplomimit janë specifikuar në dokumentet zyrtare.</i></p> <p><i>Institucioni informon studentët në lidhje me procedurat dhe kriteret e transferimeve nga studentët duke ndjekur rregulloren e transferimeve dhe aktet ligjore në fuqi. Departamenti dhe zyra e këshillimit të karrierës ofrojnë ndihmë dhe informacion për studentët që kanë nevojë për njohjen e kualifikimeve të mëparshme.</i></p> <p><i>Kriteret dhe procedurat specifike të vlerësimit janë përcaktuar në syllabuset e moduleve për çdo semestër. Parimet e përgjithshme të vlerësimit janë të përfshira në dokumentacionin zyrtar, duke siguruar që studentët të jenë të informuar rreth mënyrës së vlerësimit dhe standardave.</i></p> <p><i>Rregullorja e programit të studimit master profesional në "teknikë e lartë në laboratorë mjekësorë" përcakton me qartësi kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe procesit të diplomimit. Studentët kanë mundësi të përfundojnë ciklin e studimeve të tyre bachelor me temë diplome ose provim formimi, siç është përcaktuar në rregullore.</i></p> <p><i>Para fillimit të çdo viti akademik, ku LOGOS publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për të informuar të interesuarit dhe studentët e ardhshëm mbi programin e studimit. Takimet informuese me maturantët dhe panairët janë organizuar për të prezantuar institucionin dhe programet e studimit. GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit në Kolegjin Universitar "Logos". Procesi fillon që në momentin kur studentët shfaqin interes për një program të veçantë, përmes aktiviteteve të organizuara nga institucioni në bashkëpunim me Zyrën për Çështjet Studentore (<b>Aneks VII/3.3</b>). Informacioni vazhdon të ofrohet gjatë regjistrimit në institucion në një program studimi, duke përfshirë nënshkrimin e kontratës dhe komunikimin e vazhdueshëm nga departamenti në fillim të procesit mësimor.</p> <p>Detajet e profilizuara rreth strukturës, organizimit dhe kohëzgjatjes së programit të studimit gjenden në Rregulloren e Fakultetit (<b>Aneks II/3.1 nenet 25-26</b>) dhe në Rregulloren e Programit të Studimit (<b>Aneks II/3.3 neni 9 - Statusi i Studentit</b>). Për më shumë transparencë, të gjitha këto informacione janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit, <a href="http://www.kulogos.edu.al">http://www.kulogos.edu.al</a>. Komunikimi i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore përdoret për të alternuar kanale të informimit të studentëve. Koordinator i marrëdhënieve me studentët kujdeset që informacioni i rëndësishëm në lidhje me syllabuset, format e vlerësimit, frekuentimin, grafikun e provimeve dhe auditorët të transmetohet me efektivitet (<b>Aneks II/9</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet,</p>	<p>Studentët gëzojnë mundësinë e një aksesimi të gjerë ndaj informacionit rreth programeve të studimit, lëndëve dhe veprimtarive formuese përmes një sërë burimesh, duke përfshirë broshurat informative, guidat e studentit, materiale të printuara, si dhe në faqen zyrtare të universitetit dhe platformën Microsoft Teams. Detajet shtesë gjenden në Rregulloren e Fakultetit (<b>Aneks II/3.1, Kreu V Neni 22</b>) dhe në Rregulloren e Programit</p>



<p>përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>të Studimit (<b>Aneks II/3.3, Neni 9 - Te drejtat e studentit</b>). Informacion i hollësishëm për lëndët përcillet kryesisht në syllabuset (<b>Aneks III/2.3</b>), duke ofruar një burim të pasur dhe të qartë për studentët për të kuptuar më thellësisht strukturën dhe përmbajtjen e lëndëve të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" (KU LOGOS) ndërton një rrugë të qartë për studentët në drejtim të mundësive të punësimit, duke ofruar një gamë të gjerë të mbështetjes institucionale për orientim karriere në bashkëpunim me Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës. Kjo fillon që në momentin kur studentët shprehin interesin për regjistrim në institucion dhe vazhdon përtej këtij momenti.</p> <p>Institucioni ka konsoliduar partneritete me laboratorë dhe institucione shëndetësore për sigurimin e mundësive të praktikës dhe shanseve të punësimit pas përfundimit të studimeve, duke prezantuar një perspektivë të qartë për studentët. Zyra e Këshillimit të Karrierës zhvillon trajnime periodike për përmirësimin e CV-ve dhe strategjive të aplikimit për punë (<b>Aneks II/22 nenet 12-15, VII/2.4, 3.2 dhe 3.5</b>).</p> <p>Studentët shprehin interesin e tyre tek departamenti dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe këto të fundit vazhdojnë ndjekjen e tyre te partnerët e tregut të punës. Takimet ALUMNI, të organizuara nga institucioni, shërbejnë si një eksperiencë e vlefshme për studentët aktualë, duke u mundësuar ata të nxjerrin mësim nga perspektiva dhe përvoja e ish-studentëve në tregun e punës në praktikë (<b>Aneks II/22 neni 10 dhe VII/9</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" (KU LOGOS) përkujdeset që studentët të kenë akses të plotë dhe të përditësuar në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet që ndihmojnë në realizimin e tij. Para pandemicë globale e Covid-19, Departamenti i Shkencave Mjekësore organizonte një sesion informues fizik me studentët e rinj në fillim të çdo viti akademik. Përmes këti aktiviteti ofroheshin udhëzime rreth vendndodhjes së auditorëve, zyrave dhe sekretarive, orarit të shfrytëzimit të bibliotekës, leximit të orarit mësimor dhe përdorimit të sistemit informativ.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë, platformat online u përdorën me efikasitet për të siguruar informacion specifik dhe të përshtatshëm sipas nevojave të studentëve. Informacioni</p>



	vazhdon të jetë i qasshëm në çdo moment online përmes faqes zyrtare <a href="http://www.kulogos.edu.al">http://www.kulogos.edu.al</a> , duke u përpjekur të jetë një burim i lehtëpërdorshëm dhe i përditësuar për të gjithë studentët e KU LOGOS.
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Kolegji Universitar "Logos" shquhet për përdorimin e teknologjisë së avancuar për të siguruar një akses të lehtë dhe të përmirësuar për studentët në lidhje me programin e studimit. Përmes një platforme të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe sistemeve digjitalë si EduPage dhe MS Teams, studentët gëzojnë një përvojë të pasur, duke mundësuar marrjen e informacionit në një mënyrë të lehtësisht të arritshme, madje edhe në distancë.</p> <p>Këto sisteme online ofrojnë një pasqyrë të plotë të programit të studimit, duke përfshirë leksionet e regjistruara, dhe ndërkohë sigurojnë mundësi të pasura për komunikim të drejtpërdrejtë me pedagogët. Përdorimi i këtyre platformave ka bërë që informacioni të jetë i arritshëm edhe kur studentët janë larg kampusit universitar. Ky përparim teknologjik është një shembull pozitiv i përdorimit të inovacionit për të përmirësuar eksperiencën e studentëve, duke rritur ndjeshëm qasjen dhe përfshirjen e tyre në procesin e studimit (<b>Anekse XI 4 dhe 5</b>).</p>
<b>Konkluzione</b>	<p><i>KU "Logos" kujdeset për sigurimin e një informacioni të plotë dhe të hollësishëm për studentët në lidhje me strukturën, organizimin, dhe kohëzgjatjen e programit të studimit "master profesional në teknikë të lartë në laboratorë mjekësorë".</i></p> <p><i>Institucioni fillon procesin e informimit që në momentin kur studentët shprehin interes për një program të caktuar. Aktivitetet e organizuara nga institucioni në bashkëpunim me zyrën për çështjet studentore dhe procedurat e regjistrimit sigurojnë që studentët të kenë njohuri të mjaftueshme lidhur me programin, ndërsa nënshkrimi i kontratës dhe bashkëpunimi me departamentin thellon informacionin.</i></p> <p><i>Informacioni rreth strukturës, organizimit dhe kohëzgjatjes së programit të studimit është i publikuar në dokumente zyrtare si rregullore e fakultetit dhe rregullore e programit të studimit. Detajet janë të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të institucionit, duke përfshirë guidat e studentit, broshurat informative dhe materiale të tjera të printuara.</i></p>

	<p><i>Institucioni promovon komunikimin e brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore. Koordinator i marrëdhënieve me studentët siguron që informacioni mbi syllabuset, vlerësimin, frekuentimin, grafikun e provimeve dhe auditorët të transmetohet në mënyrë efektive.</i></p> <p><i>Studentët informohen rreth mundësive të punësimit që fillon që në momentin e shprehjes së tyre për regjistrim në institucion. Bashkëpunimet me laboratorë dhe institucione shëndetësore ofrojnë studentëve mundësinë për praktika dhe punësim pas diplomimit. Zyrat për çështjet studentore dhe këshillimit të karrierës ofrojnë mbështetje dhe trajnime për orientim në tregun e punës.</i></p> <p><i>Institucioni siguron informacion të gjerë dhe të përditësuar për zhvillimin e procesit mësimor. Në periudhën para pandemisë, takimet informuese fizike dhe platformat online janë shfrytëzuar për të siguruar studentëve informacion të nevojshëm mbi vendndodhjen e auditorëve, orarin e bibliotekës, leximin e orarit mësimor dhe përdorimin e sistemit informativ.</i></p> <p><i>Përdorimi i platformave të tilla si edupage dhe ms teams siguron që studentët të kenë qasje të lehtë dhe të përditësuar në informacion, duke përfshirë leksionet e regjistruara, komunikimin me pedagogët dhe këshilltarët e tyre. Kjo ndihmon në përmirësimin e qasjes dhe përfshirjes së studentëve në procesin e studimit, veçanërisht gjatë periudhave të veçanta si pandemia globale e covid-19.</i></p> <p><i>GVJ konkludon se ky stadanrd përmbushet plotësisht</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>KU LOGOS disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. Institucioni paraqet pranë MASR-së raportet vjetore për veprimtarinë e tij çdo vit akademik, duke përfshirë informacione rreth numrit aktual të studentëve dhe të diplomuarve për çdo program studimi. Këto statistika janë të arritura nëpërmjet Analizës Vjetore të Kolegjit Universitar "Logos" dhe përfshijnë të dhëna të organizuara dhe të përditësuara nga Sekretaria Mësimore. (Aneks II/24 dhe 24.1, 24.2; Aneks VII/13).</p> <p>Sipas të dhënave të marra gjatë vizitës në sekretarinë mësimore rezultoi që numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi në katër vitet e fundit ishte si më poshtë vijon.</p> <p>viti akademik 2019-2020 30 studentë (8 të cregjistruar)</p> <p>viti akademik 2020-2021 16 studentë (2 të cregjistruar)</p> <p>viti akademik 2021-2022 9 studentë (1 i cregjistruar)</p> <p>viti akademik 2022-2023 17 studentë (0 të cregjistruar)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon statistika vjetore të Sekretarisë Mësimore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalëse. Sekretaria Mësimore, përmes këtyre statistikave (Tabela 21), siguron informacionin e nevojshëm për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e procesit të regjistrimit dhe zhvillimit të programit të studimit, duke ndarë këto të dhëna edhe me Departamentin përgjegjës për programin për vetëvlerësim dhe planifikimin në të ardhmen.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve, përfshirë numrin e regjistrimeve, transferimet, çregjistrimet, ecurinë akademike, numrin e ECTS të grumbulluara, dhe të diplomuarve, janë të menaxhuara nga Sekretaria Mësimore. Këto të dhëna ruhen në sistemin EduPage në format elektronik dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke ofruar një mjet efikas për analizë dhe raportim.</p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Institucioni mbështet me akte rregullatore dhe kryen kontroll periodik pranë njësive përgjegjëse për menaxhimin, duke përfshirë sekretaritë mësimore dhe sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit. Përmes vlerësimit dhe dokumentimit të gjendjes dhe saktësisë së informacionit dhe dokumentacionit lidhur me studentët, institucioni siguron përputhshmëri me Rregulloren e Përgjithshme të Kolegjit LOGOS dhe rregulloreve të veçanta për funksionimin e sekretarisë mësimore</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Kolegji Universitar “Logos” ka praktikën e paraqitjes së raporteve vjetore pranë MASR-së dhe disponon statistika nga Sekretaria Mësimore për numrin e studentëve dhe cilësinë në hyrje dhe dalje. (<i>Aneks II/24.2</i>). Departamenti dhe departamentet e fakultetit, nëpërmjet raporteve vjetore dhe analizave të cilësisë, monitorojnë punësimin e studentëve, duke reflektuar dhe përmirësuar masat në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> <p>Sic raportohet ne <i>Aneks II/24</i> Kolegji Universitar "LOGOS" ka një qasje të përmbyllur në gjurmin dhe bashkëpunimin me studentët, duke organizuar kontakte dhe aktivitete nëpërmjet Zyrës Studentore dhe Zhvillimit të Karrierës që fillon që në fazën e shkollës së mesme dhe vazhdon përgjatë studimeve të tyre. Përmes kësaj njësie, institucioni mbledh informacion dhe evidenca për kërkesat e tregut të punës dhe zhvillon bashkëbisedime dhe kurse për të ndihmuar studentët në përgatitjen për jetën profesionale. Angazhimi i vazhdueshëm nëpër ciklet e studimeve shërben për përmirësimin e kualifikimeve dhe përshtatjes së studentëve me sfidat e zhvillimeve të mëtejshme në karrierë.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton si më poshtë:</i></p> <p><i>Institucioni disponon statistika vjetore të numrit të studentëve dhe të diplomuarve. Këto statistika përfshijnë të dhëna të organizuara dhe të përditësuara nga sekretaria mësimore dhe</i></p>

	<p><i>paraqiten pranë agjencisë për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë (MASR) përmes raporteve vjetore.</i></p> <p><i>Përveç statistikave të përditësuara, institucioni kryen analizën vjetore të kolegjit universitar "LOGOS". Kjo analizë përfshin informacione rreth numrit të studentëve, diplomuarve, fakulteteve, studentëve të shkëlqyer, si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për veprimtarinë e institucionit.</i></p> <p><i>Sekretaria mësimore është e përgjegjshme për ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve. Të dhënat ruhen në sistemin EDUPAGE në format elektronik dhe janë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Për të siguruar përputhshmëri me standardet dhe rregulloret, institucioni kryen kontrole periodike pranë njësisë përgjegjëse për menaxhimin.</i></p> <p><i>Kolegji universitar "LOGOS" ka një qasje të përmblyllur në gjurmin dhe bashkëpunimin me studentët. Përmes zyrës studentore dhe zhvillimit të karrierës, institucioni siguron kontakte dhe aktivitete që ndihmojnë studentët në përgatitjen për jetën profesionale, duke adresuar kërkesat e tregut të punës dhe duke ofruar kurse dhe bashkëbisedime për përmirësimin e kualifikimeve të tyre.</i></p> <p><i>Përmes raporteve vjetore të paraqitura pranë MASR, institucioni demonstroi përkushtimin e tij ndaj transparentësisë dhe ndjekjes së standardeve të cilësisë në arsimin e lartë.</i></p> <p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  X

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe</b>	<b>Kolegji Universitar "Logos" nxit pjesëmarrjen aktive dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse dhe</b>

<p>angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>këshilluese të institucionit, duke u përfshirë në Senatin Akademik (<b>Aneks I/1, vendim nr. 5 dt. 13.02.2019</b>), Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (<b>Aneks I/9</b>), Komisionin e Përhershëm të Marrëdhënieve me Studentët, Këshillin e Etikës (<b>Aneks I/10</b>), dhe grupet e vlerësimit (<b>Aneks I/14, 15</b>).</p> <p>Përfaqësuesit e studentëve luajnë një rol aktiv në procesin vendimmarrës dhe japin një kontribut vlerësues përmes sugjerimeve të tyre, të cilat diskutohen me seriozitet në mbledhjet e Departamentit. Departamenti ndjek rregulloret dhe statutet e institucionit në lidhje me këshillin studentor, duke u siguruar studentëve të drejtën për të themeluar organet e tyre që synojnë përmirësimin dhe avancimin e procesit mësimor, ashtu siç është shprehur në dokumentet rregullative (<b>Aneks II/23 dhe 23.1</b>).</p> <p>Komunikimi i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore funksionon si një mjet për shkëmbimin e informacionit në mënyrë efektive. Koordinatori i marrëdhënieve me studentët është përgjegjës për transmetimin e informacionit në lidhje me syllabuset, format e vlerësimit, frekuentimin, grafikun e provimeve, dhe auditorët (<b>Aneks II/9</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>KU LOGOS ka një angazhim të vërtetë për përfshirjen e studentëve në vlerësimin e procesit akademik përmes zhvillimit të instrumenteve matës. Organizimi i pyetësorëve periodikë nga NJSBC u mundëson studentëve të shprehin vlerësimin e tyre për aspektet e ndryshme të mësimdhënies dhe ofron hapësirë për sugjerime. Në dokumentacionin e institucionit (<b>Aneks VI/3, VI.5 dhe VI/6</b>), përcaktohet që studentët janë pjesë e proceseve vendimmarrëse dhe këshillimore në Senatin Akademik, Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Këshillin e Etikës dhe Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm (<b>Aneks I/11, I/9, I/10, I/14 dhe I/15</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton</p>	<p>Departamenti i Shkencave Mjekësore në Kolegjin Universitar "Logos" siguron përfshirjen e studentëve në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit përmes komunikimit të vazhdueshëm, përfshirjes së studentëve në grupet e punës, dhe reflektimit të kontributit të tyre në raportet për vetëvlerësimin e cilësisë (<b>Takimi me studentët dhe stafin</b>). Përfaqësuesit e studentëve, zgjedhur nëpërmjet procesit të</p>



<p>sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>konkursit, janë pjesë e grupit të punës për akreditimin e programit "Master Profesional" Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë dhe shprehin kontributin e tyre në procesin e hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit. Anketimet semestrale dhe vjetore përdoren për të identifikuar mangësitë dhe për të ndërmarë masat për verifikime dhe përmirësime të nevojshme, duke garantuar përfshirjen e studentëve në këtë proces sipas Statutit dhe Rregullores së Kolegjit (<b>Aneks I/2, tabela 11 RVB, VI/5 dhe VI/6</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Procesi i vlerësimit të dijeve dhe kontrollit të studentëve në Kolegjin Universitar "Logos" është një shembull i zbatimit të përpiktë të Rregullores së Fakultetit dhe programit të studimit. Në përputhje me këto udhëzime, rezultatet e testimeve u komunikohen studentëve brenda një periudhe prej 5 ditësh nga momenti i kryerjes së testit me shkrim. Kjo garanton të drejtën e studentëve për ankimim, rishikim dhe rivlerësim të rezultatit para se të dalë rezultati përfundimtar dhe procesverbalit.</p> <p>Në vazhdimësi, NJSBC (Njësia për Sigurimin e Cilësisë në Bashkëpunim) ndjek vlerësimet periodike të studentëve, duke paraqitur vlerësimet e tyre dhe duke i përfshirë ata në procesin e dhënies së mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve nga ana e pedagogut përgjegjës (<b>Aneks VI/3 dhe VI/6</b>). Ky qëndrim i përgjegjshëm dhe transparent ndaj studentëve përforcon një mjedis pozitiv dhe bashkëpunues në procesin e vlerësimit akademik.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><b>Përmbledhtazi GVJ konstaton:</b></p> <p><i>Studentët janë të inkurajuar dhe të përfshirë në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit, duke përfshirë senatin akademik, komisionin e përhershëm të garantimit të cilësisë në arsimin e lartë, komisionin e përhershëm të marrëdhënieve me studentët, këshillin e etikës dhe grupet e vlerësimit.</i></p> <p><i>Studentët kanë të drejtën të formojnë organet e tyre për përmirësimin dhe mbështetjen e procesit mësimor, siç është përcaktuar në dokumentet rregullative.</i></p> <p><i>Departamenti i shkencave mjekësore siguron përfshirjen e studentëve në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Përfaqësuesit e studentëve janë pjesë e</i></p>



	<p><i>grupit të punës për akreditimin e programit dhe japin kontributin e tyre në procesin e hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit.</i></p> <p><i>Koordinatori i marrëdhënieve me studentët dhe komunikimi i brendshëm shërbejnë për të siguruar që informacioni rreth syllabuseve, format e vlerësimit, grafikut të provimeve, dhe aspekteve të tjera të rëndësishme komunikohet efektivisht.</i></p> <p><i>Përmes organizimit të pyetësorëve periodikë dhe përfshirjes së studentëve në grupet e punës, institucioni siguron që studentët të kenë një rol aktiv në vlerësimin e procesit akademik dhe të japin sugjerime për përmirësime.</i></p> <p><i>Procesi i vlerësimit të dijeve dhe kontrollit të studentëve përputhet me rregulloret dhe statutet e institucionit. Sigurohet komunikimi i rezultateve në kohë të arsyeshme dhe ofrohet mundësia e ankimit dhe rishikimit të rezultateve.</i></p> <p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Procedurat për informimin e studentëve në Kolegjin Universitar "Logos" shquhen për qartësinë dhe përshtatjen e tyre me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Kjo realizohet përmes një rrjeti të zyrave të specializuara, duke përfshirë sekretarinë mësimore, Zyren e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit për Karrierën, si dhe Departamentin e Shkencave Mjekësore dhe koordinatorin për marrëdhëniet me studentët.</p> <p>Koordinatori ka një rol kryesor në ofrimin e ndihmës dhe informimit, duke ndihmuar studentët në krijimin e planeve të studimit individuale dhe duke kryer verifikimet e nevojshme për</p>

	detyrimet që studenti duhet të plotësojë (Aneks VII/7). Ky angazhim i përbashkët dhe i koordinuar i zyrave dhe koordinatorit ndihmon në sigurimin e një eksperience informuese dhe mbështetëse për të gjithë studentët në rrugën e tyre akademike.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Kolegji Universitar "Logos" ka implementuar një sistem të specializuar për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit dhe asistencën e studentëve në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit. Departamenti, Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, së bashku me koordinatorin për Marrëdhëniet me Studentët, bashkëpunojnë për të ofruar mbështetje nga momenti i aplikimit deri në diplomim. Për më shumë transparencë dhe qasje në distancë, faqja zyrtare e internetit e kolegjit ofron informacione të detajuara, duke përfshirë procesin e regjistrimit, pagesat online, dhe prenotimin e provimeve. Platforma digjitale e kolegjit gjithashtu mundëson studentëve të ndjekin dhe monitorojnë vlerësimet e tyre dhe të marrin informacion të personalizuar rreth profilit të tyre akademik.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Kolegji Universitar "Logos" dallohet në ofrimin e shërbimeve të avancuara të këshillimit të karrierës përmes Zyres së Këshillimit të Karrierës. Përmes kësaj zyre, studentët dhe alumni përfitojnë nga një gamë e gjerë e shërbimeve, duke përfshirë informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës së tyre. Aktivitete si trajnime, forume, projekte, seminare, takime informative, tryeza të rrumbullakta dhe ngjarje të tjera zhvillohen për të përmirësuar avancimin e tyre profesional. Kolegji gjithashtu bën të njohur informacion për bursa, konferenca studimore, mundësitë e mobilitetit dhe programe shkëmbimesh ndërkombëtare. Pjesëmarrja tradicionale e institucionit në panairin vjetor Work & Study të organizuar nga MASR dhe koordinimi i praktikave profesionale në bashkëpunim me institucione private dhe shtetërore shënojnë një angazhim të vazhdueshëm në përgatitjen dhe orientimin e studentëve për sfidat dhe mundësitë në botën e punës (Aneks II/22, IV/5.3, VII/3.2, VII/4.1-4.3, V/7.2, VII/3.1 dhe 3.5, VII/9.2 dhe VII/11.5).
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas	Zyra e Karrierës e Kolegjit Universitar "Logos" vazhdon të ndjekë studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe

<p>diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>ruajtur të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të të diplomuarve. Përmes përgatitjes së një raporti vjetor, kjo zyrë siguron një pasqyrë të qartë dhe të plotë të zhvillimeve në fushën e punësimit të të diplomuarve, duke ofruar informacion specifik për secilin vit.</p> <p>Raporti vjetor është një burim i rëndësishëm i informacionit për departamentin përkatës dhe institucionin, duke ofruar një panoramë të plotë për punësimin e të diplomuarve vit pas viti. Ky raport siguron një bazë të qëndrueshme për analizë dhe vendimmarrje të përgjegjshme në vazhdim (Aneks VII/9 dhe 9.1).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Procedurat për informimin dhe mbështetjen e studentëve në kolegjin universitar "LOGOS" shprehen në mënyrë të detajuar dhe parashikohen në disa mënyra që përfshijnë zyra të specializuara dhe platforma digjitale.</i></p> <p><i>Koordinatori për marrëdhëniet me studentët ka një rol kyç në ofrimin e ndihmës dhe informimit. Përmes këtij koordinatori, studentët ndihen në krijimin e planeve të studimit individuale dhe marrin asistencë për të plotësuar detyrimet e tyre.</i></p> <p><i>Kolegji ka implementuar një sistem të specializuar për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit dhe asistencën e studentëve. Departamenti, zyra e çështjeve studentore dhe këshillimit të karrierës, së bashku me koordinatoren për marrëdhëniet me studentët, janë të përfshirë për të siguruar mbështetje nga momenti i aplikimit deri në diplomim.</i></p> <p><i>Faqja zyrtare e internetit e kolegjit ofron informacion të detajuar, duke përfshirë procesin e regjistrimit, pagesat online, dhe prenotimin e provimeve. Platforma digjitale e kolegjit u mundëson studentëve të ndjekin dhe monitorojnë vlerësimet e tyre dhe të marrin informacion të personalizuar rreth profilit të tyre akademik.</i></p> <p><i>Zyra e këshillimit të karrierës ofron shërbime të avancuara për planifikimin e karrierës së studentëve dhe të diplomuarve. Kjo përfshin trajnime, forume, projekte, seminare, takime informative, tryeza të rrumbullakta dhe takime të tjera. Kolegji gjithashtu ofron informacion për bursa, konferenca studimore, mobilitete dhe programe shkëmbimesh.</i></p>



	<i>Zyra e karrierës ndjek studentët pas diplomimit duke mbledhur dhe përpunuar të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të të diplomuarve. Një raport përmbledhës vjetor ofron informacion për punësimin e të diplomuarve vit pas viti.</i> <i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Kolegji Universitar "Logos" gjatë vitit 2020-2021 ka implementuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Udhëzuesit përfshijnë objektivat kryesore dhe specifike të lëndëve, modele të mësimdhënies tradicionale dhe inovative, si dhe praktika demonstruese në laborator. Ata gjithashtu përfshijnë kriteret dhe metoda për vlerësimin e të nxënit të studentëve dhe performancën e lektorëve. Kjo qasje synon të sigurojë një përmbajtje mësimore të pasur dhe në përputhje me fushën e studimit, duke theksuar njëkohësisht vlerat e përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. (Aneks I/7 dhe 8, XI/5 dhe II/15, VII/11.1).
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë	Kolegji Universitar "Logos" dallohet në zbatimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Kjo është një dëshmi e qartë për



<p>periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>përkushtimin e institucionit për përmirësimin e cilësisë së mësimin dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Kolegji Universitar "Logos" ka struktura përgjegjëse si NJSBC që janë të përgjegjshme për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Nën vizionin se Statuti i Kolegjit, në veçanti Neni 43 (Aneks II/1 Kreu VIII), përcakton strukturën dhe funksionimin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, shprehur në një mënyrë unike dhe të përshtatshme për kontekstin e Kolegjit Universitar "Logos". Po ashtu, ka hartuar Rregulloren e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (Aneks II/11), e cila rregullon me përpikëri veprimtarinë e strukturave dhe njësisë të ngritura për të garantuar dhe përparuar cilësinë në të gjitha fushat e veprimtarisë së institucionit. Kjo përfaqësojë strukturore dhe rregulluese evidenton përpjekjet dhe sukseset pozitive në garantimin e cilësisë së arsimit dhe kërkimit shkencor në Kolegjin Universitar "Logos".</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Logos" siguron përfshirjen e studentëve në vlerësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies, si dhe në vlerësimin e dijeve. Duke u bazuar në Rregulloren të veçanta përkatëse, Kolegji u mundëson studentëve të ankohen për rezultatin e provimeve dhe të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies përmes metodave të vlerësimit direkt dhe indirekt (<b>Takimi me studentët</b>).</p> <p>Procedurat për ankimim dhe përmirësim të notës janë përcaktuar në detaje në dokumentacionin institucional, duke garantuar një proces transparent dhe të drejtë për studentët. Ky angazhim për transparencë dhe drejtësi është i theksuar në nenin 101 të Kreut XII të Rregullores (<b>Aneks II/2</b>), duke i dhënë rëndësi të veçantë kësaj sfere. Një aspekt i rëndësishëm është përcaktimi i kriterëve për të drejtën e studentëve për të përmirësuar notën në lëndë nën kushte të caktuara. Kjo sjellje proaktive ndaj studentëve tregon përkushtim ndaj përmirësimit të tyre akademik dhe thellon lidhjen mes institucionit dhe studentëve.</p> <p>Analiza e pyetësorëve të studentëve, e përfshirë në Raportin e Analizës (<b>Aneks VI/5</b>), është një praktikë e mirë që rrit transparencën dhe përmirëson cilësinë duke marrë në</p>

	<p>konsideratë pikëpamjet e studentëve. Ky raport, i disponueshëm për të gjithë, shërben si instrument për vlerësimin dhe përmirësimin e klimës së mësuarit dhe bashkëpunimit institucional. Kjo qasje e kujdesshme ndaj proceseve të vlerësimit dhe ankimit, thekson rëndësinë e transparencës dhe ndërveprimit pozitiv mes institucionit dhe studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" ka një transparence të plotë dhe publikon hapur rezultatet e vlerësimeve për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mesimdhënie. Këto rezultate, të përfshira në raportin e Analizës së Pyetësorëve të studentëve (<b>Aneks VI/5</b>), janë lehtësisht aksesueshe për pedagoget, ofruar si burim i vlefshëm për të avancuar dhe pasuruar procesin mesimdhënës.</p> <p>Një aspekt kyç i punës së Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është ndihma e vazhdueshme për përmirësimin e mesimdhënies dhe mesimnxënies. Rekomandimet e sjella përmes vlerësimit janë një mekanizëm i rëndësishëm që ndihmon në adresimin dhe përmirësimin e çështjeve të identifikuara në mesimdhënie (<b>Aneks VI/7</b>). Kjo praktikë e hapur dhe përmirësuese tregon përkushtimin e institucionit për të siguruar cilësi në fushën e arsimit.</p> <p>Një tjetër aspekt i rëndësishëm është përfshirja aktive e stafit akademik në procesin e vlerësimit, duke bërë të njohura rezultatet e anketimeve dhe duke zhvilluar një komunikim të hapur dhe të drejtpërdrejtë. Kjo shërben si një mjet i rëndësishëm për të mbështetur përmirësimin e performancës akademike dhe përmirësuar efikasitetin e mesimdhënies. Institucioni tregon një angazhim të vazhdueshëm për transparencë dhe përmirësim të cilësisë, duke përdorur rezultatet e vlerësimeve për të përmirësuar kontekstin mesimor dhe për të përmbushur objektivat e njesisë së sigurimit të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mesimdhënies.</p>	<p>"LOGOS" promovon shembuj të praktikave të mira dhe duke inkurajuar personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mesimdhënies. Ky përkushtim shfaqet qartë në Raportin Vjetor të KU LOGOS, dhe veçanërisht në Departament, ku vlerësimet e studentëve shihen si burim kyç për të përmirësuar cilësinë e veprimtarisë akademike dhe programet mesimore (<b>Aneks II/24 dhe 24.2</b>).</p>

	<p>Vlerësimet e studentëve, që sipas raportit janë jo vetëm një detyrim ligjor, por edhe një burim i rëndësishëm i informacionit, reflektojnë angazhimin e institucionit për të dëgjuar dhe marrë parasysh pikëpamjet e studentëve për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Ky proces i përdorur nga LOGOS është një model i praktikave të mira në fushën e arsimit të lartë, ku theksohet rëndësia e këtij feedback-u drejtuar stafit akademik.</p> <p>Gjithashtu, Departamenti komunikon aktivisht me pedagogët në lidhje me problemet që dalin nga pyetësorët për sigurimin e cilësisë dhe diskuton hapa konkrete për përmirësimet e mëtejshme. Kjo demonstroi një kujdes të vazhdueshëm për përmirësimin dhe zhvillimin e praktikave mësimore, duke u bazuar në informacionin konkret të marra nga studentët. Përmbushja e këtij kriteri shpërblen përpjekjet e institucionit për të qenë transparent, për të përmirësuar dhe orientuar nga nevojat dhe perspektivat e studentëve, duke promovuar kështu një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kolegji universitar "LOGOS" ka shfaqur një përkushtim të dukshëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes implementimit të udhëzuesve dhe mekanizmave të vlerësimit periodik.</i></p> <p><i>Institucioni ka hartuar dhe implementuar udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Këta udhëzues përfshijnë objektivat kryesore dhe specifike të lëndëve, modele të mësimdhënies tradicionale dhe inovative, si dhe praktika demonstruese në laborator. Përmbajtja mësimore përqendrohet në pasurimin e përmbajtjes dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i></p> <p><i>Kolegji ka implementuar mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Kjo ka për qëllim sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, duke përfshirë vlerësimin e performancës së stafit akademik nga ana e studentëve dhe vlerësimin e përgjithshëm nga strukturat përgjegjëse.</i></p> <p><i>Kolegji ka hartuar dhe miratuar dokumente si statuti dhe rregulloreja e sigurimit të brendshëm të cilësisë për të rregulluar veprimtarinë e strukturave përgjegjëse për cilësinë brendashkollimore. Raporti vjetor i njsbc përmbledh rezultatet e</i></p>

	<p><i>vlerësimeve dhe jep rekomandime për përmirësime. Kjo transparencë shërben si burim informacioni për pedagogët dhe menaxhimin e institucionit.</i></p> <p><i>Përmes vlerësimeve të performancës së stafit në nivele specifike, siç është departamenti i shkencave mjekësore, kolegji ka bërë përpjekje për të adresuar çështjet e identifikuara dhe për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Përfshirja e studentëve në këtë proces ka qenë një mjet i rëndësishëm për të marrë perspektivën e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies.</i></p> <p><i>Kolegji ka theksuar transparencën dhe ndërveprimin pozitiv mes institucionit dhe studentëve përmes publikimit të rezultateve të vlerësimeve dhe duke inkurajuar një komunikim të hapur dhe të drejtpërdrejtë. Kjo përfshin analizën e pyetësorëve të studentëve dhe veprimet konkrete për të adresuar çështjet dhe përmirësuar praktikën mësimore.</i></p> <p><i>Institucioni promovon shembuj të praktikave të mira dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Ky përkushtim shfaqet në raportet vjetore dhe në departamente, ku vlerësimet e studentëve përdoren si burim kryesor për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore.</i></p> <p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje	LOGOS përcakton dhe implementon politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Kjo iniciativë është në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore aktuale, si dhe me aktet rregullatore institucionale.



<p>me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë hartuar dhe zbatohen në përputhje me Ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" (Aneks II/2, Kreu XVII). Në veçanti, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë funksionojnë si organe kyçe për të monitoruar dhe siguruar cilësinë në institucion. Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë (Aneks II/11), Politika e Sigurimit të Cilësisë (Aneks VI/1), dhe instrumentet e miratuara (Aneks VI/3) përcaktojnë strukturën dhe funksionimin e këtyre organeve, duke siguruar një bazë solide për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Me këtë qasje të strukturuar dhe të përshtatur me kërkesat ligjore, LOGOS demonstroi një përkushtim ndaj përmirësimit të cilësisë në të gjitha nivelet e operacioneve të tij. Kjo gjithashtu krijon një mjedis të qartë dhe të përgjegjshëm për monitorimin dhe promovimin e cilësisë në arsimin e lartë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" ndjek dhe zbaton me përkushtim një Sistem të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, duke përfshirë një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ky angazhim evidenton përkushtimin e institucionit drejt ofrimit të një përvojë arsimore sa më të kualifikuar dhe të pasur me vlerë për studentët e tij.</p> <p>Strategjia e vitit 2018-2024 shërben si një dokument kornizë e cila drejton dhe orienton përpjekjet për sigurimin dhe avancimin e cilësisë. Në veçanti, krijimi dhe funksionimi i Njesisë së Vlerësimit dhe Sigurisë së Brendshme të Cilësisë tregon përgjegjësinë e institucionit ndaj standardeve të larta arsimore.</p> <p>Përfaqësuesi i studentëve në Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë reflekton një angazhim konkret drejt pjesëmarrjes së studentëve në proceset vendimmarrëse, duke i bërë ata një pjesë aktive të përmirësimit të cilësisë. Në këtë mënyrë, Kolegji Universitar "Logos" rrit ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë e të gjithë aktorëve drejt një eksperience akademike sa më cilësore.</p>
	<p>Për të rregulluar dhe mbikqyrur proceset e cilësisë, institucioni ka hartuar Rregulloren e Komisionit të Garantimit të Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe programeve të</p>

	<p>studimit, si dhe një Politikë për sigurimin e cilësisë (<b>Aneks II/8, VI/1</b>). Këto dokumente ndihmojnë në udhëheqjen dhe monitorimin e përpjekjeve për përmirësimin e cilësisë në tërësinë e institucionit dhe programeve të studimit. GVJ e konsideron si praktikë të mire faktin që institucioni ka një strategji të qartë dhe politika për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë, e cila është bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos", përdor instrumente dhe tregues të duhur për sigurimin e cilësisë. Për sigurimin e cilësisë, institucioni përdor një gamë të gjerë instrumentesh matës, duke përfshirë vlerësimet e performancës së stafit akademik dhe pyetësorët për studentë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies (<b>Aneks VI/3</b>).</p> <p>Rezultatet e këtyre instrumenteve, së bashku me rekomandimet e tyre, janë monitoruar nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe janë përcjellë drejt departamenteve për vlerësime individuale të pedagogëve. Kjo praktikë e bërë sistemikisht ndihmon në identifikimin e fushave për përmirësim dhe kontribuon në zhvillimin e një kulture të cilësisë përmes promovimit të praktikave më të mira (<b>Aneks VI/5 dhe VI/6</b>).</p> <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit dhe vlerësimeve analitike e krahasuese. Institucioni përdor procedurat ligjore dhe procedurat e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të kryer sigurimin e cilësisë në nivel jashtëm, duke përfshirë hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) në këtë kuadër. Me këto praktika, institucioni demonstroi një përkushtim ndaj vazhdimësisë së përmirësimit të cilësisë në të gjitha nivelet e operacioneve të tij dhe një përdorim efektiv të instrumenteve të cilësisë për të arritur standardet e parashikuara dhe për të përmbushur qëllimet e vet.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" dallohet për përdorimin e treguesve të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, duke reflektuar një angazhim të vazhdueshëm drejt pasqyrimin të gjendjes, arritjeve dhe sfidave të programit të studimit, të parashikuara në aktet rregullatore institucionale.</p> <p>Raportet Vjetore dhe Vlerësimi i Brendshëm janë instrumente cilësore të cilat shfaqin përpjekjet e institucionit në monitorimin</p>

<p>institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>e ecurisë dhe cilësisë të programeve të studimeve. Përmes shqyrtimit të detajuar të këtyre raporteve dhe analizave, një fokus i veçantë është përmirësimi i cilësisë sipas feedback-ut dhe sugjerimeve të studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Një tjetër praktikë e mirë është përdorimi i instrumenteve matëse si vlerësimi i stafit dhe pyetësorët për studentët. Ky proces siguron një platformë ku studentët mund të shprehin mendimin e tyre mbi vlerësimin dhe kontrollin e dijeve, duke inkurajuar një qasje të hapur dhe të drejtë të tyre në këto procese. Përmes procedurave të Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve (Aneks VI/5), institucioni siguron një transparencë dhe informacion të përhershëm për pedagogët dhe autoritetet përgjegjëse, duke kontribuar në një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë dhe përshtatjen ndaj nevojave të studentëve dhe programeve të studimit. Këto praktika tregojnë një përkushtim të vazhdueshëm ndaj cilësisë dhe një orientim drejt arritjes së standardeve të larta arsimore.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kolegji universitar "LOGOS" ka demonstruar një përkushtim të qartë ndaj sigurimit të cilësisë në të gjitha nivelet e operacioneve të tij.</i></p> <p><i>Institucioni ka përcaktuar dhe implementuar politika, struktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë (SBC). Kjo është bërë në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale dhe ka përmbledhur një bazë solide për monitorimin dhe promovimin e cilësisë në arsimin e lartë.</i></p> <p><i>Kolegji operon me një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë, duke përfshirë një strategji institucionale të dokumentuar. Një njësi e veçantë, njësia e vlerësimit dhe sigurisë së brendshme të cilësisë, ka përfshirë edhe pjesëmarrjen e studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë përmes një përfaqësuesi të tyre në komisionin e përhershëm të sigurimit të cilësisë.</i></p> <p><i>Institucioni ka hartuar rregullore dhe politika specifike për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë rregulloren e komisionit të garantimit të standardeve të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit, si dhe një politikë për sigurimin e cilësisë.</i></p>

	<p><i>Kolegji përdor një gamë të gjerë instrumentesh dhe treguesish për sigurimin e cilësisë. Përfshirja e vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe pyetësorëve për studentë është bërë pjesë e procesit për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të identifikuar fushat potenciale për përmirësime.</i></p> <p><i>Institucioni ka një qasje të qartë në monitorimin dhe pasqyrimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim. Përdorimi i treguesve të duhur, si raportet vjetore dhe analizat e vlerësimit të brendshëm, mundëson një pasqyrim të gjendjes, arritjeve dhe dobësive në institucion dhe programe të studimit.</i></p> <p><i>Institucioni përdor efektivisht instrumentet e cilësisë për të arritur standardet e parashikuara dhe për të përmirësuar cilësinë e operacioneve të tij. Ky angazhim është vërejtur në përdorimin e procedurave ligjore dhe të ASCAL për sigurimin e cilësisë në nivel jashtëm.</i></p> <p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe	<p>"Logos" përdor mekanizma dhe procese formale dhe të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin, dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, duke i shërbyer kështu akreditimit të tij. Institucioni ka implementuar një proces vlerësimi që shërben për të evidencuar arritjet dhe dobësitë, motivuar praktikatat dhe arritjet më të mira, dhe planifikuar masat për përmirësim.</p> <p>Çdo vit akademik, institucioni harton një raport vjetor në rang institucioni (<b>Aneks II/24</b>), duke përfshirë monitorimin e implementimit të Planit Strategjik të institucionit. Raporti përfshin të dhëna nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, të</p>



<p>arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>përftuar përmes analizës së Departamentit të Shkencave Mjekësore (Aneks II/24.2). Ky raport paraqet format dhe mënyrat për përdorimin e mekanizmave për shqyrtimin, miratimin, dhe mbikëqyrjen herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Proceset periodike për shqyrtimin, miratimin, dhe mbikëqyrjen herëpashershme të programit të studimit Master Profesional në Teknikë të Lartë në Laboratorë Mjekësorë janë të dokumentuara në procesverbalet e mbledhjeve të departamentit. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe komunikohen autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. Gjithashtu, ekziston një procedurë e dokumentuar për përmirësimin e kurrikulës, e cila përbën një dimension shtesë në procesin e përmirësimit të programit të studimit. Këto praktika tregojnë përgjegjshmëri dhe përkushtim të vazhdueshëm ndaj cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulës në institucion.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>"Logos" përfshin elementët e nevojshëm në raportet e vlerësimit për programin e studimit të ciklit të dytë. Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, si dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë në vazhdim. Një nga mekanizmat për këtë është raportimi dhe përpunimi i rezultateve nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) (Aneks VI/7.1).</p> <p>Raporti i NJSBC paraqet në mënyrë të qartë rezultatet e vlerësimit, përfshin pjesëmarrjen dhe sugjerimet e bëra, duke sjellë një analizë të hollësishme të performancës së programit të studimit të ciklit të dytë. Këto sugjerime shërbejnë si bazë për departamentet për të ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e cilësisë në vijim. Përparësitë dhe sfidat identifikohen dhe shqyrtohen në mënyrë që departamentet të hapin diskutime mbi çështje pedagogjike dhe të gjejnë rrugët më efektive për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien. Këto diskutime janë të dokumentuara në raporte të drejtuar Komisionit dhe Dekanit të Fakultetit. Këto raporte shërbejnë si një mjet për identifikimin e nevojave të trajnimit të personelit akademik dhe përmirësimin e proceseve pedagogjike në të ardhmen. Ky proces transparent dhe përfshirës kontribuon në përmirësimin e</p>

	vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit të ciklit të dytë në institucion.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<p>"Logos" përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit të ciklit të dytë. Këto metoda përfshijnë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimin e didaktikës, vlerësimin e kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, dhe rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare.</p> <p>Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta si anketime, intervista, dhe vëzhgime, përfshirë përpunimet statistikore të të dhënave të grumbulluara. Këto metoda janë të orientuara drejt vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, performancës së pedagogut, krahasueshmërisë dhe qartësisë së tezave të provimeve, kurrikulave, të mësuarit dhe të nxënit.</p> <p>Gjatë kushteve të pandemisë, Departamenti ka vazhduar të kryejë vlerësime të pedagogëve nga studentët përmes anketimit, duke kaluar nga vlerësimi në letër në vlerësimin online, siç është përmendur më sipër (Aneks VI/5 dhe 6). Kjo përpjekje për të ruajtur procesin e vlerësimit edhe gjatë kushteve të pandemisë tregon përkushtim ndaj vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe adaptabilitet në mjediset e ndryshme të mësimin. Grumbullimi i të dhënave dhe përpilimi i raporteve të nevojshme shërbejnë si baza për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programin e studimit të ciklit të dytë.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që	<p>"Logos" përdor metoda dhe instrumente të tërthorta vlerësimi për të vlerësuar realizimin, mbarëvajtjen dhe cilësinë e programit të studimit të ciklit të dytë. Këto metoda dhe instrumente përfshijnë sondazhe dhe intervista me studentët, alumni (të diplomuar), personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, punëdhënësit, dhe institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit.</p> <p>Institucioni zhvillon dy pyetësore periodike për të vlerësuar performancën e stafit akademik dhe cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit. Përveç kësaj, pjesë e rëndësishme e procesit janë vlerësimet dhe sugjerimet nga studentët e diplomuar (alumni), të cilët janë tashmë në tregun e punës. Zyra e Këshillimit të Karrierës mbledh informacione dhe organizon</p>

<p>bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>takime periodike me alumni, duke siguruar një kanal të hapur për ata të shprehin sugjerime dhe vlerësime mbi procesin mësimor në Kolegjin Universitar "Logos" (Aneks VII/9 dhe VII/9.3). Po ashtu, Departamenti i Shkencave Mjekësore ruan kontaktet e ngushta me institucionet bashkëpunuese, duke marrë raporte mbi performancën e studentëve në praktikë apo në punësim (Aneks VII/11.3 dhe 11.4). Këto metoda dhe instrumente ofrojnë një perspektivë të pasur dhe holistike mbi cilësinë e programit të studimit dhe kontribuojnë në identifikimin e veprimeve për përmirësim të vazhdueshëm.</p>
<p><b>Konkluzions</b></p>	<p><i>Institucioni "LOGOS" ka implementuar mekanizma dhe procese të dokumentuara për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë, duke u përqëndruar në sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm. Përmbledhtazi:</i></p> <p><i>Institucioni harton një raport vjetor në rang institucioni, duke përfshirë analizën e implementimit të planit strategjik të institucionit. Ky raport ofron një pasqyrim të performancës në nivel institucional dhe ka përfshirë analizën e fakultetit të shkencave të aplikuara, duke shërbyer kështu si një mekanizëm i rëndësishëm për vlerësimin dhe përmirësimin.</i></p> <p><i>Proceset periodike për shqyrtimin, miratimin, dhe mbikëqyrjen herëpashershme të programit të studimit janë të dokumentuara në procesverbalet e mbledhjeve të departamentit. Kjo përfshin dokumentimin e rezultateve të vlerësimit dhe komunikimin e tyre autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</i></p> <p><i>Institucioni ka një procedurë të dokumentuar për përmirësimin e kurrikulës, e cila shton një dimension shtesë në procesin e përmirësimit të programit të studimit. Kjo tregon përgjegjshmëri dhe përkushtim ndaj zhvillimit të kurrikulës në institucion.</i></p> <p><i>Raportet e vlerësimit për programin e studimit të ciklit të dytë përfshijnë elemente të nevojshme si rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, praktikat dhe arritjet më të mira, si dhe masat për përmirësimin e cilësisë në vijim.</i></p> <p><i>Njësisia e sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC) raporton dhe përpunon rezultatet e vlerësimit, duke përfshirë analizën e hollësishme të performancës së programit të studimit. Këto</i></p>

	<p><i>raporte ofrojnë sugjerime konkrete për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë.</i></p> <p><i>Institucioni përdor një kombinim të metodave të drejtpërdrejta dhe tërthorta për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe realizimit të programit të studimit të ciklit të dytë. Kjo përfshin anketime, intervista, sondazhe, vëzhgime në auditor, testim, dhe përpunime statistikore.</i></p> <p><i>Institucioni ka vazhduar vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies gjatë kushteve të pandemisë, duke përdorur metodat e duhura për të mbajtur procesin e vlerësimit edhe në mjediset e ndryshme të mësimin.</i></p> <p><i>Përfshirja e feedback-ut nga studentët dhe alumni jep një perspektivë të pasur dhe holistike mbi cilësinë e programit të studimit. Ky feedback shërben si bazë për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për përmirësim.</i></p> <p><i>GVJ konkludon se ky srandard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.4


**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" demonstroi një përkushtim të fortë ndaj sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë së programit të studimit, siç tregohet përmes politikave të strukturuar dhe dokumenteve të miratuara, përfshirë Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë (Aneks II/11), Politikën e Sigurimit të Cilësisë (Aneks VI/1), dhe instrumentet e miratuara (Aneks VI/3). Përdorimi i instrumenteve të miratuara, si sondazhe, intervista, dhe vlerësime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, tregon një përqëndrim të qëllimshëm në vlerësimin dhe adresimin e cilësisë së mësimdhënies. Përveç kësaj, përfshirja e aktorëve të ndryshëm, si personeli akademik, studentët, dhe alumni, përmes pyetësoreve</p>



	dhe takimeve periodike, përbën një qasje të hapur dhe të përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë, të cilën GVJ e konsideron si praktikë të mire.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni ka një qasje të caktuar në përcaktimin e përgjegjësi dhe detyrave për të gjithë aktorët e përfshirë në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Përmes parashikimeve dhe akteve rregullatore, Institucioni përcakton rolin e njësive, individëve dhe studentëve, të cilët janë të përfshirë në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit. Kjo qasje ndihmon në organizimin e njësisë së përgjegjshme për përpilimin e raporteve, duke siguruar që të gjithë aktorët të kenë detyra dhe përgjegjësi të qarta në procesin e vlerësimit të cilësisë. Kjo gjithashtu mundëson që vendimet për ngritjen e grupeve të punës të merren në përputhje me aktet rregullatore dhe të sigurohet një koordinim efikas në drejtim të sigurisë së cilësisë ( <b>Aneks VI/2.1 dhe 2.2</b> )."
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në kontekstin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit Master në Teknikë të Lartë në Laboratorë Mjekësorë, përfshirja e anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentëve në këtë proces është një aspekt pozitiv ( <b>Aneks I/15 dhe 15.1</b> ). Kjo përfshirje shërben për të pasqyruar një perspektivë të gjerë dhe të diversifikuar mbi cilësinë e programit në nivelin e Departamentit dhe Fakultetit. Grupi i punës, i cili është i përbërë nga 4 anëtarë, është një nismë pozitive për të kryer vlerësimin e cilësisë.
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Proçesi i përfshirjes dhe aktivizimit të aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit, duke patur parasysh nevojën për respektimin e integritetit akademik dhe shmangien e diskriminimit apo pabarazisë ndaj personelit dhe studentëve është i një rëndësie të veçantë. Institucioni, sipas Rregullores së Kolegjit Universitar "Logos" ( <b>Aneks II/2</b> ), Statutit të institucionit ( <b>Aneks II/1</b> ), dhe Kodi i Etikës ( <b>Aneks II/10</b> ), ka vepruar në përputhje me këto udhëzime për të rregulluar dhe mbrojtur integritetin akademik, duke ndërmarrë hapa për të parandaluar çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie.

	<p>Në veçanti, përfshirja e anëtarëve të ndryshëm të stafit akademik, administrativ dhe studentëve në grupe pune të ndryshme, duke u siguruar që secili të ketë mundësinë për tu përfaqësuar, shërben si shembull konkret i kësaj përpjekjeje për të garantuar një mjedis të barabartë dhe të drejtë për të gjithë. Kjo praktikë tregon përkushtimin ndaj diversitetit dhe ndërtimin e një mjedisi të hapur ku çdo individ ka mundësinë të kontribuojë në proceset ciklike të vlerësimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Ky kriter thekson rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Në rastin e Kolegjit Universitar "Logos," ky angazhim shprehet përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të rëndësishme ndërkombëtare, si Universiteti i Selanikut, Universiteti i Pireut, dhe Universiteti i Trakës.</p> <p>Përmes këtyre marrëveshjeve, pedagogë nga këto universitete ofrojnë ekspertizën e tyre dhe japin mendimet e tyre mbi programin e studimit, cilësinë e studentëve, dhe shërbimet e ofruara. Ky mekanizëm shërben si një burim i vlerësimit objektiv dhe ekspertizës së jashtme për programin, duke sjellë një perspektivë të pasur dhe të diversifikuar që mund të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Përfshirja e këtyre bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm mund të sjellë një përparim të qëndrueshëm dhe një shkëmbim të vazhdueshëm të njohurive dhe praktikave të mira në nivel ndërkombëtar.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Kolegji universitar "logos" vazhdon të theksojë përkushtimin e tij ndaj sigurimit dhe përmirësimin të cilësisë në programet e studimit, duke implementuar politika të strukturuar dhe dokumente të miratuara.</i></p> <p><i>Përdorimi i dokumenteve të miratuara, përfshirë rregulloren për sigurimin e cilësisë dhe politikën e sigurimit të cilësisë, tregon se institucioni ka një kuadër strukturor dhe organizativ për menaxhimin e cilësisë në nivel institucional.</i></p> <p><i>Përdorimi i instrumenteve të miratuara si sondazhe, intervista, dhe vlerësime të drejtpërdrejta dhe tërthorta, tregon një përqendrim të qëllimshëm në vlerësimin dhe adresimin e cilësisë</i></p>



	<p>së mësimdhënies. Ky hibridizim i metodave ofron një perspektivë të pasur.</p> <p>Përfshirja e personelit akademik, studentëve dhe alumni në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë shërben për të përmbushur një qasje të hapur dhe të përfshirë. Ky aspekt është vlerësuar si praktikë e mirë nga grupi vlerësues i jashtëm (GVJ).</p> <p>Institucioni ka një qasje të caktuar në përcaktimin e përgjegjësisë dhe detyrave për aktorët e përfshirë në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Ky qëndrim ndihmon në organizimin e njësisë përgjegjëse dhe në sigurimin e një koordinimi efikas.</p> <p>Përfshirja e grupit të punës për vlerësimin e cilësisë është një nismë pozitive, e cila mund të sjellë një analizë të thelluar dhe të përgjegjshme të programit të studimit.</p> <p>Bashkëpunimi me institucione të rëndësishme ndërkombëtare dhe angazhimi i pedagogëve nga këto institucione ofron një perspektivë ndërkombëtare dhe ekspertizë të jashtme. Kjo përcjell një shkëmbim të njohurive dhe praktikave të mira.</p> <p>Institucioni veprimi në përputhje me udhëzimet për respektimin e integritetit akademik dhe mbrojtjen nga diskriminimi apo pabarazia, siç paraqiten në rregullore dhe kode etike.</p> <p>Përfshirja e aktorëve të ndryshëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë shpreh përkushtimin ndaj diversitetit dhe ndërtimin e një mjedisi të hapur dhe të barabartë.</p> <p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe	Kolegji Universitar "Logos" garanton transparencën në politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të

<p>veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit. Ky angazhim është shprehur përmes publikimit të dokumenteve kyçe, duke përfshirë Statutin dhe Rregulloren, në faqen zyrtare të institucionit. Përtej kësaj, vendimet e marra nga organet kryesore të institucionit, si Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, gjithashtu janë bërë publike.</p> <p>Kjo transparencë siguron që studentët dhe të gjithë të interesuarit të kenë akses të drejtpërdrejtë në informacionin relevant dhe të jenë në dijeni të strukturës, proceseve dhe politikave që ndikojnë në cilësinë e programit të studimit. Publikimi i këtyre dokumenteve thekson përkushtimin ndaj hapësirës së informacionit dhe dialogut të hapur, duke krijuar një mjedis të besueshëm dhe të qartë për të gjithë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" demonstroi angazhimin për transparencë në publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programeve të studimit. Faqja zyrtare e institucionit është në dispozicion të publikut, duke përfshirë studentët dhe të gjithë të interesuarit, dhe u ofron informacion mbi rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit. Kjo praktikë është në përputhje me lirinë dhe etikën akademike, duke garantuar që informacioni të jetë i lirë dhe i hapur për të gjithë ata që kanë interes në cilësinë e programeve të studimit në institucion. Për të ruajtur integritetin akademik dhe për të përmbushur kërkesat legjislative për mbrojtjen e të dhënave personale, Kolegji Universitar "Logos" punon në përputhje me legjislacionin për të dhënat personale. Ky angazhim është shfaqur në publikimin e rezultateve të akreditimit institucional dhe ka për qëllim vazhdimin e kësaj praktike edhe për programin MP Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësore. Pas përfundimit të procesit të akreditimit, pritet që rezultatet të bëhen publike në mënyrë transparente dhe në përputhje me kriteret e cilësisë akademike.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" trgon një përkushtim konkret për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit përmes hartimit dhe zbatimit të Planit të Zhvillimit të Departamentit të Shkencave Mjekësore. Ky plan ka si synim adresimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara, duke u fokusuar në përmirësimin e cilësisë për të gjithë aktorët e përfshirë në departament, si studentët dhe stafin akademik. Kjo praktikë shpreh përkushtimin e institucionit ndaj përmirësimit të vazhdueshëm dhe është një hap i rëndësishëm drejt cilësisë së lartë akademike. Duke hartuar</p>



	<p>dhe implementuar planin e zhvillimit, Kolegji Universitar "Logos" demonstroi një qasje sistematike për të trajtuar sfidat dhe për të avancuar në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm. Kjo përfshirje dhe përkushtim ndaj përmirësimit të cilësisë reflektohen në dokumentet zyrtare, konkretisht në <b>Aneksin II/4.2.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni ka identifikuar dhe paraqitur disa shembuj konkrete nga Departamenti i Shkencave Mjekësore në Planin e Zhvillimit.</p> <p>Në këtë kontekst, disa veprimtari pozitive të Departamentit përfshijnë përmirësimin e kurrikulës mësimore, punësimin e pedagogëve të rinj të kualifikuar, zgjerimin e infrastrukturës për mësimdhënie dhe praktika laboratorike, mundësimin e mobilitetit të stafit dhe studentëve në universitete partnere ndërkombëtare për trajnim, pasurimin e fondit të bibliotekës me literaturë në shërbim të programit mësimor, si dhe përmirësimin e dokumentacionit rregullator për të rritur efikasitetin e procesit mësimor. Ky angazhim për të vlerësuar dhe përmirësuar metodat dhe instrumentet e vlerësimit shërben për të garantuar një cilësi të lartë në ofrimin e programeve të studimit. Kjo transparencë dhe përkushtim për përmirësim evidentohen zyrtarisht (<b>Aneks II/24</b>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar "Logos" organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Nëpërmjet dokumentacionit të shqyrtuar dhe diskutimeve nga takimet me NJSBC, bëhet e ditur se institucioni ka vendosur praktikën e takimeve periodike me stafin akademik, ndihmësakademik, dhe studentët.</p> <p>Këto takime shërbejnë për të informuar pjesëmarrësit në lidhje me arritjet e institucionit dhe rekomandimet që duhet të zbatohen për të përmirësuar cilësinë e institucionit në përgjithësi dhe cilësinë e programeve të studimit në veçanti. Kjo përfshirje aktive dhe informimi i pjesëmarrësve ka rëndësi të veçantë në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë. Këto informacione dhe komunikime janë dokumentuar në materiale të</p>

	veçanta, përfshirë anekset e komunikimeve me NJSBC dhe mbledhjet e departamenteve.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konkluzione</li> </ul>	<p><i>Kolegji universitar "LOGOS" vazhdon të theksojë përkushtimin e tij ndaj transparencës dhe sigurimit të cilësisë në programet e studimit. Disa elemente thelbësore të këtij përkushtimi përfshijnë:</i></p> <p><i>Institucioni ka angazhuar veten për të siguruar transparencë duke publikuar dokumente kyçe, përfshirë statutin, rregulloren, dhe vendimet e organit kryesor, në faqen zyrtare të tij. Ky veprim siguron që të gjithë të interesuarit të kenë akses të drejtpërdrejtë në informacionin rreth strukturës, politikave dhe proceseve që lidhen me cilësinë e programit të studimit.</i></p> <p><i>Faqja zyrtare e institucionit ofron informacion të përditësuar mbi rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit. Këto hapa sigurojnë që studentët dhe të interesuarit të kenë një pamje transparente dhe të jenë të informuar mbi cilësinë e programeve të studimit.</i></p> <p><i>Në përpjekje për të ruajtur integritetin akademik dhe përmbushur kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, institucioni vepron në përputhje me legjislacionin për të dhënat personale. Ky angazhim tregon ndërgjegjësim dhe përkushtim ndaj etikës dhe respektit të të drejtave të individëve.</i></p> <p><i>Hartimi dhe implementimi i planit të zhvillimit të departamentit të shkencave mjekësore shërben si një qasje sistemike për të përmirësuar cilësinë për të gjithë aktorët e përfshirë. Ky plan është një mjet konkret për të adresuar sfidat dhe për të përmirësuar cilësinë e programeve të studimit.</i></p> <p><i>Takimet periodike me personelin dhe studentët tregojnë përkushtimin ndaj ndërgjegjësisë dhe informimit të pjesëmarrësve rreth cilësisë së programit të studimit. Këto takime përfshijnë diskutime dhe raporte mbi arritjet e institucionit dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë.</i></p> <p><i>Bashkëpunimi me institucione të rëndësishme ndërkombëtare dhe përfshirja e ekspertëve të jashtëm shërbejnë si burime të vlerësimit objektiv dhe ekspertizës së jashtme për programin e studimit.</i></p> <p><i>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekesore, ofruar nga Kolegji Universitar "LOGOS"**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Tarifat e ulta dhe oferta e bursave tregojnë përkujdesje ndaj studentëve dhe inkurajojnë qasjen e gjërë të studentëve ndaj arsimit të lartë;
2. Kapacitetet e mjaftueshme infrastrukturore dhe burimet njerëzore janë një strategjia dhe politikat forcat që mund të ndihmojnë në ofrimin e një cilësie të lartë në shërbim të arsimit;
3. Institucioni ofron një sërë informacione të detajuara në lidhje me proceset e studimit, programet, dhe shërbimet e disponueshme;
4. Institucioni përdor teknologjinë (sistemet digjitale si edupage, ms teams) për të mbështetur studentët dhe siguruar transparencë në procesin e mësimin;
5. Institucioni ka procedura dhe organe që inkurajojnë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje dhe procese të tjera institucionale;
6. Ka një përkushtim për ndjekjen e studentëve pas diplomimit dhe ruajtjen e të dhënave për punësimin e tyre;
7. Institucioni ka një strategji dhe politika të qarta për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë, e cila është bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit;
8. Institucioni ka një strukturë të qëndrueshme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë, përfshirë një njësi të vlerësimit dhe sigurisë të brendshme të cilësisë dhe një komision të përhershëm të sigurimit të cilësisë;
9. Infrastruktura bashkëkohore mësimore dhe laboratorike për një zhvillim normal të punës, mësimore dhe kërkimore-shkencore në Departament;

10. Stafi akademik i përbërë nga figura të spikatura të mjekësisë laboratorike me eksperiencë dhe grada e tituj shkencorë dhe nga pedagogë të rinj të përfshirë në procese trajnimi profesional dhe kualifikimi shkencor;

**b. Pikat e dobëta:**

1. Mungesa e diversifikimit të burimeve financiare, mbështetja kryesisht nga fondacioni "Logos" mund të jetë kufizuese në situata të ndryshme financiare; (*standarti IV.5 konkluzione*)

**Rekomandime**

1. Për të përballuar konkurrencën, institucioni mund të investojë në fushën e marketingut dhe reklamës për të theksuar vlerat dhe avantazhet e tij unike në krahasim me institucionet e tjera;
2. Për të përballuar kufizimet financiare, mund të studjohet dhe shfrytëzohet më tej diversifikimi i burimeve të financimit duke përfshirë bashkëpunime me industrinë, grante dhe donacione, dhe zhvillim të programeve të paguara shtesë për trajnime profesionale;

**Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Professional Master in Advanced Techniques in Medical Laboratories, offered by the "LOGOS" College**

**a. Strengths and Affirmations:**

1. Demonstrating a commitment to student welfare, the institution showcases its dedication through low fees and scholarship offerings, fostering broad student access to higher education;
2. Implementing a strategic approach, the institution ensures high-quality education by maintaining ample infrastructural capacities and human resources;
3. The institution furnishes comprehensive information on study processes, programs, and services, promoting transparency and clarity;
4. Utilizing technology such as digital systems (e.g., Edupage, MS Teams), the institution supports students and ensures transparency throughout the learning process;
5. Established procedures and bodies facilitate student inclusion and participation in decision-making and institutional processes;



6. A commitment to post-graduation support and employment data maintenance highlights the institution's dedication to student success;
7. Clearly outlined strategies and policies for quality assurance and improvement are publicly accessible to students and stakeholders;
8. The institution boasts a stable structure for quality assurance, featuring an internal quality assurance and assessment unit and a permanent quality assurance committee;
9. Adequate teaching and laboratory infrastructure support normal operations, teaching, and research-scientific development in the department;
10. The academic staff comprises experienced figures in laboratory medicine, holding scientific degrees and titles, as well as young lecturers engaged in professional training and scientific qualification processes;

**b. Weakness:**

1. The institution faces a challenge in financial resource diversification, relying predominantly on support from the "Logos" foundation, which may be limiting in various financial situations; *(Standard IV.5 conclusions)*.

**Recommendations:**

1. To enhance competitiveness, the institution can invest in marketing and advertising to emphasize its unique values and advantages compared to other institutions;
2. To address financial constraints, exploring diversified funding sources, such as collaborations with industry, grants, donations, and the development of additional paid vocational training programs, is recommended for study and implementation;

**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X